

revista shqiptare e turizmit rajonal

# travel

Nr.24 / 2017

albaniantravel.info



*Berati*  
2400 karat ofertë turistike

*Kavaja*  
qyteti mesjetar me rrënjët  
në antikitet

*Saranda*  
vjeshtë ullinjsh e mandarinash

*Puka*  
mikpritje me ngjyra vjeshite

*Via Egnatia*  
me qerre dhe kuaj si romakët

# #di1vend

*në Shqipëri, këtë herë ishte*

# Kepi i Rodonit

*në zbulim Ftë vendit të radhës me klubin Discover Albania*



## ADRIATIK TOURS LLC



Adriatik Tours LLC



@travel2albania

### *Experience your vacation in Albania a destination to discover in the Mediterranean!*

We operate as an Exclusive Sales Office and a Tour Agency for Adriatik Hotel in North America. We are committed to offer to you the best experience of your lifetime. Custom made packages, 5 Star luxury affordable accommodation, Dental Tourism and Special Tours. Specially designed for the food lovers, the adventurers, the ones who look for tranquility and relax, the curious ones, the nightlife party lovers, Cultural heritage tours.

We have plenty of options to serve you all.

Our Tour Agency will book for you a 5 star hotel stay and surprise you with what Albania has to offer.

**Visit us on a vibrant central location, steps from Blue Back Square**

**Address : 970 Farmington Avenue, Suite 208 ,**

**West Hartford, Connecticut, 06107, USA**

**Phone: +1 860 936 2216**

**email: gm@adriatiktours.com**

**www.adriatiktours.com**

**Hours:**

**Monday - Friday: 9am - 5pm**

**Saturday: By appointment**

**Sunday: Closed**





Festojmë  
Bukur  
Çdo  
Festë!



Bëhu pjesë e tyre!

# NidBooking

HOTEL BOOKING PLATFORM



*hotele*  
*në mbarë botën*  
**480.000**

*mbi* **15.000**

*destinacione*

Per cdo nevoje ne ju pergjigjemi menjehere.

Na kontaktoni si me poshte:

NidBooking është një platformë **B2B** për rezervim hotelesh e dedikuar vetëm për **AGJENCITË TURISTIKE** dhe **TUR OPERATORET**, e cila operon në tregje si: Europe, Amerike e Veriut dhe të Jugut, Azi dhe Afrike.

info@nidbooking.com  
(Kerkesa te pergjithshme)  
reservations@nidbooking.com  
(Departamenti rezervimeve)  
finance@nidbooking.com  
(Departamenti finances)  
Phone: +355 4 560 11 55  
Skype: NidBooking B2B Platform

[www.nidbooking.com](http://www.nidbooking.com)



## Parku Kombëtar Lugina e Valbonës, AL

Vjeshta vjen si gjithmonë me një spektakël ngjyrash në Alpet e Shqipërisë. Ky fragment i larë në okër, ju vjen prej fotografit të mirënjohur gjakovar, i cili nuk lodhet së ndjekuri momentet më të bukura që të dhuron natyra shqiptare në çdo stinë

Photo: Shkëlzen Rexha ©

enjoy the  
*Autumn*  
colours of Albania

# Përmbajtja/Contents

Sportet në natyrë dhe sportet e aventurës, tashmë janë një dukuri e zakonshme në territorin e Shqipërisë, madje kanë kaluar edhe kufijtë dhe tani zhvillohen edhe në territorin e Ballkanit. është vërtet kënaqësi të shohësh që ujrat e liqeneve dhe lumejve nuk janë më të shkretë por popullohen e zbukurohen me varka, me kanoe, ma kajakë, varka me vela e gjithfarëloj mjetesh të tjera lundrimi, drejtuar nga më të apasionuratit e natyrës e sporteve. Ne foto: një prej dhjetë lundrimeve që bashkëpunëtori ynë Kastriot Faci realizoi këtë verë me kanoe në liqenet dhe lumejtë e Shkodrës dhe Pukës

Bregu i Ranës, Kiras  
Foto: Kastriot Faci©






26



40



62



70



98

## Rubrika / Articles

- 13 Editorial**  
Come to my Home  
*Irhan Jubica*
- 26 Intervista**  
Milva Ekonomi: "Prioritetet e turizmit s` duhet të ndryshojnë"  
*The tourism priorities should`nt change*  
*Irhan Jubica*
- 22 Gjurmë**  
Kavaja, qyteti mesjetar me rrënjët në antikitet  
*Zyhdi Shehi*
- 52 Reportazh**  
Di një vend në Shqipërinë e bukur - është Rodoni  
*I know a place in the beautiful Albania - it is Rodoni Cape*  
*Flora Xhemani Baba*
- 58** GlobalLimits Albania - The Hidden Treasure  
*From berati to Butrint, through the hidden treasures of Albania*  
*Albania Adventure*
- 70 Itinerar**  
Me qerre dhe kuaj si romakët nëpër shtigjet e Rrugës Egnatia  
*With chariots and horses like the Romans, on the trails of Via Egnatia*  
*Artur Guni*
- 76 Natyrë**  
Kelmendi bukuria e rrallë në gji të Alpeve  
*Kelmend, the rare beauty of the Northern Alps*  
*Rozafa Topalli*

## Destinacionet e vjeshtës 2017

### Autumn Destinations 2017

- 40** Berati, 2400 karat ofertë turistike  
*Berat, the 2400 years - old precious package*
- 44** Saranda në vjeshtë? Po, me ullinj e mandarina  
*Saranda in Autumn? Yes, with olives and tangerines*

## Events

- 38** **Komkursi Ndërkombëtar "Onufri"**  
**20 DHJETOR - 30 JANAR**  
Edicioni i radhës i Konkursit Ndërkombëtar të Arteve Pamore "Onufri" vjen në Galerinë Kombëtare të Arteve.



**4 NËNTOR - 30 DHJETOR**  
Fundjavë në Shkodër në kërkim të atraksioneve turistike të qytetit





# PATA NEGRA

r e s t a u r a n t

Kur flitet për gastronomi në Shqipëri, tashmë asgjë nuk i lihet më rastësisë. Investimi bëhet serioz e i kuruar në çdo detaj. Sot forma e servirjes është shumë e rëndësishme për shqisën e të parit por kurrësi ajo nuk duhet të rrezikojë përmbajtjen, që është edhe thelbi i gjithçkaje në gastronomi. Pata Negra Restaurant, i plotëson të dyja. Madje, edhe më shumë se kaq. Kuzhinë me mish të egër, prodhime fshati dhe çdo të premtë menu me bazë peshku. Shumëllojshmëri verërash të kantineve më të njohura italiane. Në fundjavë muzikë e zgjedhur Live, nga këngëtarë të talentuar të muzikës Blues dhe Jazz.



*Wild culinary cuisine, village produce and every Friday fish-based menu. Variety of wines of the most popular Italian canteens. At the weekend, Live music, from talented singers of Blues and Jazz music.*




Rr. Reshit Collaku Nr. 42, 1001 Tirana, Al  
 Tel: +355 4 562 9663  
 Mpb: +355 69 57 75 100  
 FB: PATA NEGRA Tirane





# HOTEL ARGJIRO

*Welcome to the heart of Gjirokastra!*



*Hotel Argjiro is located in the heart of historical centre of Gjirokaster city. It is situated very close to all touristic attractions like Old Bazaar, Argjiro Castle and to the numerous traditional houses that are open to visitors. It has a magnificent view from the Old Bazaar.*

*We offer for you Bar Caffe, Meeting Room, Roof Garden and many other places that can be used by our clients. Also we offer Wi-Fi, Air Conditioner System, TV, and Free Parking.*

*Your stay at our hotel will be a wonderful experience!*

## Adresa:

Rruga GjinZenebishi  
(Historic Center)  
Sheshi "CercizTopulli",  
Gjirokaster, Albania  
Tel: +355 84267022

Email: [hotelargjiro@gmail.com](mailto:hotelargjiro@gmail.com)

[reservation@hotelargjiro.al](mailto:reservation@hotelargjiro.al)

Web: [www.hotelargjiro.al](http://www.hotelargjiro.al)



Administrator: Florian Baba

Kryeredaktor:  
Irhan Jubica

Koordinatorë:  
Flora Xhemani Baba

Konsulentë  
Arjan Konomi  
Sophia Clingenberg

Gazetare:  
Irena Kanani

Bashkëpunëtorë:  
Arben Kola, Ardiola Alikaj, Adrian Mitrovasilii, Agro-Web, Aigin Teqja,  
Aleksandër Filipllari, Anila Çuçllari, Anne Slater - Brooks, Artur Guni, Ermir  
Hoxha, Eltjana Shkreli, Ismail Hoxha, Florika Rodakaj, Jona Kuka, Lazjon  
Petri, Matilda Guçi, Kastriot Faci, Piro Katundi, Rezarta Delisula, Vladimir  
Dedndreaj, Nada Drita, Soraldo Nebo, Zyhdë Shehi,

Fotografia: Adis Shera, Albania Adventure, AST Elbasani, Artur Guni, Blue  
Albania, Ina Toska, Marsel Çoçoli, Klubi Discover Albania, Mario Gjini,  
Kastriot Faci, Shkëlzen Rexha

English:  
Jona Kuka

Designer:  
Anisa Kaso, Adriatik Baba

Marketingu  
Blue Agency

Distribucioni:  
Shqipëri: Adrion L.t.d,  
Posta Shqiptare  
Kosovë: Rilindja, Buzuku  
Maqedoni: TDS Kiosqe Sh.p.k.

Përgjegjës botimi për Maqedoninë  
TDS Kiosqe Sh.p.k.

travel

magazine

Blv. Bajram Curri, P. Agimi, Nr. 14/260  
Tel: +355 68 40 17 309  
Email: revista@albaniantravel.info  
Web: www.albaniantravel.info

## Mos humbisni / don't miss:

### *Të dashur lexues!*

*E keni vënë re që sa herë vjen vjeshta, shtohet dëshira për udhëtime në natyrë? Si të thuash, duke qenë se përgjithësisht e mbyllim historinë me detin, mendja të shkon tek lojrat e mrekullueshme që vjeshta bën me natyrën dhe tek bukuritë e pafundme që kemi nëpër të gjithë Shqipërinë. Dhe në fakt në këtë periudhë kemi udhëtuar vërtet shumë, për t'ju sjellë më të mirën e vjeshtës që ofron Shqipëria, kemi qenë nëpër bujtinat zemërbardha të Veriut, ku mikpritja të përplot, kemi shijuar zahiretë dhe atmosferën magjike të Juglindjes, kemi shijuar Vlorën ndryshe, ju kemi ofruar një Sarandë vjeshtore, një Berat 2400 karatësh, kemi sjellë përvojat e jashtëzakonshme të bashkëpunëtorëve tanë që si asnjëherë tjetër, kanë qenë pjesë aktivitetesh kombëtare e ndërkombëtare vërtet të rralla. E siç mund të kuptohet, duke qenë se vjeshta është edhe stina e begatë e ushqimit të mirë, ju kemi ofruar si rrallëherë një buqetë përvojash gastronomike të pazëstueshme. Nuk e teprojmë po të themi se ky numër i Travel Magazine është vërtet i begatë, mos ngurroni t'ia shijoni frytet!*

## e Vjeshtës 2017

Destinacionet

# Autumn

destinations

### *Dear readers!*

*Have you noticed that whenever autumn comes, is there a desire to travel in nature? To put it, as we generally close the story with the sea, mind goes to the wonderful games that autumn makes with the nature and endless beauties we have throughout Albania. And indeed, in this period we have traveled really a lot, to bring you the best of autumn that Albania offers, we have been in the warm welcoming guest houses of the North, where the hospitality astounds, have tasted the magical atmosphere of the Southeast, have tasted a different part of Vlora, we have offered to you a little Saranda in autumn, a 2400 years-old precious golden Berat, we have brought the extraordinary experiences of our collaborators who have been part of the truly rare national and international activities. And as you can understand, since autumn is the prosperous season of good food, we have offered as rarely before it, bunch of irresistible gastronomic experiences. An in this point, we can say that this Travel Magazine issue, is really prosperous, do not hesitate to enjoy the fruits!*

Partners:



Albanian American  
Development Foundation



giz  
Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



10 Nëntor - 29 Dhjetor

## Muzeu im

*Çdo të Premte, Muzeu Historik Kombëtar fton qytetarët të marrin objektet e vjetra të trashëguara nga paraardhësit dhe t'i prezantojnë ato në ambientet e Muzeut, duke u bërë kështu pjesë të projektit "Muzeu im". Në fund të ditës, objektet do të merren sërish me vete.*



# KOPLIKU TRAVEL

Shkodër, Albania

*Udhëtoni me mjetet  
tona luksoze e  
komode drejt të gjitha  
destinacioneve në  
Europë!*

*Me Kopliku Travel....  
udhëtimi juaj merr vlera...*

***Touristic Transport  
in Albania and Europe***

**Transport turistik brenda  
dhe jashtë Shqipërisë**

- Bileta avioni, trageti dhe autobusi
- Udhëtime turistikë
- Transport turistik
- Rezervime hoteli në të gjithë botën
- Agjenci imobiliare
- Sigurancione
- Shërbim Taksi



Shkodër, Albania, pranë Teatrit "Migjeni";  
Tel: +355 682031125;  
+355 682031124; +355 674447720;  
0222 50370; [koplikutavel@yahoo.it](mailto:koplikutavel@yahoo.it)



Vlora Albania



[www.reginacity.al](http://www.reginacity.al)

# REGINA CITY HOTEL



Hotel Regina City was born with the commitment to the good, the beauty and passion. Regina City Hotel is located in the City of Vlora with a position and structure that makes it one of the modern city environments, just 5 m far from the sea, with its privat beach, 1000 m from "Pavarësia" square and 2000 m from "Flamuri" square. With a relaxing sea-hill panorama, where the pool is located with a lounge bar and restaurant with Mediterranean cooking. No doubt that your vacation will be even more special at Regina City. Welcome !



"Pavli Flloko" Str. "7 Pallatet"  
Uji i Ftohtë, Vlorë, Albania  
Tel: +355 (0) 33 407 600  
E-mail: [info@reginacity.al](mailto:info@reginacity.al)  
web: [www.reginacity.al](http://www.reginacity.al)



CITY ★★★★★



## NË SHIFRA

80.000.000.000

dollarë është investimi që Arabia Saudite do të bëjë në Mekë deri në 2030, për të rritur me 20 milionë numrin e vizitorëve në këtë vend që siguron 1/3 e të ardhurave nga turizmi fetar.

9.000.000

vizitorë në vit do të presë Shqipëria brenda 2031. Sipas Fondit Shqiptar të Zhvillimit, paralel me zgjatjen e sezonit deri në 10 muaj, vetëm në Alpet Shqiptare turizmi do të rritet deri në 29%.

40.000

ndërtesa të stilit Bauhaus, pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s që nga viti 2013, numërohen në kryeqytetin e Izraelit, Tel Aviv, njohur ndryshe edhe si Qyteti i Bardhë.

3.500

vizitorë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar zgjodhën Gjirokastrën në 6-mujorin e parë të këtij viti. Ndërsa Kalaja e Beratit numëroi mbi 52 mijë vizitorë nga Janari deri në Gusht.

240

milionë euro, ose 2% të PBB do të jetë huamarrja e qeverisë shqiptare në vitin 2018, por sipas medias, borxhi publik do të ulet nga 70.2% në 68%, për shkak të rritjes ekonomike.

76

përqind e vizitorëve të Shkodrës gjatë këtij sezoni, vinin për herë të parë në këtë qytet. Sipas një hulumtimi të shoqërisë civile, 65% e tyre do ta vizitonin prapë qytetin.

3

janë sektorët ku biznesi amerikan dëshiron të investojë në Shqipëri: turizmi, energjia dhe financat. Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri kërkon klimë më të mirë biznesi.



Gjatë përgatitjeve për ekspozitën "Arkitektura Tradicionale - Kullat" të organizuar nga GIZ dhe G02 në Tiranë

**EDIT**

# Come to my home

**Irhan Jubica**

I përhershëm në strategjitë kombëtare të turizmit, qëkur këto nisën të hartoheshin, turizmi bregdetar mund t'i ketë sjellë Shqipërisë të ardhura të konsiderueshme, sepse shumica e frekuentuesve të plazheve tona ishin shqiptarë nga jashtë kufijve. Mirëpo sikurse e kemi thënë që në editorialin e numrit të parë të revistës Travel (Maj 2011), shtegtimi patriotik i kosovarëve drejt Shqipërisë po ulet gradualisht, e këtë e konfirmoi edhe INSTAT, sipas të cilit, vetëm gjatë Korrikut 2017, në krahasim me një vit më parë, në vendin tonë erdhën 33% më pak pushues nga Kosova. Në jo pak raste të zhgënjyer nga diferencimi në shërbime, dyndja e tyre krijoi idenë e një turizmi të përjetshëm, duke e shtyrë biznesin e ndërtimit drejt një krimi thuajse të pazhbëshëm: shëmtimin e qyteteve. Metastazat e betonit e kanë zgjeruar shkatërrimin mjedisor në secilën perlë të banuar përgjatë 400 km bregdet, duke i kthyer disa prej kryeqendrave, si Durrësin, Vlorën dhe Sarandën, në qytete fantazëm me përbindësia - bunkerë të frikshëm që hanë pyje dhe male e në të cilat, në këtë Tetor të ngrohtë, nuk gjendej turist që të ndizte një dritare, ndërsa ne pretendojmë zgjatjen e sezonit turistik deri në 10 muaj. Dhe nëse komentet negative të turistëve të huaj në TripAdvisor duken dashakeqe, një natë e kaluar në të ashtuquajturat hotele të bregdetit kundrejt kushteve dhe çmimeve të papërshtatshme, është provë se sa jostrategjike vazhdojnë të jenë investimet e biznesit të betonit në territorin e një shteti që nuk arrin ta shtrijë sovranitetin e tij territorial, në kuptimin më të drejtpërdrejtë të fjalës.

Kësisoj, ngjan më shumë se ironik mendimi që rekomandimi i Këshillit Botëror të Udhëtimeve dhe Turizmit (World Travel & Tourism Council - WTTC) se "autenticiteti është pika më e fortë e turizmit shqiptar"

i referohet situatës së mësipërme. Me Beratin, Gjirokastrën, Iso-Polifoninë, (Lumin e Gashit dhe Shebenik-Jabllanicën), e sidomos Butrintin në UNESCO, autenticiteti do të duhej të reflektohej edhe në draft-Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit 2017-2022, duke orientuar sa më shumë kapacitete të të gjitha llojeve drejt theksimit dhe shfrytëzimit për mirë të këtij tipari të turizmit shqiptar. Nga ana tjetër, duke tentuar të mashtrojë opinionin me pëlqimin e paqenë të UNESCO-s, Ministria e Kytyrës arsyeton betonizimin e Butrintit me nevojën e plotësimit të kushteve që kërkojnë vizitorët e më të mirit park shqiptar. Diçka jo fort e ndryshme nga velierat, sheshskënderbejt dhe lungomaret e deritashme. Mirëpo turistët e huaj, konsumatorët më të mëdhenj të turizmit kulturor (kryesues dhe me rritje vjetore rreth 17%) vlerësimet më pozitive i kanë pikërisht për autenticitetin tonë, duke e mirëkuptuar kontekstualisht mungesën e luksit, bie fjalla, në bujtinat e Alpeve Shqiptare. Gati të mrekulluar prej mbijetesës së traditës dhe mënyrës së jetesës të bukurive tona të rënda - siç i quajtën çifti Benzenberg-Klosi - turistët e huaj përbëjnë, sipas Planit Kombëtar Sektorial të Turizmit për Rajonin e Alpeve Shqiptare të përgatitur me mbështjetjen e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) - 67% të vizitorëve në 860 km<sup>2</sup> të këtij Parku Kombëtar. Falë metodës ekonometrike të Delphit, FSHZH parasheh që numri i vizitorëve në Alpe, nga rreth 69 mijë në 2017, të shkojë në mbi 570 mijë në vitin 2031. E shoqëruar edhe me zgjatjen e sezonit turistik, kjo do të thotë se nga rreth 3 mijë shtretër sa ka aktualisht në të gjithë Alpet Shqiptare, deri në vitin 2031, (kur Shqipëria do të presë rreth 9 milionë turistë në vit), duhet të sigurohen gati 30 mijë shtretër për mbi 2.5 milionë netëqëndrime.

**Vijon në faqen 32**



## Skulptori Arben Bajo, ekspozitë personale në galerinë FAB

### Ermir Xh. Hoxha



Skulptura e Arben Bajos e nis rrugëtimin e vet në fundvitet '80, atëherë kur këmbanat e komunizmit internacional po binin fuqishëm anembanë kampit të Lindjes. E ndërtuar në atelietë e Akademisë së Arteve në Tiranë, skulptura e Bajos guxoi të ishte ndryshe në ato vite kur edhe studentë të tjerë shqiptarë po vinin në diskutim gjuhën plastike, e stereotipale të metodës së Realizmit socialist. Sot, pas tridhjetë vitesh dhe një numri të madh ekspozitash personale e kolektive sa brenda e jashtë vendit, Bajo ofron një produkt të shumfishtë pa e humbur atë gjuhë plastike të ngjizur në atelietë akademike. Dallohen mes tyre lehtësisht "Raftet", struktura prej allçie, ku përmbliidhen si në një melting pot në miniaturë të gjithë format skulpturore të krijmtarisë së tij ndër vite. Konceptuar si një ikonostas personal i një krijmtarie në fazë muzeale, në to gjejmë nudo, portrete, kuaj lakonikë apo copëza projektesh të prekura në kohë. Në këtë seri artisti merr dhe rimerr nga vetja, duke ricikluar format si metamorfozë e shenjës dhe prekjes së tij, ndoshta në kërkim të një faze nostalgjike përmbyllëse, e cila si duket qëllimisht nuk arrihet kurrë. Qendër e krijmtarisë së tij gjatë viteve të fundit mbetet figura njerëzore, sidomos portreti e nudot, të cilat ofrohen si hetim i drejtpërdrejtë i artistit njëherazi sa mbi psikologjinë e personazhit, aq dhe mbi vetë realitetin që e rrethon.

Prezent në ekspozitën e tetë personale në Galerinë FAB, format skulptorike të Bajos e ftojnë shikuesin deri më 10 Nëntor, në një dialog psikologjik mes formës dhe subjektit, si për të përforcuar shprehjen se arti ndryshon shikimin tonë mbi veten aq sa dhe mbi botën.





# ALB TRAVEL

TRAVEL AND TOURS

- Bileta avioni,*
- Bileta autobusi,*
- Bileta trageti,*
- Paketa turistike,*
- Udhëtime individuale,*
- Siguracione shëndeti në udhëtim*



**Adresa:**  
Lagjja "Vojo Kushi",  
Rruga "Qemal Draçini", Shkodër  
Tel: +355 68 85 34 130;  
068 85 60 436; 0696095859  
Email: albtravelsales@gmail.com



*Operon edhe me tre zyra të tjera me shërbime  
si këmbim valute,  
Moneygram, pagesa tregtare, shlyerje faturash  
të OSHEE,  
pagesa gjobash (automjetesh),  
në adresat si më poshtë:*



**SHFT08 /1**

Lagjja "Vasil Shanto", Rr. "Vaso Kadia", Shkodër  
Tel: +355 69 20 61 467  
E-mail: shft08@hotmail.com



**SHFT08 /2**

Bulevardi "Zog i Parë", Shkodër  
Tel: +355 69 26 55 107  
Email: jeta.murati3@gmail.com



**SHFT 08 /3**

Lagjja "Vasil Shanto", Rr. "Vaso Kadia", Shkodër  
Tel: +355 66 32 23 335  
Email: shft082@gmail.com



# Qindra udhërrëfyes huaja vijojejnë punën

Udhërrëfyesit (guidat) turistike në Shqipëri janë një profesion relativisht i ri, sikurse edhe sektori i turizmit. Megjithatë, vitet e fundit nuk kanë munguar përpjekjet për rritjen profesionale, sasiore por edhe për institucionalizimin e këtij profesioni, qoftë nga autoritetet shtetërore, po ashtu edhe nga organizatat e shoqërisë civile, të impenjuara drejtpërdrejt me turizmin. Megjithatë, pavarësisht diplomave ndërkombëtare të pak individëve, vetë Ministria e Turizmit certifikimet e guidave të para kombëtare turistike i kreu përpara nisjes së sezonit turistik 2017. Kështu, në Shkurt u certifikuan 159 guida kombëtare, ndërsa disa muaj më vonë edhe 52 guida të tjera kombëtare. Zyrtarisht, ministria e atëhershme e Turizmit, znj. Milva Ekonomi, se janë certifikuar 199 udhërrëfyes kombëtar, 12 prej të cilëve zotërojnë edhe certifikatën e specialitetit të veçantë. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e NATGA-s deklarojnë 252 guida kombëtare të certifikuara. Megjithatë, lista zyrtare e publikuar në faqen e Ministrisë së Turizmit, përmban vetëm emrat e 115 udhërrëfyesve kombëtare, në mesin e të cilëve janë edhe 7 guida të huaja, certifikata e të cilëve si udhërrëfyes kombëtar në Shqipëri - si e të gjithë të tjerëve - skadon më 30 Shtator 2018.

Certifikimi i këtyre guidave u bë sipas Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të datës 24 Janar 2017, ku përcaktohen edhe kriteret e akreditimit të programeve të kualifikimit të këtyre udhërrëfyesve. Sipas Udhëzimit, programet për guidat kombëtare përmbajnë njohuri nga mjedisi fizik dhe natyra; gjeografia humane dhe zhvillimi shoqëror e urban; arkeologjia, prehistoria dhe antikiteti Shqipërisë; historia e Shqipërisë; diversiteti kulturor; arti & arkitektura; kohët moderne; praktika dhe mësimi në terren, si dhe njohuri mbi teknikat e guidimit, aftësi biznesi dhe kushtet e

Vijon në faqen 18 ►

## Pyetjet për forumin

1. Në çfarë konsiston detyra e një guide professioniste të licensuar?
2. Prej sa kohësh operoni si guidë turistike?
3. Sa grupe/turistë shoqëroni gjatë një viti?
4. Sa është numri i guidave profesionale të licensuara në Shqipëri ose/dhe jashtë?
5. Sa guida të tjera, kombëtare ose/dhe lokale ushtrojnë aktivitet të palicensuar?
6. Nëse nuk jeni një udhërrëfyes i licensuar, a ju ka penguar kjo në punën tuaj?
7. Sa është numri i guidave të huaja që veprojnë sezonalisht në vendin tonë? Sa prej tyre janë të certifikuar nga autoritetet shqiptare dhe cili është dëmi që i shkaktojnë turizmit shqiptar?
8. Në fund të Qershorit të këtij viti, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Turizmit nxori një urdhër, sipas të cilit "asnjë person nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e udhërrëfyesit turistik në territorin shqiptar pa u pajisur me certifikatën përkatëse nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes". Sa raste të shkeljes së këtij urdhëri keni paraqitur pranë Task Forcës për Turizmin gjatë këtij sezoni?
9. A është i mundur një formalizim i sektorit të guidave turistike?
10. Në disa prej faqeve të profilizuara të internetit (toursbylocals, viator etj) numërohen më pak se 50 guida professioniste (shqiptarë dhe të huaj) që operojnë në Shqipëri. A mendoni se kjo ofertë online e përballon kërkesën?



Arben Kola

1. 7 vite.
2. Varet nga lloji i turit dhe sa ditorë mund të jetë. 10 deri në 15.
3. Diku te 200 persona.
4. Ndoshta 100 deri në 150.
5. Po.
6. Po.
7. Guidat e huaja që veprojnë në vendin tonë janë rreth 10 persona, ndërsa vetëm 5 prej tyre janë certifikuar nga pala shqiptare. Mendoj se dëmi që na shkaktojnë është thjesht në vendet e punës.
8. Asnjë, pasi duhet të jetë në xhiro në Tiranë, Berat dhe Gjirokastrë.
9. Po.
10. Jo.



# të certifikuar, por guidat e në sitet turistike shqiptare



## Florika Rodakaj

**1.** Një guidë profesionale e licensuar kërkon një bagazh kulturor të përgjithshëm, si dhe një përgatitje në sektorin e turizmit në Shqipëri. Guida duhet të jetë e njohur nga institucionet kompetente dhe të ketë një eksperiencë në këtë fushë. Do të ishte mirë që të kishte një bashkëpunim me aktorët e fushës së turizmit, si hotele, restorante, varka, destinacione turistike etj., që të lehtësonin punën e tij, duke i ofruar shërbime falas. Guida duhet të shquhet për profesionalizëm dhe si ndërmjetës kryesor midis turistit - trashëgimive kulturore - agjencisë që e punëson.

**2.** Operoj prej 5 vitesh si guidë turistike.

**3.** Në mesatare momentalisht arrijmë të organizojmë deri në 25 grupe.

**4.** Nuk jemi në gjendje të vendosim një numër për këtë figurë profesionale.

**5.** Ne mundohemi që të promovojmë guidat e licensuara, por nga eksperiencia vëmë re se raporti mund të jetë 40/60 (40% të palicensuara).

**6.** Mendoj se që nga njohja e guidës si profesion dhe pajisja e tyre me licensa, ka krijuar vështirësi fakti i të mos qenit i licensuar.

**7.** Dëmi që mund t'i shkaktonte turizmit shqiptar do të ishte ulja e punësimit të guidave shqiptare nga agjencitë e huaja dhe prezantimi jo i denjë i vendit tonë te turisti, nëse informacioni i tyre nuk dotë ishte të përshtatshëm. Gjithsesi, ka guida të huaja, që duke njohur mirë kulturën e turistit të huaj, janë në gjendje ta prezantojnë në mënyrë fantastike vendin tonë. Prandaj kërkohet jo vetëm një përgatitje gjuhësore nga guidat shqiptare, por mbi të gjitha kulturore, pasi çdo kulturë ka mënyrat e veta të komunikimit.

**8.** Mendoj se ende ka raste të shumtë. Gjithësesi kemi vënë re se shumë guida të licensuara janë më pak të përgatitura se shumë guida të palicensuara.

**9.** Shpresoj që të jetë i mundur një formalizim si në anën praktike, por edhe atë financiare. Vështirësia e një agjencie turistike momentalisht është fakti që detyrohet të angazhojë guida të licensuara (me rrezikun që të jenë jo shumë të përgatitura) dhe të mos jenë në gjendje të deklarojë pagesën e tyre. Në momentin që një guidë ushtron profesionin e tij, duhet patjetër të jetë i pajisur me një NIPT dhe të lëshojë fatura për shërbimin që ofron. Nga ana tjetër është fakti se guidat shqiptare kërkojnë një shpërblim nga 70-130 euro dita, goxha superiore nëse mendojmë se jemi në Shqipëri dhe jo në vendet e BE-së.

**10.** Nuk mendoj se e përballon kërkesën, sidomos në vitet që vijojnë.

## Piro Katundi

**1.** Detyra e një guide profesionale konsiston në realizimin me sukses të një udhëtimi në një destinacion të caktuar. Ku një turist të marrë më të mirën e mundshme nga udhëtimi, qoftë nga komoditeti i itinerarit të ndjekur, qoftë nga informacioni i plotë mbi historinë, kultrën dhe natyrën e vendit që po vizitohet.

**2.** Operoj si guidë turistike prej 3 vitesh.

**3.** Gjatë një viti shoqëroj rreth 25-30 grupe turistike.

**4.** Numri i guidave profesionale të licensuara në Shqipëri për momentin është rreth 250, nga të cilët jashtë vendit operojnë rreth 20-30 guida.

**5.** Mund të jenë rreth 200-250 guida të tjera të palicensuara në Shqipëri, duke marrë parasysh që certifikimi është një proces që u bë rishtazi dhe guidat që operojnë kanë një kohë relativisht më të gjatë në treg.

**6.** Nuk mund të shprehem tani për vështirësitë si guidë e

palicensuar, pasi e disponoj licensën, por edhe më herët kur nuk ka ekzistuar certifikimi kam pasur certifikata dhe trajnime të tjera si udhërrëfyes. Nga ana tjetër edhe shteti nuk ka penguar në një gjë të tillë, duke qenë se kohët e fundit realizoi certifikimin dhe licensimin.

**7.** Sipas ligjeve shqiptare, çdo grup turistik i huaj që vjen në vendin tonë duhet të jetë i shoqëruar nga një udhërrëfyes shqiptar. Kjo për 2 arsye: ndikon negativisht në ekonominë e vendit tonë dhe nga ana tjetër, një turist i huaj duhet të informohet për

historinë e vendit tonë ashtu si është realisht dhe jo ashtu si mund ta kenë të mësuar nga shteti i vet. Aktualisht ka disa grupe të huaja që operojnë në vendin tonë, por besoj që shumë shpejt do rregullohet kjo gjë.

**8.** Unë, duke e disponuar licensën dhe duke qenë brenda rregullave të ministrisë përsa i përket ushtrimit të profesionit si udhërrëfyes profesional, nuk më ka interesuar të merrem me çështje dhe raste të shkeljeve, pasi nuk kam hasur; mbi të gjitha interesohem të bëj sa më mirë punën e udhërrëfyesit.

**9.** Sigurisht që formalizimi është i mundur. Si në shumë vende të botës së zhvilluar ku funksionon shumë mirë, edhe në Shqipëri ndryshimet e fundit do të japin rezultate pozitive në këtë drejtim.

**10.** Janë rreth 250 guida të licensuara në Shqipëri për momentin, pavarësisht se në adresa të tilla numri mund të jetë më i vogël. Gjithsesi, duke qenë se aktualisht, në tregun shqiptar janë rreth 500 guida, duke përfshirë edhe ata jo të licensuar, besoj se janë më se mjaftueshëm dhe e përballojnë më së miri kërkesën për udhërrëfyes. Në të ardhmen, me rritjen e kërkesës, do të shtohen edhe guidat.

## Qindra udhërrëfyes të çertifikuar, por guidat e huaja vijnë punën në sitet turistike shqiptare

► Vijnë nga faqja 22

punës; ndihma e shpejtë etj.

Më specifike kërkesat janë për guidat e specialitetit të veçantë, ku përveç njohurive për specialitetin e veçantë, udhërrëfyesi duhet të ketë edhe aftësi fizike për t'i ofruar turistit "në kushte të larta sigurie, një eksperiencë unike lidhur me temën/objektin e veçantë, duke interpretuar me saktësi të gjithë informacionin rreth kësaj teme/objekti dhe duke prezantuar me vërtetësi aktualitetin".

Një kategori tjetër janë udhërrëfyesit lokalë, dhjetëra prej të cilëve janë çertifikuar deri tani, ndërkohë që trajnimet vazhdojnë.

Sa i takon Kodit të Etikës, NATGA shkruan se një udhërrëfyes turistik duhet të jetë i sjellshëm, miqësor dhe i afrueshëm; të respektojë besimin fetar të çdo turisti; të respektojë zakonet etike të çdo turisti; të jetë i kujdesshëm ndaj nevojave të çdo turisti; të jetë i ndërgjegjshëm për sigurinë e çdo individi; të jetë gjithmonë në kohë; të jetë i besueshëm dhe i ndershëm; të kujdeset për higjienën personale; të vishet në mënyrë të përshtatshme. Gjithashtu, gjatë ushtrimit të profesionit, një guide i ndalohet shitblerja e çfarëdo produkti nga turisti për qëllime përfitimi, si dhe dallimet diskriminuese ndaj turistëve për motive race, gjinie, etnie, kombësie, aftësi fizike apo moshës. Sipas Kodit të Etikës, guida duhet të jetë i vëmendshëm dhe i përgjegjshëm në çdo situatë të mundshme rreziku e madje të mos i japë asnjë mjekim turistit pa u këshilluar më parë me mjekun. Ai duhet të jetë i paanshëm dhe pozitiv, duke komentuar çdo fakt apo ngjarje në mënyrë objektive, duke dhënë informacion të saktë dhe joparagjyqës për asnjë arsye. Një guide duhet të përpiqet të zgjidhë me përgjegjshmëri çfarëdo situatë konflikti, si dhe të raportojë çdo incident, dëmtim apo raste fatale pranë autoriteteve më të afërta. Edhe kur nuk është duke e ushtruar profesionin, udhërrëfyesi turistik duhet të respektojë historinë, natyrën, trashëgiminë kulturore e shpirtërore si dhe traditat e popullit shqiptar, duke u përpjekur të përçojë në formë edukuese të turistët trashëgiminë

Vijnë në faqen 20 ►



### Ardiola Alikaj

#### NATGA

**1.** Guida profesioniste e "çertifikuar" do të ishte termi i saktë i parashikuar nga ligji, ka për detyrë të udhërrëfjeje një grup vizitorësh në gjuhën e përzgjedhur prej tyre, të interpretojë trashëgiminë kulturore dhe natyrore të vendit të tij në normat më të larta të etikës profesionale, dhe të jetë i pajisur me kualifikimin përkatës nga instancat e akredituara.

**2.** Unë operoj si guide turistike që prej vitit 2000.

**3.** Natyra e grupeve që unë kam udhërrëfyer dhe kohëzgjatja e tureve kanë qenë në ndryshime dinamike nga viti në vit, por nëse vendos një mesatare të përafërt, mund të them se variojnë mes 25 - 40 grupe/vit.

**4.** Numri i guidave të çertifikuara nga MZHETTS nga 3 fazat që prej muajit Shkurt deri në Korrik është 252. Dua të specifikoj se ligji kërkon çertifikim vetëm për udhërrëfyesit të cilët operojnë brenda territorit shqiptar, dhe nuk është i detyrueshëm për "shoqëruesit në udhëtim" të cilët shoqërojnë grupet jashtë territorit shqiptar, mirëpo në kushtet e variantit të fundit, ata nuk janë më udhërrëfyes por vetëm shoqërues në udhëtim. Po ashtu çertifikimet e bëra jashtë Shqipërisë kanë nevojë për "akreditimin" sipas ligjit shqiptar, por mund të them se është një numër i limituar i udhërrëfyesëve të çertifikuar jashtë shtetit.

**5.** Kjo është një përgjigje të cilën nuk jam në gjendje t'ju jap. Çertifikimi pikërisht se është një proces i gjatë ka fazën e tij tranzitore, e cila sapo ka filluar.

**6.** Unë jam udhërrëfyesë e licencuar me kategorinë kombëtare, por kam informacion nga kolegë të mi, të cilët nuk arrijnë për arsye të ndryshme t'i nënshtroheshin procesit të çertifikimit provizor, të cilëve ju ka krijuar pengesa serioze mospajjsja me certifikatë në këtë sezon.

**7.** Numri i udhërrëfyesëve të huaj që operojnë sezonalisht në Shqipëri nuk dihet saktësisht. Nga MZHETTS janë çertifikuar faktikisht udhërrëfyes të huaj të cilët jetojnë dhe punojnë në Shqipëri të pajisur me leje pune (sikurse në fakt e kërkon për ta ligji për udhërrëfyesit turistikë). Mospajjsja në vijim e udhërrëfyesëve të huaj me certifikatë, sjell dëme të parik-

uperueshme për turizmin shqiptar, sepse jemi në fazën e ndërtimit të profilit tonë turistik, dhe atë çka kemi autentike, një vizitor mundet vetëm ta "prekë" nga sytë e një udhërrëfyesi i cili jeton dhe punon në këtë vend çdo ditë, i cili shikon ndryshimet jo vetëm në urbanistike e arkitekturë por edhe në shpirtin e kombit tonë. Gjëra të cilat nuk t'i mësojnë dot as librat apo përmbledhjet akademike që dikush mund të shfrytëzojë si burime informacioni.

**8.** Pasi xhori urdhëri e sipërpërmendur, Task Forca e Turizmit filloi një fushatë informimi në të gjithë sitet, muzetë apo pikat e tjera turistike, përfshirë edhe ato ku fitare. Kjo fushatë nuk pati qëllim trajtimin me agresivitet të çështjes apo penalizimin e sa më shumë udhërrëfyesëve gjatë ushtrimit të këtij profesioni, por njihjen e tyre me faktin që ky urdhër po fillonte zbatimin e menjëhershëm. Nga ne si NATGA janë komunikuar jo më shumë se 2 raste pranë MZHETTS, por marrim parasysh që me udhërrëfyesit që kemi të çertifikuar deri tani, ne nuk kemi kapacitete të mjaftueshme për ta mbuluar fluksin në rritje të vizitorëve në vendin tonë. Mangësi të thellë ne kemi për udhërrëfyes të gjuhëve me pak të përdorura si spanjisht; bullgarisht; polonisht; serbo-koratisht; madje edhe italisht. Dhe mendoj se ky sezon është përballuar me sukses nga të gjitha instancat dhe se çdo aplikim ligji apo urdhëresash do të marrë kohën e vet deri në zbatimin e plotë. Mund të përmend këtu shprehjen e famshme franceze..."Roma nuk u ndërtua në një ditë" :)

**9.** Sektori i guidave turistike tashmë është formalizuar, ajo që do të vijë gradualisht me kohën është plotësimi i të gjitha mangësive, akreditimi i kurseve të formimit profesional në operimin sa më efikas të të gjithë sistemit dhe rritja e performancës së figurës së udhërrëfyesit në treg, si një profesion prestigjioz ashtu si i takon një ambasadori të kulturës shqiptare.

**10.** Kjo ofertë që paraqisni, absolutisht nuk e përballon kërkesën për vizitat në Shqipëri. Në këto site jo detyrimisht ka qenë kërkuar të jesh i çertifikuar ose edhe nëse kërkohej, askush prej administratorëve të faqes nuk i verifikonte tipologjitë e çertifikimeve që ngarkonin në profilin e tyre këto guida. Problem ky i ngritur në Janar 2015 edhe në Konferencën e Federatës Botërore të Shoqatave të Guidave Turistike ku NATGA është anëtare me të drejta të plota. NATGA vetë ka një website i cili do të jetë në shërbim të udhërrëfyesëve të kualifikuar, çka do të thotë të kenë përfunduar me sukses kurset e formimeve profesionale si e parashikon ligji. NATGA nuk promovon dot udhërrëfyes të pakualifikuar dhe të paçertifikuar për arsye të anëtarësisë në dy prej entiteteve kryesore për këtë profesion, si WFTGA (World Federation of Tourist Guide Associations) dhe FEG (European Federation of Tourist Guides), pasi NATGA humbet të drejtën e anëtarësisë nëse promovon në faqen e internetit udhërrëfyes të paçertifikuar dhe të pakualifikuar. Anëtarësia në të dy këto entitete hap shumë dritare mundësisht punësimi, pasi rrjeti i udhërrëfyesëve të kualifikuar ndërvepron në mënyrë të suksesshme mes vetes në rang europian dhe botëror.

## Lazon Petri

**1.** Bërja me dashuri e punës. Përditësimi i vazhdueshëm i të dhënave dhe njohurive në lidhje me trashëgiminë kulturore dhe natyrore. Përsosmëria dhe pasuria e shqipes dhe e gjuhëve të tjera të huaja të zotëruara. Mbajtja e përgjegjësive udhërrëfyese: letërkëmbim, prani njerëzore, shoqërim i denjë, përm-bushja e kërkesave hapësinore dhe kohore. Në thelb, ka të bëjë me pritje-përcjelljen e njerëzve njësoj sikur janë miqtë e shtëpisë.

**2.** Prej gati 2 vjetësh.

**3.** Mesatarisht, 3-4 grupe në muaj. Grupi mund të jetë nga dy deri në 30 veta. Përveç tyre, kam nderin dhe kënaqësinë të shoqëroj çifte apo njerëz në udhërrëfime të specializuara.

**4.** S'e di.

**5.** As këtë s'di ta them.

**6.** Të qenit i linçuar në punën e udhërrëfyesit ka përmasën shoqërore dhe atë vetjake. Përmasa e parë, ajo shoqërore, ka të bëjë me marrëdhënien që ne krijojmë me shoqërinë dhe me shtetin. A jemi të ligjruar? A paguajmë taksa? Sigurancione? Edhe ana tjetër e monedhës: shoqëria është më e vërtetshme kur ne punojmë në të zezë apo në të bardhë? Mund të ndodhë që, teksa trumbetojmë Shqipërinë turistike, grupe njerëzish të bien në duar shoqëronjësisht të paafte. Por, a do të ishte e drejtë që të binin në duar njerëzish keqbërës? Sado që sot, teknologjia e informacionit e ndan grurin nga egjra, licensimi ndihmon në mishërimin e shoshës që lipset për këtë punë. Përmasa tjetër, ajo vetjakja, ka të bëjë me marrëdhënien e udhërrëfyesit me veten dhe të tjerët, me vetëbesimin që vetiu i shtohet udhërrëfyesit nga një licensim shtetëror. Kjo përmasë, vetjakja, ka të bëjë edhe me shtimin e mundësive që udhërrëfyeni në fjalë të brumoset edhe më tepër profesionalisht. Kështu që sido që ta kapësh, moslicensimi, pa bukë nuk të le, por që të pengon, të pengon.

**7.** Nuk kam të dhëna në këtë lëmë për t'ju thënë numrin e saktë. Do ju jap vetëm një shembull që e mësova rastësisht këtë verë, nga një shoqja ime, Paula, që jeton në Gjermani, por që u ndodh të kalonte buzë një grupi shtetasish grekë, të cilët shoqëroheshin nga udhërrëfyesa e tyre në Korçë. Për Muzeun tonë Kombëtar të Arsimit, Shkollën e Parë shqipe u thotë: "Kjo është një shkollë e vjetër, në të cilën mësohej greqisht. Vazhdojmë më tej, me objektet e tjera..." Kaq. Jo vetëm shumë pak, por edhe pasaktësisira...

**8.** Asnjë.

**9.** Çdo gjë është e mundur. Vetëm se duhet ditur përse bëhet dhe duhet pleqëruar si të bëhet më mirë ky formalizim. Duhet të vijë si pasqyrim i vetëdijes së udhërrëfyesve, si shtrëngim institucional, apo si ndërthurje e të dyjave?

**10.** Nuk e di. Sepse uji mund të pikojë drejtpërsëdrejti tek udhërrëfyesit, por mund të rrjedhë edhe në mullinjtë e agjensive, të cilat bëjnë lidhjet mes kërkesave dhe udhërrëfyesve. Çështje menaxheriale e punës kjo, por edhe mungesë informacioni. Sado ironike të tingëllojë. Të të thahet gryka për ujë, kur pluskon mes oqeanesh.



## Eltjana Shkreli

**1.** Një guidë është një udhëheqës apo këshillues i vizitorëve që i prin nëpër atraksionet turistike apo vendet e interesit, duke jua shpjeguar dhe prezantuar. Liçensimi i një guide nënkupton një të drejtë që ia njohin edhe institucionet publike përkatëse.

**2.** Unë operoj prej 4 vitesh dhe kjo e nxitur nga pasioni për t'ua përcjellë vizitorëve, të huajve në veçanti, por edhe atyre vendas (shqipfolës) në përgjithësi, historinë dhe përjetimin e realitetit shkodran.

**3.** Mund të duket pak, por jo më shumë se 100-150 vizitorë në vit. Këtu më tepër do të ndalesha tek grupet e studentëve që shpeshherë janë studentë të mi apo vullnetarë në punë të ndryshme që operojnë në territor. Shpesh janë miq të miqve të mi, që u rekomandojnë dhe pastaj grupe të vogla turistësh që mund të më gjejnë përmes lidhjeve të shumta, kryesisht rrjeteve online.

**4.** Nuk mund të përgjigjem për këtë pyetje, pasi nuk është pjesë e interesit tim.

**5.** Mund të pohoj pa drojë që ka, kjo për shkak të një sektori të pastrukturuar ende, si turizmi. Gjithsesi dua të vlerësoj faktin që ka interes në rritje për të sjellë këtë shërbim, por kërkon përkujdesje dhe kontroll sistematik për cilësinë e ofruar. E shprehur ndryshe, të ketë aftësi të forta komunikimi, të ketë aftësi kujtese që të përcjellë historinë, të ketë aftësi improvizuese, të ketë entuziasëm, të jetë njeri me humor dhe i përpiktë, të zotërojë njohuri të mira mbi qytetin apo atraksionet dhe ta përcjellë atë me pasion. Të gjitha këto janë vokacion, përgatitje e përvetësim – pra një udhërrëfyeni është një ambasador që përcjell imazhin e një vendi e jo kushdo mund ta ushtrojë këtë aktivitet.

**6.** Pasioni nuk pengohet, përkundrazi të shtyn të zbulosh qytetin në hullitë e veta të thëna e të pathëna. Si urbaniste, pasioni im lidhet drejtpërdrejt me qytetin. Qyteti është i shtresëzuar, por unë kam preferuar të ndalem tek përjetimet e mia. Duke qenë se u rrita në pakërcyell të dy epokave (komuniste dhe postkomuniste) intrigimi më i madh më sjell ndërmendje qasjen krahasuese. Qyteti me ngjyra në sytë e një fëmije dikur dhe qyteti bardh e zi në sytë e një të rriture sot. Qyteti brenda një kuadrati i prindërve/gjyshërve të mi dikur dhe qyteti jashtë një kuadrati pa formë i një të rriture sot. Ku-

jtesa kolektive brenda familjes sime ndër breza i ka bërë vizitorët gjithmonë kurioz të më ndjekin në rrefimin e interpretimin tim 2-3 orësh tek ec me ta nëpër itinerarin e qendrës së Shkodrës. Me një broshurë plot fakte e foto të së kaluarës i ndal në hapësira publike të hapura (sheshe) ose të mbyllura (kishë, xhami, muze, banesë) duke u interpretuar botën time shpirtërore, përjetimet e mia personale të asaj çka ndjej në kohë e hapësirë. Guida urbane me titull "Komunizmi në qytetin reaksionar, Shkodër" e cek realitetin përmes propogandës në sheshet publike, fesë, persekutimit komunist të elitave të qytetit dhe përditshmërisë.

E pra kjo është më tepër se autentike dhe nuk ka liçencë që ta ndal.

**7.** Prania e guidave të huaja mbetet një shqetësim i madh, pasi sikurse e shpreha më sipër, udhërrëfyeni mbetet ambasador i vendit të vet. Nëse një udhërrëfyeni nuk i përket këtij vendi nuk ka ndjenjën e përkatësisë, pra edhe pasioni brenda tij nuk ekziston. Mungesa e pasionit dhe kulturës mbi këtë vend nëse nuk ekziston, të lejon të përqafosh përgjeshtrimin.

**8.** Me sinqeritet nuk kam paraqitur asnjë shkelje, jo sepse nuk kam evidencuar, por se nuk kisha asnjë informacion mbi mënyrën si duhej të deklarohet, kujt duhet t'i drejtohesha dhe a do të procedohej më tutje. Pa përjashtuar aspak mungesën e interesit tim personal rreth kësaj nisme, pra ta nisim nga vetja e ta kërkojmë informacionin jo vetëm të na serviret.

Mendoj që institucionet publike përkatëse duhet që të nxisin një fushatë sensibilizuese kombëtare për këtë gjë. Mendoj që rastet duhet të paraqiten jo vetëm nga vetë udhërrëfyeni, por nga çdo qytetar, pasi në këtë rast kemi të bëjmë më shkelje e nëpërkëmbje të imazhit të vendit. Përveç kësaj, vetëm kështu do të mund të rrisim ndërgjegjen qytetare mbi reagimin ndaj shkeljes dhe indirekt kuptojnë se turizmi është një sektor zhvillimi shumë i rëndësishëm për gjithë vendin, i cili krijon punësim dhe mirëqenie direkt e indirekt për këdo.

**9.** Absolutisht gjithçka është e mundur, thjesht kërkon vullnet dhe bashkëpunim të të gjithë aktorëve, sikurse edhe përmenda më lart.

**10.** Mendoj se kërkesa është gjithnjë në rritje dhe nuk mendoj që e përbalton. Por këto burime nuk paraqesin gjithmonë realitetin e terrenit. Shpeshherë udhërrëfyeni nuk rregjistrohen online, ose operojnë me rrjetet e tyre.

## Qindra udhërrëfyes të certifikuar, por guidat e huaja vijojnë punën në sitet turistike shqiptare

► Vijnë nga faqja 24

kulturore, historike e mjedisore të Shqipërisë.

Mirëpo është pikërisht kjo pikë e fundit, por jo për nga rëndësia, tek e cila disa prej udhërrëfyesve turistikë kanë vërejtje. Sikurse shihet nga përgjigjet e disa pjesëmarrësve në këtë forum të revistës Travel, udhërrëfyesit thonë se në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin e tyre guida të huaja, sipas tyre edhe të paçertifikuara nga autoritetet shqiptare. Ata thonë se këto guida mund ta dëmtojnë imazhin turistik të Shqipërisë me ose pa dashje, dmth, duke dhënë ose interpretuar qëlimisht informacion të pasaktë, ose duke mos pasur formimin dhe njohuritë e duhura për të ushtruar këtë aktivitet në vendin tonë. Shembulli i sjellë nga një udhërrëfyes korçar në këtë forum, ku një guidë e huaj u thotë grupit të turistëve duke u treguar Muzeun Kombëtar të Arsimit, se në këtë shkollë dikur mësohej greqisht, është për alarm.

Pikërisht për t'i dhënë fund një praktike dhjetërvjeçare, kur guidat e huaja turistike e ushtronin aktivitetin e tyre në Shqipëri pa asnjë kontratë e kontroll nga autoritetet shqiptare - çka nuk ndodh me një guidë shqiptare në një shtet tjetër - Ministria e Turizmit nxori një urdhëresë të posaçme në fillim të sezonit turistik. Dokumenti autorizonte Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes që të ushtronte kontroll dhe të merrte masat deri në 150.000 lekë gjobë për çdo person që mund të identifikohet duke ushtruar veprimtarinë e udhërrëfyesit turistikë në territorin shqiptar pa u pajisur me certifikatën përkatëse nga Ministria e Turizmit.

Nga ana tjetër, të pyetur për rastet e kosntatuara gjatë ushtrimit të profesionit të tyre në terren gjatë këtij sezoni, apo për denoncimin e këtyre rasteve pranë Task Forcës për Turizmin, udhërrëfyesit që morën pjesë në forumin e revistës Travel, dëshmojnë vetëm 10 raste. Mirëpo ne nuk mund të presim që turistët e huaj, me njohuritë e kufizuara për vendin tonë, të denoncojnë raste të tilla pranë autoriteteve shqiptare.



**Adrian Mitrovaski**

**1.** Guida turistike interpreton trashëgimime kulturore dhe natyrore të vendit të tij në gjuhën e kërkuar nga vizitorët. Ai është ambasador i vendit të tij dhe mbron dhe promovon vlerat e vendit me profesionalizëm dhe përkushtim.

**2.** 10 vjet.

**3.** 20.

**4.** Rreth 240.

**5.** Nuk e di, minimumi 50.

**6.** Jam i licensuar, udhërrëfyesit e palicensuar përballen me disa vështirësi

**7.** Guidat e huaja të licensuara nuk shkaktojnë dëm. Në vendin tonë, janë më pak se 10. Guidat e huaja të palicensuara shkaktojnë dëm të konsiderueshem ekonomik dhe kulturor.

**8.** Më pak se dhjetë.

**9.** Sigurisht që është i mundur, por jo në masën 100 për qind.

**10.** Jo nuk e përballon plotësisht.



**Matilda Guci**

**1.** Detyra e një guide profesioniste është që të prezantojë në mënyrën më dinjitoze vendin e vet. Të jesh një guidë turistike do të thotë të hulumtosh, të prezantosh, të shpjegosh dhe të tregosh historinë e vendit.

**2.** Prej më shumë se 6 vitesh.

**3.** Gjatë sezonit veror janë mesatarisht 170 grupe nga vende të ndryshme. Janë grupe ditore që vijnë nga Korfuzi, turistë ditore që vijnë me kroçierat që kanë Sarandën dhe Durrësin si destinacion dhe gjithashtu grupet që kalojnë pushime javore në Shqipëri.

**4.** Për territorin shqiptar janë rreth 180, ndërsa guida shqiptare të certifikuar për jashtë vendit janë jo më shumë se 15.

**5.** Duke qenë se licensimi për guidat për herë të parë u zhvillua vetëm këtë vit nga Ministria, të gjithë ata që ushtrojnë këtë profesion me seriozitet u licensuan. Guidat shqiptare që operojnë në Shqipëri janë të licensuara dhe të certifikuar. Një numër shumë i vogël mund të jetë që operon në treg të palicensuar.

**6.** U licensova në grupin e parë të të licensuarve.

**7.** Numri i guidave të huaja është i lartë dhe kjo është një çështje që vërtet na shqetëson dhe besoj jo vetëm mua. Guida të huaja të paçertifikuara dhe pa asnjë lloj kontrolli nga shteti shqiptar. Nuk mund të them se çfarë dëmi i sjellin këto lloj guidash shtetit shqiptar, por përse kohë ne nuk lejojmë të guidojmë jashtë shtetit pa një guidë vendase, pse këtë rregull të mos e ndjekim edhe guidat e huaja në vendin tonë?

**8.** Ky ligj që u shkrua duhet zbatuar. Kjo jo vetëm për të mirën e arkës të shtetit por edhe për rritjen e cilësisë së shërbimit. Fatkeqësisht guidimi nuk të jep shanse për përmirësim, pasi një grup të vjen vetëm një herë dhe ai grup largohet me ato çfarë ne u kemi dhënë, për mirë apo për keq.

**9.** Po! Guidat në Shqipëri përfaqësohen denjësisht nga NATGA, Shoqata e Guidave e cila shpeshherë organizon seminare dhe ëork shope të ndryshme për rritjen e cilësisë.

**10.** Turizmi në Shqipëri është çdo vit e më shumë në rritje dhe agjensitë/operatorët turistikë janë më të organizuarat në përgatitjen dhe pritjen e këtij fluksi. Sot në Shqipëri ka rreth 180 guida të licensuara dhe vërtet të denja për të promovuar vendin tonë në mënyrë dinjitoze.



**Aigin Teqja**

**1.** Puna e një udhërrëfyesi konsiston në përçimin e saktë të informacionit të turisti, në menaxhimin e situatave dhe ndodhive të papritura, në paraqitjen sa më të qartë të kulturës shqiptare etj etj.

**2.** Prej 3 vitesh.

**3.** Çdo vit e më shumë (vështirë të them një numër të saktë, pasi janë shumë).

**4.** Sipas MEZHETTS, janë rreth 200 udhërrëfyes.

**5.** Numër të saktë nuk di, por ka shumë.

**6.** Jam i licensuar.

**7.** Nuk di numrin e saktë, por ka goxha të huaj që operojnë në Shqipëri, të palicensuar dhe e dëmtojnë jashtë mase Shqipërinë, pasi shumica e tyre janë dashakeqës dhe aspak të informuar mbi vendin tonë.

**8.** Kjo punë i takon Inspektoriatit dhe muzeve, që të mos i lejojnë këto udhërrëfyes të operojnë në Shqipëri.

**9.** Është i domosdoshëm.

**10.** Aspak. Vendi ynë ka nevojë për më shumë udhërrëfyes, pasi numri i turistëve çdo vit sa vjen e rritet.

## Lista e udhërrëfyesve të çertifikuar\*

Emër/Mbiemër	Gjuha	Tel	Email	Emër/Mbiemër	Gjuha	Tel	Email
Alfred Kopani	Frëng	0692595601	alfredkopani@yahoo.fr	Kujtim Enesi	Gjerm	0682891579	-
Ylber Osmanagaj	Ang, Srb-Kroa	0692094854	beliadadr@yahoo.com	Laura Goxhi	Ang, Ital	0692182822	info@skanderbegtravel.com
Megi Ismailaj	Span	0693890106	megi.ismailaj@gmail.com	Luiz Seiti	Ang, Ital	0692182793	luizseiti@yahoo.com
Heldi Turhani	Greq, Ang	0665966979	helditurhani@yahoo.it	Marin Beli	Gjerm	0665738258	marinbeli2007@hotmail.com
Arben Kola	Shqip	0695871149	ben_02uk@hotmail.com	Martin Mato	Gjerm, Ital, Ang	0692339195	martinmatoalbania@yahoo.com
Ilir Hidri	Ang	0692092436	ilirhidri@yahoo.com	Nikolla Prifti	Ang, Ital	0682211453	nikkos59@gmail.com
Kledi Milloshi	Ang	0693650937	kledimiloshi@yahoo.com	Petër Trepenishti	Frëng, Rus	0692133135	petertrepenishti@live.com
Lavdosha Jaupaj	Frëng	0674175836	ljaupaj@gmail.com	Rezarta Mitro	Frëng	0692797950	rezemitro.rm@gmail.com
Gazment Sadiku	Ang	0696315858	gazisadiku@gmail.com	Rigert Çako	Ital	0693585230	rigert_cako@yahoo.com
Esmeralda Kacani	Ang	0692171943	esmeralda_kacani@hotmail.com	Thoma Nikuli	Frëng, Greq	0694048731	thoma.nikuli@prominiera.com
Ardiata Alikaj	Ang, Ital	0692164170	ardiata22@gmail.com	Vangjel Xhani	Ang	0697763047	vangjelxhani@fyahoo.com
Ol's Lafe	Ang	0662016160	olslafa@hotmail.com	Vasil Barka	Ang, Greq	0692276460	vasil.barka@gmail.com
Myzejen Çurri	Ang, Turq	0699656600	jenka26@hotmail.com	Adrian Mitrovassili	Ang	0672085011	mitrovassilia@gmail.com
Gentian Proseku	Ang	0682087253	gen-p@hotmail.com	Albana Gojani	Ang, Ital	0694042788	albana.gojani@gmail.com
Krisfor Djejesina	Polon	0673682145	djejesina@gmail.com	Andi Çoku	Gjerm, Ital	0695673876	andicoku@yahoo.com
Lenka Binxhiu	Çek, Sllovak, Ang	0675136190	lenickab@hotmail.com	Anila Angjeli	Ang	0692348222	angjelianila@yahoo.co.uk
Kliti Zeka	Ang	0672325019	klitizeka@yahoo.com	Ardit Abazaj	Ang	0683066280	aabazaj@gmail.com
Armela Memaj	Gjerm, Ang	0694388380	armelamemaj@hotmail.com	Artur Gruda	Srb	0692934849	arthur.gruda@gmail.com
Dorian Disha	Ang	0698228244	doriandisha76@gmail.com	Edvin Lamçe	Ang	0693655915	edvinlamce@hotmail.com
Sabri Ismailati	Gjerm	0694610602	sabriismailati@gmail.com	Elkierd Deliu	Frëng	0674503169	deliu_elkierd@yahoo.fr
Arben Meçe	Gjerm	0673239474	ben_mece37@yahoo.de	Erion Avllazagaj	Gjerm, Ang	0697281798	erionavllazagaj@gmail.com
Armada Molla	Ang	0694018618	armadamolla@gmail.com	Genti Bruci	Ang, Gjerm	0693214621	gent_bruci@hotmail.com
Almar Canaj	Ang, Ital	0666129924	almarcanaj@yahoo.com	Gjolek Mera	Ang	0692122555	gjolekmera@yahoo.com
Artan Koçi	Frëng	0673852747	tanikoci@yahoo.fr	Ilir Parangoni	Ang	0692175579	iparangoni@gmail.com
Bruno Ismaili	Gjerm	0693656533	brunoismaili@gmail.com	Ivi Xhufka	Gjerm	0698633409	ixhufka@gmail.com
Dhurata Memushaj	Ang, Gjerm, Frëng	0674622246	dhuratamemushaj@gmail.com	Julian Trushi	Ital	0672046263	privateguidealbania@gmail.com
Edlira Gabili	Spanj, Ang	0682943680	gabili.edlira@hotmail.com	Silvi Deçka	Rus, Span, Maq	0695852807	silviodecka@live.com
Erion Puca	Ang, Ital	0682319459	erionpuca@hotmail.com	Stavri Çifligu	Frëng	0674011810	scifligu@hotmail.com
Ermil Mullanji	Ang	0692035602	ermilm@yahoo.it	Ardit Duraku	Shqip	0672045862	arditduraku@albania-experience.al
Roland Palushi	Frëng	0682092562	rolandpalushi@yahoo.com	Artur Guni	Ang	0694799855	arturguni2005@yahoo.it
Shkëlzen Alite	Gjerm, Ang	0682060410	xalite@yahoo.de	Suela Xhyheri	Ang	0695402224	suelaxhy@yahoo.it
Junid Jegeni	Gjerm, Ang	0692475728	junid@cyclealbania.com	Etrit Taushani	Ang, Frëng, Ital	0682728114	etrittaushani@yahoo.com
Ricardo Fahrigh	Gjerm	0696731932	ricardo@zbullo.org	Elio Kromidha	Ang	0692617500	elio.kromidha@gmail.com
Dylber Alla	Frëng	0692065653	alldylber@yahoo.com	Flogert Hoxha	Shqip	0676038855	flogerthoxha@albania-experience.al
Arjola Mahmudaj	Ang, Ital, Frëng	0692930620	arjola.mahmudaj@yahoo.fr	Helis Veizi	Ang	0676038856	helisveizi@albania-experience.al
Bledar Jubani	Ang	0672313311	bledarjubani@yahoo.com	Natalia Ivanova	Rus	0698656415	tekilajzforever@rambler.ru
Demir Kroj	Ang, Ital	0692250454	demirkroi@albania.co.uk	Dritan Pengili	Gjerm, Ang	0692615550	dritanpengili@yahoo.com
Denis Agolli	Ang	0697290817	denisagolli44@yahoo.com	Mirza Betuzi	Ang, Gjerm, Srb-Kroa	0697319997	mirza_bei@hotmail.com
Dhimiter Doka	Gjerm	0684054521	dhdoka@yahoo.com	Murat Aruçi	Ital	0695746930	murataruci@hotmail.com
Dorian Gjoni	Shqip	0665763765	dorjan.gjoni@yahoo.it	Gëzim Varfaj	Rus, Ang, Frëng, Srb-Kroa	0682253261	gezimvarfaj@yahoo.com
Dorian Malaj	Ang	0684051766	incoming@sondortravel.com	Elisabeta Qevani	Gjerm	0694793497	vretoelisabeta@gmail.com
Dritan Begolli	Ang, Ital, Holl	0676037365	dritan.begolli@baths-travel.com	Sokol Kasaj	Gjerm	068 2212446	kasajsokol@gmail.com
Edmond Zhupani	Gjerm, Ang	0692029294	edmondzhupani@gmail.com	Jetmir Duraku	Gjerm	0694440893	jetmirduraku@yahoo.com
Eduart Qendrai	Frëng	0695553773	eduartqendrai@yahoo.com	Klodian Pandelejmoni	Gjerm	0672767480	klod_pandi@yahoo.co.uk
Elton Çausi	Frëng	0684058529	contact@albaniantrip.com	Mustafë Tukaj	Rus	0672562868	mustafatukaj@yahoo.com
Elton Xheka	Ital, Ang	0692326777	eltonxheka@hotmail.com	Ergys Xhikola	Shqip	0696363113	xhikola.31@gmail.com
Enea Kumi	Ang, Ital, Gjerm	0694073477	eneakumi@hotmail.com	Armand Pasho	Frëng	0673890090	armandpasho@gmail.com
Ervin Lani	Gjerm	0674136420	ervin_lani@yahoo.com	Taulant Pjetërgjokaj	Ang	0684258606	t.pjetergjokaj@gmail.com
Ervin Budo	Ang	0692276613	irvinbudo@gmail.com	Lindita Trashani	Frëng	0692282112	ditiir2001@yahoo.it
Gerion Orhani	Ang	0692154547	gerion1983@yahoo.com	Ardit Kodra	Span, Ital	0693369523	kodra.ardit@gmail.com
Gjergj Vinjahu	Ang, Ital	0692303781	gjergjvinjahu@hotmail.com	Altin Bogdani	Ang	0667077667	admin@apollon-tours.com
Halit Allkushi	Frëng	0692446042	h.allkushi@yahoo.com	Ilia Grillo	Ang	0682138223	iliagrillo10@hotmail.com
Ilir Agolli	Ang	0682078603	i_agolli@yahoo.com	Altin Skënderaj	Frëng, Ital	0672954291	askenderaj@yahoo.fr
Irina Troyanova	Rus	0699670346	tisa007@mail.ru	Ardit Zaja	Ang, Ital	0692709258	arditzaja@yahoo.com
Iva Sota	Rus	0692605955	ivasota@mail.ru	Eduart Çekoja	Ang, Frëng	0696213789	eduart_cekvoja@yahoo.com
Jetmir Molla	Span, Ang	0698755427	jetmir_molla@yahoo.com	Vasil Jorgji	Ang	0696780787	vjorgji1990@outlook.com
Klodian Lilo	Ital	0675793153	klodian.lilo@yahoo.it	Amarildo Shehu	Ang	0694751279	amarildo.shehu@gmail.com
Klodian Kushova	Ang	0696630715	klodi_k@hotmail.com	Aigin Teqja	Polon	0684669212	teqja.a@gmail.com

\*) Burimi: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (30/08/2017)



## Aleksandër Filiplari

1. Detyra e një guide profesioniste konsiston drejt qëllimit të promovimit dhe të natyrës të larmishme, kulturës dhe vlerave të ndryshme që ofron Shqipëria. Në rastin tonë fokusi kryesor përqendrohet në jug-lindje të Shqipërisë. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit dhe standardizimi i guidave janë objektivat që duhet të arrihen.
2. Koha që ne operojmë është rreth 7-8 muaj, por më shumë gjatë sezonit turistik në Pogradec.
3. Si një guidë e re, ne kemi shfrytëzuar sezonin turistik të parë dhe përafërsisht kemi shqëruar rreth 150 persona/turistë.
4. Nuk jemi në dijeni për këto të dhëna.
5. Interësi jonë është fokusuar në jug-lindje, dimë që ka disa guida lokale në qarkun e Korçës dhe guida kombëtare që operojnë në këtë zonë, por aktualisht nuk kemi të dhëna

për numrin real.

6. Për momentin nuk më ka penguar të ushtrojmë profesionin e udhërrëfyesit.
7. Guidat e huaja operojnë në territorin shqiptar. Përsa i përket rrethit të Pogradecit, më së shumti janë guidat maqedonase dhe paksa greket. Ndërkohë dëmi është se guidat e huaja nuk shfaqin vlerat apo potencialet e vërteta të rrethit të Pogradecit. Bashkëpunimi me guidat vendase nuk është në pritsmëritë e duhura.
8. Jemi në dijeni të ushtrimit të veprimtarisë së udhërrëfyesve turistikë, por ndërkohë nuk kemi paraqitur shkelje të këtij urdhëri.
9. Shpresojmë që në të ardhmen të formalizohet sektori i guidave turistike..
10. Oferta online mbase e përballon kërkesën, por duke parë që turizmi në Shqipëri sa vjen e bëhet më atraktiv, do të kërkohet licensimi i plotë i të gjitha guidave, qofshin ato online apo në terren.

Zyhdî SHEHI  
Studios

# KAVAJA,

## qyteti mesjetar me rrënjët në antikitet - Një vështrim i shpejtë historik -

Kavaja është qytet mesjetar. Në burimet historike të shkruara është përmendur në shek. XV me emërtimin "Kavalje" (viti 1431, regjistrat osmanë të sanxhakut Arvanid).

Në dokumente të shek. XVI për herë të parë është cilësuar me emrin "Borgo Kavaglia". [1]

Për etimologjinë e emrit "Kavajë" deri tani nuk kemi hasur ndonjë studim shkencor nga gjuhëtarët.

Treva e Kavajës ka qenë e banuar që në lashtësi. Kjo dëshmohet me gjetje arkeologjike të rastit, nga vëzhgime sipërfaqësore dhe rrallëherë nga sondazhe arkeologjike. Gjetjet më të hershme janë dy çekanë guri, gjetur në fshatrat Ballaj e Hajdaraj. Gjetjet e periudhës pararomake i përkasin kryesisht periudhës së vonë qytetare ilire. Në raste të rralla janë identifikuar gjetje më të hershme, si në kodrën e Qenzës, objekte qeramike të shek. VI-V para Kr. Këtu ka ekzistuar një vendbanim, i cili ka vazhduar deri në shek. IV para Kr. Po në këtë kodër, por jo në të njëjtin vend, është gjetur qeramikë e shek. III-I para Kr. Qeramikë e kësaj periudhe është mbledhur edhe në fshatrat Kryemëdhënj, Zig-Xhafaj (ku më parë është menduar se ekzistonte një vendbanim i fortifikuar, por kërkimet e fundit nuk e kanë provuar; më së shumti mendohet se ka pasur një vendbanim fshatar dhe ndoshta një kullë si pikë kontrolli e rrugës natyrore, që kalonte aty pranë); Çetë (vendbanim që ka vazhduar jetesën deri në peridhën romake); Rrakull (deri në shek. II-III pas Kr.), etj. Në hyrje të qytetit të Kavajës është gjetur një varrezë e shek. I-II pas Kr.; ndoshta ka pasur një vendbanim të hapur në zonën rrotull.

Gjurme të rrugës "Egnatia" janë zbuluar pranë fshatit Qerret, si edhe

mbetje themelesh të ndërtimeve me funksion të paqartë. Përbri kësaj rruge dhe degës që shkonte në Apoloni, u ngritën qendërbanime të reja, stacione rrugore dhe vila latifondistësh. Harta arkeologjike e zonës Kavajë-Rrogzhinë është mjaft e pasur, por këtu nuk janë bërë asnjëherë gërmime të mirëfillta arkeologjike.

Për periudhën e antikitetit të vonë gjetjet kanë qenë më të pakta në trevën e Kavajës.

Gjetjet e periudhës mesjetare janë më të shumta dhe në një territor të gjerë: Shkëmbi i Kavajës, Tilaj, Kanaparaj, Kodra e Qenzës, Çetë, Lekaj, Mlik, Kryevdh, Patk-Milot etj. Ky shtim i vendbanimeve ka vazhduar edhe pas shek. XV. Gjetjet më të rëndësishme janë fortifikimi i Kalasë së Turrës, ndërtuar nga konti Niketë Topia; magazina e kripës në fshatin Karpën dhe zbulimi së fundi aty pranë i disa strukturave të shek. XV-XVI, ndoshta, pjesë të një skele për eksportin e kripës.

Nga fundi i shek. XIII në Çetë u ndërtua kisha e Shën'e Premtes në stilin romaniko-gotik. Në zonën fushore pranë grykëderdhjes së lumit Shkumbin ruhet ende në gjendje të mire kalaja e Bashtovës, ndërtuar në shek. XV.

Nga fundi i shek. XVI Durrësi e humbi rëndësinë ekonomike të mëparshme dhe kryente funksionin e një kështjelle bregdetare, kurse funksionin e qytetit filloi ta luante Kavaja. [2]

Zhvillimin më të madh qytetet shqiptare e patën në shekujt XVII-XVIII, duke u bërë qendra tregtare e zejtare. [3]

Zhvillimi ekonomik e shoqëror i Kavajës në këtë periudhë ndihmoi dukshëm për pasurimin e tipologjisë arkitektonike të kohës dhe në rritjen e veprimtarisë ndërtimore. Ndërtesat e banimit u ngritën në të katër lagjet, ndërsa dyqanat në pazarin në qendër të qytetit, të ndara sipas zejeve. Qyteti kishte nisur të



mernte fizionominë e tij urbanistike, e cila do të zhvillohej e do të ruhej edhe në shekujt e mëvonshëm, deri aty rreth fillimit të shek. XX. [4]

Udhëtari osman i shek. XVII, Evlija Çelebi, shkruante se Kavaja ishte një qyteti i bukur në një fushë pjellore afër një mangle deti... tregu përbëhej prej 200 copë dyqanesh të rregullt, ishte i pasur në marrëdhënie tregtare e industriale, në të gjendej çdo gjë... Zotërinjtë e Kavajës i prisnin e i nderonin miqtë; populli ishte i varfër, por besnik. [5]

Tetë tregtarë kavajas (pesë muhamedanë e tre kristianë) në periudhën 1741-1800 mbanin lidhje tregtie me Venedikun, ndërkohë që për Durrësin e Vlorën numri i tyre ishte gjashtë për secilin. [6] Tregtarët kavajas sillnin mallra të shtrenjtë, sidomos manifaktura, të mëndafshita etj. edhe nga Manastiri e Stambolli. [7]

Në vitet 1735-36 në qendër të qytetit u ndërtua Xhamia kubelie, e cila me shatërvanin, portikun dhe minaren e lartë krijonin një ansambël karakteristik, që plotësohej edhe me medresenë dykatëshe përballë xhamisë. Më 1817 u ngrit kulla e sahatit.

Në vitin 1867 Kavaja u bë qendër kazaje. [8] Sipas një statistike turke të vitit 1897, Kavaja kishte 3245 shtëpi, 415 dyqane, 22 magazina, 12 hane, 110 mullinj, 10 furra tjegullash, 1 postë gjindarmërie, 1 farmaci, 37 mesxhide (xhami të vogla), 42 teqë, 1 medresë, 1 shkollë ruzhdie, 10 shkolla fillore, 1 shkollë rume (greke), 4 kisha etj.

Formimi i pashallëkut të Kavajës në çerekun e dytë të shek.XVIII [9] qe një tjetër faktor që ndikoi në zhvillimin ekonomik e social të qytetit.

Më 1912 Kavaja zinte vendin e shtatë ndër 14 qytetet kryesore të Shqipërisë, me 5.400 banorë, duke lënë pas qytete si Vlora me 5.000 banorë dhe Durrësi me 3.000 banorë. [10]

Në vitet e Luftës së Parë Botërore Kavaja ndodhej në zonën e pushtimit austro-hungarez. Burimet e pakta ekonomike e financiare të qytetit e të fshatrave u përdorën për mbajtjen e ushtrisë pushtuese dhe për nevojat e frontit të luftës.

Nga ana tjetër, ruajtja e rendit çifligar edhe pas Shpalljes së Pavarësisë u bë pengesë për zhvillimin e forcave prodhuese në bujqësi dhe për zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste në ekonominë e vendit. [11]

Në Kavajë nga viti 1921 e prapa prodhimi i vogël i mallrave, kryesisht ai zejtar, ishte mbizotërues në ekonominë e qytetit, ku u ngritën katër mullinj drithi (fabrika mielli). Mulliri i parë me motor në qytet qe instaluar që në vitin 1909 nga inxhinieri Jani (Xhuf) Koljaka. Një pjesë e banorëve të qytetit merrej me bujqësi.

Më 1931 u instalua energjia elektrike.

Durrësi dhe Vlora, të cilët më 1912 ishin nën Kavajën për numrin e popullsisë, nga viti 1921 e prapa u rritën dhe u zhvilluan me ritme më të shpejta, krahas qyteteve si Shkodra, Elbasani, Korça. Tirana, si kryeqytet, eci edhe më shpejt.

Në traditën e saj Kavaja është përmendur për punimin e baltës (prodhime të shumëllojshme poçerie), të leshit, të bakrit, të bulmetit, të vajit të ullirit, të drithërave, të kashtës për hasra (rrogoza). Më vonë, në gjysmën e dytë të shek.XX, kjo traditë u pasurua me punimin e alabastrit, të qelqit, të bakrit artistik, të prodhimeve artistike prej leshi, por pas vitit 1990 dhe në dekadëne parë të shek. XXI, mjerisht, e gjithë kjo veprimtari u shua.

E njëjta gjë ndodhi edhe me objektet industriale dhe me ndërmarrjet e mëdha, të ngritura në periudhën e socializmit.

\* \* \*

Atdhetarët dhe populli i trevës së Kavajës kanë marrë pjesë aktive dhe kanë dhënë ndihmesën e vet në luftërat për liri e pavarësi, për ruajtjen e tërësisë tokësore të vendit, për drejtësi e përparim shoqëror, për zhvillimin e arsimit e të kulturës kombëtare, për demokratizimin e jetës së vendit.

Rilindësit i konsideronin përhapjen e gjuhës amtare të shkruar në popull dhe çeljen e shkollave shqipe si faktorë shumë të rëndësishëm të Lëvizjes Kombëtare, krahas luftës me armë.

Më 1826 Andrea Ekonomi (Plaku), pastor i kishave të Kavajës e të Durrësit, me gëzim të madh ua predikonte në gjuhën shqipe besimtarëve të vet ungjillin e Mateut [12]

Më 1887, pas Mësonjëtores së parë të Korçës, mëmëdhetarët kavajas u munduan për çeljen e shkollës shqipe, por nuk ia arritën.

Konsulli i Austro-Hungarisë më 14 maj 1904 i shkruante MPJ-së në Vjenë se gazeta shqipe më tepër e përhapur dhe që lexohej më shumë në Shqipërinë e Mesme ishte "Drita". "Këtë gazete e lexojnë shumë njerëz në Kavajë, Peqin dhe Elbasan... Shumë shqiptarë, sidomos në Kavajë, marrin mësim në lexim... gazeta shkon dorë më dorë nëpër lexuesit...". [13]

Atdhetarët Andrea Ekonomi, Abdurrahim Sedja, Pal Xhumari, Hamdi Beu, Marigo Pjeshkazi (Bidoshi), Mustafa Cara, Qazim Fortuzi, Ethem Vogli, Haxhi Isuf Kazazi, Sheh Hamid Kraja, Besim Sinella, Hasan Gjeçi, Ahmet Rreshka (Hushi) etj. luftuan përkrah njëri-tjetrit për përhapjen e mësimin e gjuhës amtare bashkëqytetarëve; i kthyen shtëpitë, hanet, kopshtet e dyqanet në mësonjëtores të fshehta.

Atdhetari Andrea Ekonomi (I Riu), veprimtaria e të cilit qe bërë e njohur në Kavajë, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë e Delvinë, mbante lidhje e korrespondencë me shoqëritë patriotike të shqiptarëve në Bukuresht, Sofje e Tobhar të Egjiptit, duke u kërkuar gazeta e libra shqip. Më 25 korrik 1908 ai i shkruante Shoqërisë Kulturore "Drita" të shqiptarëve në Bukuresht: "T'gjith me t'mdhenj e të vegjël, me një avëll t'parrëfyer me gojë dëshirojn t'msojn gjuhën e vet. Nevojë e madhe asht për libra...". [14]

Në Gjirokastrë A.Ekonomi hapi të parën shkollë shqipe, mësimoren "Liria" më 1908. [15]

Në kongresin e Dibrës në korrik 1909 Kavaja dërgoi tre delegatë: myftiun, Hamdi Beun dhe mësuesin ortodoks Stavro Stavri. [16]

Në shtator 1909, në kongresin e Elbasanit morën pjesë dy atdhetarë kavajas: Andrea Ekonomi, i zgjedhur delegat nga populli i Gjirokastrës, dhe Abdurrahim Kavaja (Sedja), i zgjedhur delegat nga klubi "Vëllazënia" i shqiptarëve të Kozhanit në Maqedoni. [17]

Kavaja pati përfaqësues të saj në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, ndihmoi me djemtë e saj në luftën për mbrojtjen e Ulqinit, dërgoi qindra luftëtarë vullnetarë për mbrojtjen e Shkodrës nga ushtritë malazeze e serbe më 1912-13 dhe të viseve të Jugut nga forcat shovene greke; dërgoi një batalion vullnetarë për çlirimin e Vlorës nga pushtuesit italianë.

Sipas studiuës H.Isufi, rreth vitit 1901 në Kavajë kajmekami gjeti vdekjen nga plumbat e masave të revoltuara. [18]

Më 23 nëntor 1912 Ismail Qemali dhe grupi i atdhetarëve që e shoqëronte, u nisën nga Durrësi për në Vlorë. Ndalesën e parë e bëri në Kavajë, në zyrat e nënprefekturës, ku u takua me zëvendësnënprefektin, me të cilin bisedoi për situatën kritike që po kalonte vendi dhe për domosdoshmërinë e ngritjes së flamurit kombëtar, para se t'ia behnin forcat ushtarake të fqinjëve shovinistë ballkanas. [19] Kavajasi Qazim Merhori i shprehu Ismail Qemalit gatishmërinë për t'i vënë kuajt e tij në shërbim të karvanit të Pavarësisë deri në Vlorë. Njerëz të armatosur, nën komandën e atdhetarit Bajram Xhani, iu bashkuan grupit në atë udhëtim historik për të forcuar sigurinë e mbrojtjen.

Më 27 nëntor patriotët kavajas dhe autoritetet vendore ngritën në ndërtesën dykatëshe të nënprefekturës flamurin kombëtar, të qëndisur nga mësuesja mëmëdhetare Marigo Pjeshkazi (Bidoshi). Po atë ditë Kavaja i telegrafoi Vlorës: "Ju bajmë me ditë se, me ndihmën e Perëndisë, ndashti e shpalli edhe Kavaja independencën." (zëvendësnënprefekti).[20]

Më 28 nëntor nënprefekti Shahsivar Alltuni në telegramin dërguar Ismail Qemalit shkruante: "Ju bajmë me ditë se me vendim të Këshillës Fuqiplotë... u zgjodh përfaqësues për Kavajën Abdi bej Toptani nga parësia e Tiranës." [21] Atdhetari i njohur Ahmet Bejtaga hyri në shërbim të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe u emërua komandant xhandarmërie në Gollobordë, të cilën e mbajti të lidhur me Vlorën duke luftuar me guxim e vendosmëri kundër veprimtarisë përçarëse të Esad Pashë Toptanit e të veglave të tij. Më 20 nëntor 1913 A.Bejtaga i shkruante Aqif Pashë Elbasanit: "Shqipëria nuk është as e Esadit e as e Qemalit. Është e shqiptarëve...". [22]



\* \* \*

Në pranverë 1913 u hap shkolla shqipe në Kavajë. Shkolla e vajzave në godinë të veçantë u vendos para korrikut 1921. Shkolla e mesme u hap vonë, në shtator 1956. Më 1931 u formua banda muzikore.

\* \* \*

Populli i trevës së Kavajës dha ndihmesën e tij të çmuar në luftën kundër pushtuesve nazifashistë në të gjitha format e me të gjitha mjetet. Rreth 800 bij të tij dolën partizanë, ndërsa 70 ranë dëshmorë për liri. Kavaja i dha LANÇ-it Komandantin e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, Spiro Moisiun. [23] Kjo luftë e popullit shqiptar e radhiti Shqipërinë përkrah SHBA-së, Anglisë, Ruisë, Francës etj. në koalicionin e madh antifashist botëror. Kavaja u çlirua më 14 nëntor 1944.

Në periudhën e socializmit (1945-1990) u ndërtuan: uzina e gozhdë-bulonave, fabrika e qelqit dhe e xhamit, fabrika e letrës, ndërmarrja e pro dhimit të qilimave e sixhadeve, SMT-ja etj.

U ngrit rrjeti arsimor e shëndetësor, u hapën muzetë etnografik e historik, kisha ortodokse u shndërrua në pallat kulture, u ndërtua stadiumi "Besa" etj. Institucionet kulturore dhe një pjesë e administratës shtetërore vendore u vendosën në godina ish-pronë private, të shtetëzuara nga regjimi komunist.

Në katër dekada e gjysmë të rendit socialist, ndërmarrjet dhe fabrikat e sipërhënuara ishin të pamjaftueshme për një jetesë normale të popullatës, e cila ishte gjithnjë në rritje. Papunësia, strehimi problematik, infrastruktura e dobët, mungesa e ujit të pijshëm dhe e ushqimeve, mbyllja e vendit dhe trysnia politike e të tjera, rritën dukshëm pakënaqësinë popullore, veçanërisht





të brezave rinorë, duke çuar në demonstrime të hapura me pjesëmarrje të gjerë kundër regjimit komunist. Më 1990 Kavaja ishte në pararojë të luftës për demokraci. Më 25 e 26 mars rinia e qytetit realizoi dy demonstrata antikomuniste, të organizuara, goditëse ndaj forcave të rendit, me pjesëmarrje të konsiderueshme për kushtet kur u zhvilluan, në shkallë vendi. Njëri nga këta të rinj të guximshëm, Josif Budo, disa muaj më vonë, më 10 korrik, do të bëhej dëshmori i parë i luftës për demokraci.

Popullsia e qytetit të Kavajës ndër dekada ka patur një rritje normale, jo të vullshme. Lëvizjet demografike kanë qenë të pakta, kryesisht brenda zonës, fshat-qytet. Më 1944 në qytet e në disa fshatra u vendos një numër i konsiderueshëm çamësh, të shpërngulur forcërisht nga trojet e tyre e të masakruar nga grekët. Në qytet e në rrethin e Kavajës kanë jetuar vazhdimisht në harmoni dy komunitete fetare, mysliman (rreth 70%) dhe ortodoks. Numri i familjeve katolike apo të ndonjë besimi tjetër është i papërfillshëm. Sipas burimeve të shkruara shënojmë popullsinë e qytetit në disa vite: 1920 – 6268 banorë; 1938 – 7200 banorë; 1955 – 12.760 banorë; 1965 – 16.330 banorë; 1994 – 30.086 banorë; 2001 – 36.600 banorë. Në vitet 1990-91 Kavaja ka patur një migrim të madh të banorëve të saj në Evropë, por dhe në kontinente të tjera. Migrimi ka vazhduar edhe më pas, por në përmasa të vogla. Numri i të mërguarve si rreth mendohet të jetë 7000-8000 vetë.

Më 1999 Kavaja hapi dyert e zemrat për të pritur 22.500 vetë nga shqiptarët e Kosovës, të dëbuar forcërisht nga trojet e tyre gjatë genocidit serbomadh.

Edhe në këtë vit të paharruar të 1999-s, emri i Kavajës u ngrit lart nga vepra sublime e birit të saj, Dëshmorit të Kombit, Indrit Cara, i cili dha jetën për Lirinë e Kosovës, duke dritësuar madhërisht atdhetarizmin bashkëkohor shqiptar.

**Durrës, shtator 2017**

- [1] Z.Shkodra, *Esnafet shqiptare, Shek.XV-XX, Tiranë 1973, f. 35.*
- [2] *Historia e Popullit Shqiptar, vëll. I, Toena, 2002, f. 548.*
- [3] *Po aty, f. 554.*
- [4] I.Sukaj, *Urbanistika dhe arkitektura e qytetit të Kavajës, Tiranë 1998, f. 23-28.*
- [5] *Evliaja Çelebi, Sejjahatname, botim i v.1902, përkthyer nga Salih Vuçiterni e botuar më 1930 nën titullin "Shqipnija para dy shekujsh", f. 90-92.*
- [6] Z.Shkodra, *vep. e cituar, f. 299.*
- [7] I.Sukaj, *vep. e cituar, f. 52.*
- [8] *FESH, Tiranë 1985, f.463.*
- [9] *Historia e Shqipërisë, vëll. I, Tiranë 1959, f. 422.*
- [10] *V.Duka, Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1923, Tiranë 1997, f. 10.*
- [11] I.Fishta e V.Toçi, *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944 ... , Tiranë 1983, f. 72.*
- [12] Z.Shehi, *Kavaja-trajtesa historike, Durrës 2017, f. 6.*
- [13] *Po aty, f. 7, 8.*
- [14] *AQSH, F.22, D.88, dok. 15.*
- [15] Z.Shehi, *Andrea Ekonomi – Mësues i Popullit, Tiranë 2000, f. 29.*
- [16] *Arkivi i Institutit të Historisë, HHSTA, nr. 41, dt. 22.7.1909.*
- [17] Z.Shehi, *Kavaja-trajtesa historike, Durrës 2017, f. 11.*
- [18] *Gazeta "Adriatiku", d.11.9.1988, f. 4.*
- [19] P.Pepo, *Lufta për çlirimin kombëtar në vitet 1878-1912, Tiranë 1962, f. 263.*
- [20] *Lef Nosi, Dokumente historike..., nr. 3, prill 1924, f. 73.*
- [21] *Lef Nosi, vep. e cituar, nr. 8, v.1924, f. 235.*
- [22] *AQSH, F.71, dok.nr. 12023.*
- [23] *Shënime: Spiro Moisiu ishte kushëri i aktorit me famë botërore Aleksandër Moisiu. Djali i Spiros, Alfred Moisiu, u bë President i Republikës së Shqipërisë në vitet 2002-2007.*

# Come to my home

► Vizion nga faqja 24

Në këtë pikë, llogaritjet nisin të bien erë gëlqere, tulla e beton.

Presioni i madh i kërkesës për turizëm në këtë hapësirë, është evidentuar nga dokumenti serioz i FSHZH-së, si cenes i mjedisit natyror dhe atij të ndërtuar të Alpeve Shqiptare. "Ngakesa turistike mbi të cilën cenohen ndjeshëm aspektet mjedisore, sociale dhe infrastrukturore të Alpeve Shqiptare, është 18.000 deri në 20.000 vizitor në ditë" - shkruhet në draft-Plan dhe kjo i përgjigjet një oferte akomoduese prej jo më shumë se 12 mijë shtretërisht, të shpërndarë në rreth 800 bujtina dhe mbi 100 hotele.

Ky vlerësim duket më afër Skenarit 4 të Zhvillimit në "Vlerësimin Strategjik Mjedisor" të FSHZH.

Mirëpo ajo çka ndodh në terren është diçka krejt tjetër. Përveç hidrocentraleve të dyshimta që po ua thajnë damarët Valbonës e Vjosës, as vetë malësorët nuk janë krejt pa përgjegjësi për situatën. Në vetëm më pak se dy dekada Valbona, e në vetëm një dekadë edhe Thethi, po e mbrrijnë pikën e ngopjes me ndërtimin e strukturave akomoduese, në mjaft raste pa kurrfarë respekti për arkitekturën tradicionale, duke ia vënë në diskutim, e ndoshta edhe duke ia ndërruar asaj identitetin (vetëm Thethi ka aktualisht rreth 1.000 shtretër nga 1.500 të parashikuara për 2031). Banorët e këtyre zonave akuzojnë shtetin se po i detyron të ndërtojnë në mënyrë të paligjshme dhe rrjedhimisht të ngutshme, për shkak se sipas tyre, nuk u ka dhënë tapitë dhe prapë rrjedhimisht, as leje ndërtimi. Për kredi të buta apo grante as që bëhet fjalë. Dhe duke parë se si fqinjët e kanë rregulluar jetën me turizëm, disa janë kthyer në fshatin e braktisur para 10 vitesh dhe me parë borxh po ndërtojnë, me tulla e beton - mundësisht brenda verës së shkurtër - ndonjë vilë me sa më shumë kate e dhoma. Këto probleme me të cilat ballafaqohet grupi i punës për hartimin e Kodit të Dizajnit të Thethit të mbështetur nga GIZ, në të vërtetë janë evidente edhe gjetkë në Alpe. Le t'i shtojmë kësaj edhe bjerrjen e pjesshme të traditave kulturore e kulinare aq sa, psh i ashtuquajtur Muze Etnografik i Thethit nuk ka inventar objektësh, apo që toka bujqësore zaptohet nga ndërtimi dhe turistëve u shërbehët qumësht *tetra pak* apo margarinë - dhe ajo çka

pritet në perspektivë është një pamje po aq e shëmtuar sa fantazmat e Durrësit, Vlorës dhe Sarandës.

A do të mund të flitet paskëtaj për autenticitet të turizmit shqiptar, së paku në Alpe? E sigurisht edhe në mrekullitë e jugut të thellë, pa harruar Mirditën dhe Matin. A do të duhej që përcaktimi "autentik" në Vizion të reflektonte ndryshimin edhe në vetë prioritetet e Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit 2017-2022, për të nxjerrë turizmin e kulturës dhe atë të natyrës në krye? Pra për ta *brand*-uar turizmin tonë për vlerat historike, trashëgiminë kulturore, kulinarinë, ekoturizmin, agroturizmin, për mikpritjen dhe për barishtet e egra. Në intervistën e këtij numri të revistës Travel, ish-ministrja e Turizmit del kundër kësaj ideje, duke argumentuar se turizmi bregdetar ka potenciale të pashfrytëzuara, si psh. turizmi detar i jahteve etj. Po si t'ua ndërrojmë mendjen 79 % të turistëve, që sipas dokumentit të FSHZH-së të cituar më sipër, do të preferonin bujtinat dhe kampingjet për t'u akomoduar në Alpet Shqiptare, sepse ata nuk vijnë këtu për të vuajtur - por sigurisht as për komoditetin që ne nuk ua ofrojmë dot brenda përbindëshave të betonit - mosnxënia shembullore prej Spanjës, Monte Carlos, Izraelit e plot brigjeve tjera të Mesdheut të përcudnuara nga grykësia e turizmit masiv të dekadave të shkuara.

Pa folur për kulturën e shërbimit, që sikurse transmetoi ministri i ri i Turizmit një shqetësim të polakëve, dominohet nga kamarierë që nuk dinë as të buzëqeshin.

Ndoshta është koha, që motoja përcjellëse e turizmit shqiptar "Go your own way", e kuptuar me sa duket si "Bëj sipas qejfit", të zëvendësohet me ndonjë koncept krejt tjetër. Ndoshta "Come to my home" është më ftuese dhe udhërrëfyese drejt një destinacioni të qartë: shtëpinë, që për çdo shqiptar është e Zotit dhe e Mikut.

Vështirë të kemi diçka më autentike se kjo.

Morali i fabulës: Le t'i presim turistët në shtëpitë tona të kthyer në bujtina, airbnb apo hostele dhe me paratë që do të bëheshin bunkerë të rinj, të përmirësojmë kushtet dhe shërbimin e hoteleve që do t'i mbijetojnë konkurrencës.

**Irhan Jubica**

18 Tetor

## Ekspozita "Arkitektura tradicionale - Kullat" prezanton në Tiranë draft-Kodin e Dizajnit të Thethit

I fshehur mes malesh të larta në një luginë rreth 800m mbi nivelin e detit, Thethi është i pari fshat i Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare që po bëhet me një Kod Dizajni. Drafti i këtij kodi u prezantua në Kinema Millennium të Tiranës, me pjesëmarrjen e qindra të ftuarve, profesionistë dhe studentë të arkitekturës, planifikues urbanë, përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), të bashkisë Shkodër, të Ambasadës Gjermane, GIZ, të kompanisë së konsultimeve GOPA/DIAVA, të shoqërisë civile etj.

Aktiviteti me titull "Arkitektura tradicionale - Kullat" u mbajt në kuadër të Tetorit Gjerman, pasi që prej një viti, ekspertë lokalë dhe të huaj, me mbështetjen e GIZ, kanë punuar intensivisht mbi



18 Tetor

## Omani heq vizat për shqiptarët

Në një përpjekje për të rritur turizmin në vend, Mbretëria e Omanit vendosi heqjen e vizave për 25 shtete të ndryshme, përfshi edhe Shqipërinë. Të vetmet kritere për të vizituar Omanin janë një pasaportë e vlefshme të paktën 6 muaj brenda aplikimit, bileta avioni vajtje-ardhje dhe një rezervim hoteli.



Kodin e Dizajnit, si një bashkësi rregullash dhe kriteresh që përcaktojnë çfarë dhe si duhet të ndërtohet në zonë.

Thethi u zgjodh si subjekti i Kodit të Dizajnit (projekt pilot) sepse është një ndërzonat më të ruajtura të Alpeve Shqiptare pavarësisht zhvillimit të tij gjatë dhjetëvjeçarit të fundit.

Aktiviteti u përcoll përmes fjalëve përsëritëse të drejtorit të AKZM, Zamir Dedej, kryetares së Bashkisë Shkodër Voltana Ademi, përfaqësuesve të projektit CABRA Ralf Peveling dhe dhe Shpresa Smajli. Ndërsa ekspertët Hartmut Mueller dhe planifikuesja urbane Eltjana Shkreli, theksuan nevojën që shembulli i mirë i Thethit, me gjithë pikat e tij të diskutueshme dhe të pasqyruara në draft Kodin e Dizajnit, të përshtatet dhe të kthehet në rregullore (instrument ligjor)

në Shqipëri, e cila të zbatohet jo vetëm në këtë zonë, por në të gjithë Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare.

Pas shfaqjes së një filmi dokumentar për shkollën verore të organizuar në Theth me studentë arkitekturës e urbanistikës nga universitet shqiptare e gjermane, të pranishmit vizituan ekspozitën "Arkitektura tradicionale - Kullat". Përveç një modeli simbolik të Kodit të Dizajnit të Thethit, ekspozita mbi Kodin e Dizajnit, e organizuar nga GIZ dhe organizata GO2 u fokusua rreth simbolikës së kullës. U paraqitën punime të teknikave të ndryshme, si gur, dru, tekstil, tezgjah etj. Qëllimi i kësaj ekspozite ishte sjellja e produkteve kreative të të rinjve të zonës si dhurata për turistët, si simbol i Alpeve Shqiptare dhe pse jo, si një ndihmesë për biznesin e vogël.

11 Tetor

## "Mozaik Kruje" në Pazarin e Ri të Tiranës



Bashkëpunimi mes bashkive Krujë dhe Tiranë, Fondit Shqiptaro- Amerikan për Zhvillim, AZHR2 dhe TID Kruja, në Pazarin e Ri të Tiranës u organizua "Mozaik Kruje".

Aktiviteti nisi me panairin e artizanit, ku u prezantuan produktet artizanale të një tradite 500 vjeçare, si bakër, drur, shajak etj.

Më pas, "Kruja outdoor", e fokusuar në Parkun Kombëtar të Qafshatës u

prezantua si një nga atraksionet më të reja të bashkisë së këtij qyteti, së bashku me "Kruja Virtual Tour".

Ndër momentet më të nxehta të aktivitetit dhe që zgjoi interes të madh të qindra qytetarë të pranishëm, ishte performanca e dasmës krutane e cila zgjati për gati 5 orë dhe përfshinte interpretime të grupit karakteristik "Pleqtë e Krujës" si dhe të aktorit të njohur Xhevat Limani me rolin e Skënderbeut. Në mbrëmje aktiviteti vijoi me "Artisan's Fashion Night" ku u prezantuan nga modelet veshjet tradicionale me motive moderne, të realizuara nga artizanët krutanë në kujdesin e stilistes Gerta Oparaku dhe etnografes së njohur Afërdita Onuzi.

Aktivitetin e ndoqën nga afër përfaqësues të bashkive Krujë dhe Tiranë, si Ilir Loci dhe Erion Veliqaj, Drejtori i Bordit Drejtues të Fondit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, Michael Granoff, deputetët Eglantina Gjermani Rrahman Rraja, por dhe përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në Shqipëri.

29 Shtator

## Presidenti shënon Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore në Berat



Presidenti i Republikës, Ilir Meta së bashku me Ministren e Kulturës, Mirela Kumbaro zgjodhën Beratin për të shënuar Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore. Të shoqëruar nga autoritetet vendore, ata vizituan fillimisht Muzeun "Onufri" e më pas edhe institucione të tjera muzeale të këtij qyteti.

29 Shtator

## Ambasadorja holandeze vlerëson nga Kukësi turizmin shqiptar



Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore është shënuar edhe në Kukës, ku e pranishme ka qenë edhe ambasadorja e Holandës në Shqipëri, Dewi Van de Werd, sipas së cilës, turizmi në Shqipëri, po merr një hov të madh zhvillimi.

Ajo e përgëzoi iniciativën për promovimin e trashëgimisë kulturore dhe turizmit, ndërsa Kryetari i Bashkisë, Bashkim Shehu tha se promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore është prioritet si pjesë e strategjisë për zhvillimin e turizmit. Duhet të bëjmë të pamundurën që turistët t'i mbajmë sa më gjatë në Kukës dhe t'i njohim ata jo vetëm me bukuritë natyrore, por edhe me çfarë ne kemi trashëguar, qoftë me Kalanë e Pecës, Kalanë e Gradishtës, Muzeun apo Tumat Ilire në Çinamakë, - tha ai.

I pranishëm në këtë aktivitet, Drejtori i Institutit të Arkeologjisë Luan Përzhita theksoi rëndësinë e zonës së Kukësit në arkeologji e trashëgimi kulturore.



3 Tetor

## Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore reagon për ndërtimin në Butrint

Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (FMKT) ka dalë me një deklaratë të ashpër kundër Minsitrisë së Kulturës, në lidhje me ndërtimet që po kryhen në Parkun Kombëtar të Butrintit.

Në deklaratë thuhet: "Sipas dokumentacionit dhe njoftimeve zyrtare të stafit të Mirela Kumbaros bëhet fjalë për ndërtimin e një objekti për shitje suveniresh dhe objekti i dytë për një "Qendër Multifunktionale Shërbimesh" (më shkoqur lokal). E gjitha kjo është justifikuar me "mungesën e kushteve higjieno-sanitare dhe sigurisë ushqimore të shërbimeve që u afroheshin deri më sot turistëve që vizitojnë parkun. Kjo logjikë do të funksiononte sikur Butrinti të ishte i njohur dhe vizitohet si destinacion "slow food" apo prodhimeve bujqësore bio dhe jo një sit arkeologjik.

Pavarësisht këtyre argumentave qesharakë që sjell ministria për të mbrojtur zullumin e saj, ajo ende nuk i është përgjigjur pyetjes kryesore që ngrënë sot të gjithë: përse duhet të ngrihen këto dy objekte në brendësi të parkut, pranë një muri prehistorik, i cili daton në shekullin e 7-8 para Krishtit? A është vërtet i domosdoshëm sigurimi i bar-kafeve dhe shitjes së suvenirëve në brendësi të parkut, aty ku nëntoka ende nuk i ka nxjerrë thesaret e saj?

Të gjithë arkeologët si Neritan Ceka, Gjerak Karaiskaj, Gjergj Frashëri, e shumë zëra të tjerë profesionistë, kanë denoncuar mungesën e sondimeve arkeologjike përpara se të aprovohej këto leje në brendësi të parkut. Vendimet e dhëna për këto objekte nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe më pas Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, janë dhënë në një distancë prej vetëm 13 ditësh (nga 12-25 maj), duke dëshmuar nxitimin me të cilin janë aprovuar vendimet nga institucionet në varësi të Ministrisë dhe mungesën e sondimeve të detyrueshme përpara hedhjes së betonit.

Akoma më absurd duket edhe shfaqësi mi se ndërtimet janë duke rehabilituar një ndërtim ekzistues, i ndërtuar në vitet '70, ndërkohë që pamjet në terren vërtetojnë se bëhet fjalë për betonime

të reja. Vetë objekti ekzistues, apo e njohur si ndërtesa e arkeologëve, mund të cilësohet si monument për shkak të historikut të saj mbi 50-vjeçar dhe nuk mund të rikonstruktohet nga punëtorë të paspecializuar.

Ministria Kumbaro duhet të shpjegojë gjithashtu edhe faktin që këto objekte po ndërtohen me kërkesë të subjekteve private, pra Partneritetin Publik Privat të famshmet PPP, dhe do të menaxhohen prej tyre. Dhe nga sa flitet deri më sot, nuk bëhet fjalë për biznese në fushën e artit apo fundacione, që ndihmojnë mbrojtjen e trashëgimisë, por biznese të tjera pa eksperiencën e duhur në menaxhimin kompleks që kërkohet në raste të tilla. Të shesësh sot nevojën e bizneseve për të ndërtuar bar-kafe apo restorante si shpëtim i arkeologjisë, është më shumë se hipokrizi. Përpara se të jepet me koncension ndaj lokaleve të privatëve, Butrinti ka nevojë urgjente për të patur planin e tij menaxhues, i cili po vonohet nga ministria e Kulturës prej 12 vitesh, pavarësisht se është detyrim nga qenia e tij pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCOs. Ky plan do të vërtetonte edhe "nevojat e vërteta higjieno-sanitare" të ministrisë në Butrint. Nëse nuk do të frenohet kjo "grykësi" e Kumbaros, do të kemi edhe shumë skandale të tjera në sitet arkeologjike. Këto investime PPP në fakt u paralajmëruan nga Forumi në vitin 2015, me miratimin e udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 5110 date 13.10.2015 "Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të Monumenteve të Kulturës me qëllim rijetëzimi", duke i hapur rrugën çdo "subjekti të interesuar privat" që të propozojë ndërtime të tilla në sitet arkeologjike.

Tashmë është tepër vonë për të besuar tek reagimi i kësaj ministreje ndaj letrave të hapura apo denoncimeve publike të ekspertëve. Për të gjitha këto arsye, FMKT do t'i drejtohet me një letër zyrtare informuese sekretariatit të UNESCO-s për të denoncuar skandalin e rradhës. Të shpresojmë që komuniteti ndërkombëtar do të jetë më i ndjeshëm dhe do të frenojë veprimet e papërgjegjshme të ministrisë për të shkatërruar Butrintin" - thuhet në deklaratën e FMKT-së.

27 Shtator

## Ministri Klosi zgjedh Krujën në Ditën Botërore të Turizmit

Agjencia Kombëtare e Turizmit në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit Rajonal Nr.2, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Shoqatën e Restoranteve Turistike Shqiptare, Shoqatën e operatorëve të turizmit UTSH, ATA, ATOA dhe AITA, nën kujdesin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit Blendi Klosi, organizuan në Krujë festimet qendrore me rastin e Ditës Botërore të Turizmit, që këtë vit, sipas Organizatës Botërore të Turizmit, i kushtohet turizmit të qëndrueshëm. Ministri i Mjedisit dhe Turizmit Blendi Klosi tha se qeveria e ka përcaktuar turizmin ndër sektorët prioritarë për zhvillimin ekonomik të vendit, duke iu referuar edhe shpalljes së 2018 si vit i Skënderbeut, ndërsa kreu i Agjencisë Kombëtare të Turizmit, Ardit Çollaku tha se falë promovimit të vazhdueshëm dhe frytdhënës nga AKT, si dhe bashkëpunimit të ngushtë me sektorin privat, Shqipëria po tërheq një numër rekord turistësh dhe vizitorësh të huaj.

Më pas erdhi radha e një performance nga grupi karakteristik i Pleqve të Krujës dhe grupit lokal të valleve, si dhe panairit të kulinarisë.

22 Korrik

## Klubi Taraboshi Shkodër



Një grup të rinjsh, dashamirës së ecjes në mal dhe të natyrës u mbodhën në fund të Korrikut në fermën ekosociale në fshatin Oblikë të Shkodrës, për të themeluar klubin shumësportësh Taraboshi. E ftuar ishte Uta Ibrahim, femra e parë shqiptare që sfidoi Everestin. Ajo ndau me të pranishmit eksperiencën e saj, sfidat me të cilat u përball deri në realizimin e ngjitjes në majën më të lartë në botë. Utën dhe klubin e përshendetën edhe bjeshketarët nga shoqata Rumija e Malit të Zi, Dajti Alpino-Turistik dhe Pashtriku Kosovë, AST nga Elbasani, si dhe Luigj Malaj, veterani i alpinizmit shkodran.

Presidente e Taraboshit u zgjodh Aurora Piroviç, sipas së cilës, klubi konsiston në organizimin e aktiviteteve të natyrë, përfshirjen e të rinjve në këto aktivitete, identifikimin e promovimin e atraksioneve natyrore të malit të Taraboshit e më gjerë, të krejt zonës së Shkodrës.

Në ditën e dytë, nga një grup antarësh të klubit Taraboshi dhe mysafirët VIP u organizua një udhëtim me kanoe përgjatë lumejve Drin dhe Buna, me destinacion plazhin e Belaj, në Dajç duke përshkuar distancë prej 20 km.

# Klinika Dentare Toti & Gurakuqi

Eksperiencë



Profesionalizëm

Besueshmëri



- Mbi 20-vjet eksperiencë në Implantologji orale (metoda me mbjellje të dhëmbëve).

- Ortodonci (me aparate fikse dhe të lëvizshme) me mjek të specializuar të fushës.
- Si dhe të gjitha shërbimet e tjera dentare.



*Rikthejmë buzëqeshjen tuaj...*



*Rikthejmë buzëqeshjen tuaj!*

Ortodonci me aparate fikse dhe të lëvizshme, me mjekë të specializuar të fushës

Mbi 20 vjet eksperiencë ne Implantologji orale

(metoda me mbjellje të dhëmbëve)

Të gjitha shërbimet dentare me materiale cilësore dhe jetëgjata

Adresa: Rruga "Muhamet Gjolleasha" nr 81, Tiranë, Albania

Tel.1: +355 4 2258 429; Tel. 2: +355 4 2249 494

email: [almirogurakuqi@hotmail.com](mailto:almirogurakuqi@hotmail.com); [www.toti-gurakuqi.al](http://www.toti-gurakuqi.al)



# BUKË, KRIPË E ZEMËR....

## mikpritja e trashëguar ndër breza

**Projekti kushtuar vlerësimit të dijeve, produkteve vendore, traditës e kulturës në veri e jug të Shqipërisë**

Me 30 maj pranë agroturizmit "Nano Resort" u përmyll projekti "Bukë, Kripë e Zemër – Ushqimi, Tradita dhe Kultura: procese të bashkëzhvillimit në zonat e margjinalizuara në veri dhe jug të Shqipërisë me anë të vlerësimit të njohurive dhe prodhimeve tradicionale bio-mesdhetare", i financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS), realizuar nga VIS në Malësi të Madhe e nga Cesvi në Përmet.

Projekti, me një kohëzgjatje mbi 3 vjeçare, ndikoi pozitivisht në qarqet në të cilat u zhvillua, duke arritur një numër të konsiderueshëm përfituesish: 150 ndërmarrje të vogla e të mesme në Përmet e Malësi të Madhe, me një total prej 1500 personash të përfshirë në sipërmarrje bujqësore dhe përpunimi, agroturistike e turistike.

Bukë, Kripë e Zemër, një program zhvillimi dhe promovimi për komunitetet rurale, pati si qëllim diversifikimin prodhues dhe rritjen e të ardhurave përmes kanaleve të reja të financimit, përfshirjen e aktiviteteve prodhuese në ekonominë e tregut, çeljen e aktiviteteve të reja që prodhojnë të ardhura, rikualifikimin mjedisor dhe pjesëmarrjen e përgjegjshme të popullsisë në zonat target të projektit dhe të institucioneve vendore.

Projekti adresoi çështjen e varfërisë dhe të papunësisë së të rinjve me një qasje të integruar përmes vlerësimit të traditave,

burimeve vendore agroushqimore dhe turistiko-mjedisore. Këtë e bëri të mundur përmes një kuadri të plotë dhe të diversifikuar instrumentesh: 575 mikrokredi me interesa të ulëta, 52 grante, aftësim tekniko-profesional (kurse: kuzhine, udhërrëfyes turistikë, hotelerie; trajnime: mbi njohuritë për shpellat dhe biodiversitetin, mbi mountain bike si aktivitet i mundshëm ekonomik, standardet e prodhimit të djathit Mishavinë, standardet e prodhimit të mjaltit biologjik), nisma komunitare e komunikim.

Bukë, Kripë e Zemër u ofroi komuniteteve në të cilat u zhvillua një mundësi konkrete për të ndryshuar. Vlerësimi i burimeve kulturore, gastronomike dhe turistike do të thotë të forcosh vetëdijen, nga ana e banorëve të këtyre dy zonave, për sa i përket bukurisë që zotërojnë dhe të traditave shekullore që meritojnë respekt dhe vlerësim nga ana e tjetër e Vendlit e më gjerë.

Projekti u dallua edhe për dy elemente shumë të rëndësishëm, që përbëjnë një vlerë të shtuar të tij dhe një praktikë të mirë për t'u përsëritur edhe në zona të tjera: Komitetet e Menaxhimit të Fondit – një mekanizëm publik – privat, pararendës të Grupeve të Veprimit Lokal dhe figura





gjithashtu subjekteve të veçanta të zinxhirit agro-turistik, të paraqiten në treg në mënyrë më të dukshme, të koordinuar dhe sinergjike, dhe do të kontribuojnë për të rritur standardin cilësorë dhe të proceseve prodhuese në sektorin agro-ushqimor dhe të ofruesve të shërbimeve në sektorin turistik.

Projekti u shënuar nga një pjesëmarrje e gjerë në panaire dhe evente të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, për promovimin e këtyre dy zonave me potenciale të jashtëzakonshme, natyrore e kulturore, me një gastronomi bazuar në produktet tipike vendore e të shoqëruar gjithmonë nga mikpritja e pashoqe e shqiptarëve!

BUKË, KRIPË E ZEMËR.... Projekti që vuri në qendër njeriun dhe territorin e tij.....duke bërë kështu të mundur zhvillimin e tyre social dhe ekonomik.

[www.kelmend-shkrel.org](http://www.kelmend-shkrel.org)  
[www.visitpermet.org](http://www.visitpermet.org)

e Agjentëve të Zhvillimit Lokal, vajza e djem të rinj të zonës që vënë në dispozicion njohuritë e tyre në shërbim të komunitetit, që përfaqësojnë rrugën më të mirë për të siguruar qëndrueshmërinë e projektit edhe në vitet që pasojnë.

Projekti u përball me një sfidë komplekse: dialogun në një gjuhë mes komuniteteve dhe institucioneve. Një sfidë kjo e fituar. Përgjatë projektit u forcuan dy konsorciumet agroturistike "Pro-Përmet" dhe "Fryma e Kelmendit", aktive në territor e që kanë dyfishuar tanimë numrin e anëtarëve. Turizmi në Shqipëri është në një rritje të qëndrueshme e të vazhdueshme.

Qendrat Multifunktionale, në dy zonat e projektit, janë një rezultat i prekshëm, në të cilat një personel i kualifikuar mund të orientojë dhe të udhëheqë turistët për pushime sipas kërkesave të tyre, duke u ofruar materiale informuese dhe të përditësuara vazhdimisht mbi shërbimet dhe aktivitetet që ofron zona. Këto qendra u lejojnë



një udhëtim eksplorues në veprat e kësaj artisteje shumëdimensionale: duke nisur nga vizatimet, fotografitë, tablotë e famshme me thurje e deri tek „Malmachine“ dhe video-instalacionet.



**23 TETOR - 10 NËNTOR**

Ekspozita e 8 personale e skulptorit Arben Bajo vjen në Galerinë FAB të Universitetit të Arteve në Tiranë, e kuruar nga Ardian Kapo.



**21, 22, 28, 29 TETOR**

Teatri Metropol prezanton "Gjyshja ka ikur me Cirkun" nga autori Mike Kenny. Regjisore Armela Demaj. Interpretojnë Kastriot Ramollari, Klesta Shero, Ibrahim Selishta. Skena dhe kostumet Ina Elezi.



**24 TETOR - 3 DHJETOR**

Ekspozitë me vizatime, objekte dhe video të përzgjedhura në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë. Gjermanja Rosemarie Trockel vlerësohet si një nga artistet më të famshme bashkëkohore, e cila e shpreh vështrimin e saj krejtësisht vetjak për botën me anë të objekteve, skulpturave dhe instalacioneve. Me ekspozitën e Institutit për Marrëdhëniet me Jashtë (ifa) „Rosemarie Trockel“, Ambasada Gjermane dhe Galeria Kombëtare e Arteve i mundësojnë publikut shqiptar për herë të parë



**3 - 11 NËNTOR**

Tirana International Film Festival (TIFF) është i pari dhe më i madhi event ndërkombëtar i kinemasë në Shqipëri, i krijuar që në vitin 2003, me moton "Think Different, See Alike". Që nga fillimi, TIFF ka pritur mbi 15 mijë filma të shkurtër dhe 4 mijë filma të gjatë nga 112 vende të botës. Festivali përbëhet nga programi i konkurimit me disa seksione dhe programi i prurjeve të reja, gjithashtu me seksione të veçanta.



**4 NËNTOR - 30 DHJETOR**

Fundjavë në Shkodër në kërkim të atraksioneve turistike të qytetit? Marubi vjen jo vetëm si muze, por edhe si street art me teknikën e sticker-art në disa pika "të fshehura" të qendrës së Shkodrës.



**10 NËNTOR - 29 DHJETOR**

Çdo të Premte, Muzeu Historik Kombëtar fton qytetarët të marrin objektet e vjetra të rashëguara nga paraardhësit dhe t'i prezantojnë ato në ambientet e Muzeut, duke u bërë kështu pjesë të projektit "Muzeu im". Në fund të ditës, objektet do të merren sërish me vete.

**2 NËNTOR - 5 DHJETOR**

Ekspozitë vetjake e artistit britanik Grayson Perry në Galerinë Kombëtare të Arteve, të njohur sidomos për vazot shumëngjyrëshe të qeramikës. Në vitin 2008, artisti u rendit i 32 në listën e 100 personave më të fuqishëm në kulturën britanike, sipas "The Telegraph".



**28 NËNTOR**

105-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë, së shpallur nga Ismail Qemali më 1912.



**29 NËNTOR - 15 DHJETOR**

Artisti Zeni Ballazhi vjen me projektin "Nata e Bardhë" në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë.

**29 NËNTOR**

Dita e Çlirimit të Shqipërisë (28 Nëntor 1944).

**1 - 31 DHJETOR**

Teatri Metropol sjell për të rinjtë shfaqjen "Romeo dhe Zhulieta" nga William Shakespeare, regjia Sonila Kapidanit.

**8 DHJETOR**

Dita Kombëtare e Rinisë, në nderim të fillimit të Lëvizjes Studentore të vitit 1990, që ishte nismëtare e rënies së diktaturës 45-vjeçare në Shqipëri.

**20 DHJETOR - 30 JANAR**

Edicioni i radhës i Konkursit Ndërkombëtar të Arteve Pamore "Onufri" vjen në Galerinë Kombëtare të Arteve.



**21 - 23 DHJETOR**

Edicioni i 56-të i Festivali i këngës në RTSH do të mbahet sipas traditës, në fund të Dhjetorit. Për të gjashtë herë, moderator i Festivalit do të jetë Adi Krasta, regjisor Pali Kuke, scenograf Albi Çifligu, derjtues muzike Sokol Marsi, ndërsa drejtues i Orkestrës Elton Deda.

**25 DHJETOR**

Krishtlindjet

**31 DHJETOR - 1 JANAR**

Vitit i Ri



# HOTEL BELGRAD MANGALEM



Duke gërshetuar antiken dhe modernen, qetësinë dhe komfortin, I vendosur në një shtëpi 300-vjeçare në lagjen historike Mangalem, Hotel Belgrad Mangalem ju ofron shërbim dhe mundësi për pushime të paharruara në qytetin e Beratit. Nuk është thjesht qëndrim fjetjeje, është një mundësi për të prekur nga afër historinë e qytetit 2400-vjeçar, me detaje që flasin për stil dhe klas por edhe për traditë e shije beratase. 24 orë shërbime si: vendparkim, linjë telefonike, linjë kabllori dhe wireless.

*Combining antique and modern, tranquility and comfort, located in a 300-year-old house in the historic Mangalem neighborhood, Hotel Belgrad Mangalem offers you services and opportunities for unforgettable holidays in the city of Berat. It's not just a sojourn, it's an opportunity to touch the 2400-year-old history of the city closely, with details about style and class, but also about Berat's tradition of taste. 24 hour services such as parking, telephone line, cable TV and wireless internet.*

*Your home,  
away from your home...!*



Address:  
Historic area of Mangalem  
"Kostaq Stefa", Str., Berat, AL  
Phone: +355 698326499  
[info@hotelbelgradmangalem.com](mailto:info@hotelbelgradmangalem.com)  
[www.hotelbelgradmangalem.com](http://www.hotelbelgradmangalem.com)

DESTINACIONE

Foto: Blue Albania ©


# *Berati*

*2400 karat  
ofertë turistike*

Foto: Blue Albania ©

# Berat, a 2400 years-old precious package




 Berati, trashëgimia jonë e UNESCO-s, që "doli në dritë" edhe njëherë me rikonstrukcionin e rrugës Lushnje-Berat, ka njohur vetëm rritje të turistëve çdo vit, sidomos atyre të huaj. Vetëm në vitin 2017 qyteti dhe zonat përreth u vizituan nga më shumë se 60 mijë turistë, një shifër kjo e kënaqshme po të mendosh numrin shumë të ulët të pak viteve më parë. Tashmë mund të thuhet se Berati ka një ofertë të plotë turistike kulturë-naturë-aventurë dhe për fat të mirë mundëson zhvillimin e një turizmi gjithëvjeter. Megjithëse realiteti aktual nuk flet për fluks gjatë të gjithë vitit, sezoni i lartë është shtrirë ndjeshëm, duke filluar qysh në muajt e parë të pranverës, me një rritje kulmuese në muajt korrik-gusht dhe vazhdim të grupeve vizitore deri në vjeshtën e vonë.

 Berat is a valuable heritage city protected by UNESCO. It came back to light after the reconstruction of Lushnje-Berat road and it has experienced a yearly increase of tourists, especially foreign ones. Just during 2017, Berat and the surrounding areas, received 60,000 tourists, a satisfactory number considering the lower number of visitors in previous years. It can be said now that Berat offers the full touristic package culture-nature-adventure and fortunately, it accommodates a year-round touristic season. In actuality there isn't an all year surge, the high season is spread significantly, starting from the early months of spring, reaching an ever increasing peak in July-August, while groups of visitors continue to arrive until late autumn.



[www.alrafting.org](http://www.alrafting.org) ©



© Qendra Kombëtare e Muzeve Berat



© AADF




Shkëlzen Rexha©



© Qendra Kombëtare e Muzeve Berat




Adis Shera ©

 Që të jemi të sinqertë, para pak vitesh shikonim me trishtim autobusët e rrallë të lodhur nga rruga e keqe, që zbrisnin turistët përballë hotel Tomorit apo buzë Mangalemit dhe na vinte keq që gjithë ky qytet rrinte kot; një pasuri kulturore që kishte pak vite që kishte hyrë në listën e UNESCO-s, që vizitohej nga aq pak turistë të huaj!

Berati ka trashëgiminë kulturore mijëra vjeçare, një qytet-kala që jeton jetën pa ndërprerë prej më shumë se 2400 vjetësh, si asnjë vend tjetër në Shqipëri, me një pasuri kulturore të paçmueshme, ku trashëgimia fetare përcillet jo vetëm nëpërmjet objekteve të shumta të kultit por edhe veprave të rralla të Onufrit, me një muze të jashtëzakonshëm, që është edhe objekti më i vizituar në qytet nga turistët e huaj. Bashkë me Muzeun Etnografik, Muzeun Onufri përbën një ansambël që mban emrin Qendra Kombëtare e Muzeve Berat, dhe që gjeron një numër të lartë vizitorësh që rritet çdo vit, edhe për shkak të një menaxhimi shumë të mirë të një stafi të përkushtuar e profesional.

Të bujtësh në Berat është tashmë një përvojë e paharrueshme. Vërtet që vetëm fjetja nuk është hallka më e rëndësishme e një përvoje turistike por një pjesë e mirë e hoteleve në Berat, të vendosura në lagjet e vjetra të Mangalemit dhe Goricës, si dhe në brendësi të Kalasë, nuk ofrojnë vetëm fjetje. Hotel Mangalemi, Hotel Belgradi, Hotel Vila Aleksandër, Hotel Muzaka, Bujtina Kodikët, Hotel White City, Vila Sigal, janë kthyer në muze të gjallë, ku çdo element i ndërtesave të tyre apo mobilimit të brendshëm përcjell një vlerë në traditë apo histori. Të konsumosh një vakt mëngjesi apo drekë-darke në secilin prej këtyre hoteleve nuk është thjesht të ushqehesh por të njohësh gastronominë e të gjithë zonës së Beratit, me glikotë, ushqimet natyrale, gatimet tradicionale që kanë dalë nga recetat e vjetra të amvisave beratase dhe janë bërë kryefjala e menuve të restoranteve. Produktet e famshme të Beratit si vaji i ullirit, verërat e kantineve të njohura Çobo, Nurellari, Luani, fiku i Roshnikut apo reçelnat e glikotë, janë kthyer në produkte lokale nga Sidnej sh.p.k, dhe i ofrohen turistit si suvenir.

E meqë jemi tek suvenirët, vështirë se gjen qytet tjetër turistik në Shqipëri që të ketë mjeshtra drugdhendës e gurgdhendës si ata të Beratit. Si në asnjë vend tjetër, suvenirët autentike janë ato që mbushin vitrinat e antikuarëve apo dyqaneve të suvenireve, duke

 In all sincerity, a few years ago we looked with sadness at the few busses stopping by, which were exhausted after trading in the rugged roads. The tourists got off in front of Tomorri hotel or besides Mangalem and felt dull with the idleness of city, a cultural heritage that had recently become part of UNESCO, and that received so few tourists from abroad!

Berati's cultural heritage is multiple thousands-years-old, a castle-city that lives uninterrupted for more than 2400 years, not akin to any other place in Albania, with an invaluable cultural heritage. The religious heritage for example is preserved in many cult objects and the rare oeuvres of Onufri, with an exceptional museum, which makes the most visited object in the city by foreign tourists. Together with the Ethnographic Museum, Onufri Museum makes up the ensemble that holds the name of National Center of Museums of Berat that yields a high number of visitors, which increases with each passing year. This is also thanks to a highly efficient management staff, who are committed and professional.

Lodging in Berat makes for an unforgettable experience. Admittedly, sleeping is not the most important part of a touristic experience, but a large number of hotels in Berat, located in the old hoods of Mangalem and Gorica, and within the castle walls, don't just offer a good sleep. Mangalemi Hotel, and hotel Belgradi, Vila Alkesander, Muzaka, Kodiket, White City, Vila Sigal have become rare museums, each element of the buildings, the inner decor and furnishing transmit a valuable piece of tradition or history.

Eating breakfast, lunch or dinner in each of the aforementioned hotels is not a simple experience but one where you can learn about the regional cuisine, and taste gliko, organic food, and traditional dishes that are prepared using old recipes from homemakers of Berat, and take center focus in the menus of city's restaurants. The famous products of Berat such as the olive oil, and the canteen wines of Cobo, Nurellari, and Luani, the figs of Roshnik or the jams and glikos are the local products made by Sidnej inc., which serve as souvenirs for tourists. And talking about souvenirs, Berat is a unique place, because of the master woodcarvers and stone-carvers. Unlike any other place, the authentic souvenirs are displayed in the windows of antique and souvenir shops, avoiding at a maximum the



© Qendra Kombëtare e Muzeve Berat



© Qendra Kombëtare e Muzeve Berat



© Qendra Kombëtare e Muzeve Berat



© 1001 Albanian Adventures

shmagur maksimalisht shitjen e produkteve kineze, që rëndom i gjen nëpër vitrina dyqanesh kudo nëpër Shqipëri. Berati ka një qendër artizanati, që funksionon si kooperativë dhe që synon të nxisë prodhuesit lokalë t'u kthehen punëve të dorës, aq të kërkuara në treg nga turistët.

Berati për fat të mirë ka disa zyra të informacionit turistik, përveç asaj të bashkisë, që ofrojnë shumë shërbime për turistët dhe ky është një standart pozitiv po të kemi parasysh që jo të gjitha qytetet turistike shqiptare ofrojnë zyra turizmi. House of Tourists, 1001 Albanian Adventures, me zyrat e tyre të informacionit nuk kufizohen vetëm në orientime rrugësh apo adresash, apo shitje suveniresh të vogla por në oferta paketash të plota turistike për ta vizituar Beratin në disa ditë. Djem e vajza të reja nga 1001 Albanian Adventures, mbushur me pasion i bien shtigjeve kryq e tërthor, duke e njohur turistin edhe me anën e Beratit që nuk duket ose që nuk ngjan aq e rëndësishme sa kultura; me rrethinat natyrore dhe përvojat lokale. Kjo ka ngjallur shumë interes tek turistët që janë të etur për zbulime të reja.

Berati ka një aset të çmuar që rrallë qytete kulturore e kanë; një xhevahir natyror si Kanioni i Osumit, të cilin Albania Rafting Group e ka shndërruar në destinacionin më të pëlqyer të aventurës në Shqipëri dhe me të cilin prej vitesh prezanton Shqipërinë nëpër aktivitete turistike nëpër botë. E cilësuar si një prej përvojave më të bukura, Aventura e rafting në Kanionet e Osumit e përmes rrugës Berat-Përmet, e kombinuar edhe me rafting në Vjosë, mund të thuhet pa frikë se e ka rritur ndjeshëm numrin e turistëve në Berat vit pas viti.

Sot, të kënaqur nga numri gjithnjë në rritje i vizitorëve, mezi po presim të vijë ajo ditë kur rrugët e qytetit, sokakët e Mangalemit e të Goricës dhe labirinhet e Kalasë, të jenë të mbushura dimër-verë me turistë. Sepse Berati e meriton. Ai i ka të gjitha!

Chinese stuff that can be usually seen in other window shops around Albania. Berati has an artisanal center that works as a cooperative and encourages local producers to return to handmade techniques, so much preferred by tourists nowadays.

Fortunately for Berat, there are some tourist point offices that offer many services for tourists and this is a positive trait, since not every touristic city in Albania offers tourists info points. House of Tourists, 1001 Albania Adventures, with their info offices are not limited to street and road orientations, or trading small souvenir, but they offer full tourist packages to visit Berat for several days. They young folks at 1001 Albanian Adventure are avid and they discover all hidden trails and present them to the tourist. These are the undiscovered parts of Berat, the surrounding natural spots and local nuances that at first sight don't seem as important as the cultural side. This has drawn a great deal of interest among tourists that are hungry for fresh explorations.

Berat possesses a valuable asset, incomparable to any other cultural city; Osumi canyon is a natural gem that has become a preferred destination in the Albanian adventure thanks to Albania Rafting, which presents this experience in tourist actives around the world. Deemed as one of the most beautiful experiences, the rafting adventure in the Osumi Canyons across the road of Berat-Permet, combined with the rafting in Vjosa River, have admittedly increased the number of tourists in Berat, each year.

Today, satisfied by the ever increasing number of visitors, we are impatiently expecting the moment when all the streets in the city, the neighborhoods of Mangalem and Gorica, and the mazes of the castle will be full of tourists in summer and winter. Because Berati deserves it. It has everything!

## National Center of Museums Berat

You can't miss the most attractive spot of the city: The Castle. It is situated on the top of the hill. And inside the castle, the numerous cult objects but above all, the Museums: Onufri Iconographic Museum and Ethnographic Museum. The main cultural heritage is hidden there.

**Qendra Kombëtare e Muzeve Berat, lagja "13 Shtatori" Rruga "Toli Bojaxhiu" Berat**  
Tel: 0035532232224; Agron.Polovina@muzeumetberat.gov.al  
[www.muzeumet-berat.al](http://www.muzeumet-berat.al)

### TIME TABLE:

**Winter Opening Hours:**

1 October - 30 April

Every Day 9.00 - 16.00 / Sunday 9.00 - 14.00

**Closed: Monday**

### Summer Opening Hours:

1 May - 30 September / Every Day

9.00 - 19.30

**The Price Of Tickets: 200 ALL / Euro 2**

Soraldo Nebo



# Saranda në vjeshtë?

Po, madje edhe në dimër

*Me midhje, vreshta, ullinj e mandarina*





# To Saranda during Autumn?

## Yes, even during Winter

*plenty of mussels, vineyards, olives and tangerines*




**T**ë gjithë ne, kur na zënë në gojë Sarandën, na shkon mendja te deti, Butrinti, Ksamili, Syri i Kaltër, jeta e bukur e natës dhe kjo atmosferë alegrie mbaron me katër muaj sezon vere, me mallëngjim themi, Saranda është e bukur në verë se në dimër këmbë njeriu nuk gjen, e s`ke çfarë bën.

Trendi botëror i turizmit sipas Organizatës Botërore të Turizmit është: Një turist kur viziton një vend do të përjetojë eksperiencat e vendit ku ai zgjedh të kalojë pushimet si: ushqimi, muzika, prodhimet vendase, sjellja, traditat, kultura etj dhe natyrshëm na lindin ideja që ne nuk është se kemi vetëm detin, Butrintin dhe Ishujt e Ksamilit për të prezantuar por kemi edhe Midhjen e Liqenit, ullinjët e Kodrave të Sotirës në Ksamili, kemi plantacionet e mandarinave në tokën e agrumeve me fshatrat matanë Butrintit, Xarra, Vrina, Mursia, të vendosura majë kodrave dhe fushat që shtrihen poshtë tyre nga të katër anët.

**U** When talking about Saranda, the majority of people think of the sea, the archaeological site Butrinti, Ksamili beaches, the Aquamarine Eye, and the beautiful night life, while this entertaining atmosphere lasts for the four months of summer. And after we reminisce with nostalgia about this season in Saranda, because we believe that in winter there is nothing left to do and not a breath's presence felt.

According to the World Organization in Tourism, the latest world's tendency is this: Once a tourist visits a country, they seek to experience the place while tasting the food, listening to the music, exploring the local produce, traditions, behaviours and culture. We are conscious that we don't offer only the sea, Butrinti and the islands of Ksamili. There are also the Mussels of the Lake, the olives of the Hills of Sotira in Ksamili, there are the tangerine plantations in the land of citrus and the villages of Butrinti, Xarra, Vrina, Mursia, located on top of the hills with fields laying at the bottom.



## Po çfarë të bësh në vjeshtë dhe dimër në Sarandë?

Si promovues të turizmit në këtë zone, ne dolëm këtë verë me me produkte konkrete, të cilat u pritën mjaft mirë nga turistët, si Turi i Midhjes, një tur i veçantë i paofruar më parë, i cili u dha mundësinë turistëve të përjetonin përvojën vendase të njohjes së zonës së bukur të Butrintit dhe Ksamilit si dhe shijimin e Mbretëreshës së Liqenit, direkt nga vendi ku ajo mblidhet. Dhe meqenëse ky tur dhe shumë shërbime të tjera të vogla, u pritën me karrahë hapur nga vizitorët, në po guxojmë pak më shumë e po propozojmë disa ture interesante për periudhën e vjeshtës dhe dimrit, që Saranda të mos jetë vetëm një destinacion disamujor por të presë vizitorë gjithë vitin.

### Mbledhja e ullinjve

**Mesi i Tetorit deri në fillim Dhjetori**

Së bashku me vendasit shkojmë për të mbledhur ullinj, me teknikat vendase, hamë drek aty poshtë ullinjve, ulur nëpër taraca me prodhime vendase. Pas drekës, ora e leksionit mbi



## What can you do during autumn or winter in Saranda?

As the area's tourist promoters, this summer we came up with actual products that were well received by the tourists, like the Mussel Tour, a very unique tour offered for the first time, which gave tourists the possibility to experience the local sensation and getting to know the good looking Butrint and Ksamil and savouring the Queen of the Lake, right at the place of harvest. While this tour and other minor services were very well received, we are mustering up some courage and suggesting a couple of interesting tours suitable for autumn and winter. So that Saranda will not only be a summer destination, but it can expect visitors throughout the year.

### Harvesting Olive

**Mid October to beginning of December**

We join the locals in the mission to harvest olives, using the local techniques, and then we take our lunch under the olive trees, sitting down at the terraced valley with local produce. After lunch, we experience an hour of lecture over the types of olives, their season and the necessary climate conditions. In





ullirin, llojin, sezonet, klima që i duhet. Në mbrëmje ulliri që është mbledhur çohet në fabrikë për vaj, edhe aty përvojë më vete, kur sheh dhe provon vajin mjaftueshëm të virgjër të prodhuesve lokalë.

## Turi Mandarinave

Fundi i Tetorit deri në fund të Janarit

Nisemi te plantacionet poshtë Miles, që i përfshin fshati Xarrë, pasi pajisemi me dorashkat dhe gërshërët, fillojmë vjeljen e mandarinave së bashku me fermerët që punojnë në plantacion, dreka shtrohet me bollëk në produkte të vendit, edhe në pamje pasi para nesh shtrihet deti deri në Korfuz, Butrinti dhe liqeni në të djathtë, fushat dhe fshatrat përball nesh. Leksione përreth një orë, duke lëvizur midis mandarinave nga më të vjetrit e fermës. Kthehemi në të perënduar të diellit.

Ne jemi këtu edhe dimrit po aq të bollëkshëm dhe të këndshëm sa në verë.

**Duhet vetëm të na shijoni!**

the evening, the olive is transported to the oil factory, and there we experience another event, while observing and tasting the virgin oil made by local producers.

## The Tangerine Tour

End of October until end of January

After we are equipped with hand gloves and scissors, we start off our tour down the plantations of Mile, which is part of Xarrë village, and together with the farmers we gather tangerines. Lunch is abundant in local food, there is plenty of stuff for the pleasure of the eye with the sea in the horizon in Corfu and Butrinti, and on the right, there is the lake, the fields and the surrounding villages. After one hour long lecture as we move from one tree to the next gathering tangerines, we return at the sun's dawn.

We are here also during winter and we assure you that it is abundant and entertaining just like summer.

**You are invited to give it a try!**

Për të prenotuar turin / to book the tour:



ONCE TOURIST ALWAYS FRIENDS



[www.ksamil.al](http://www.ksamil.al)

Phone: +355672000981

Mail: [nebosoraldo@gmail.com](mailto:nebosoraldo@gmail.com)

Adress: Ksamil- Sarande, St. Antoni Athanas



# Mikpritje pukjane Me ngjyra vjeshte

Kur mendojmë të nisemi për Pukë, mendja na shkon automatikisht tek Xhimi Begeja dhe tek Përparim Laçi. Dhe nuk ka si të jetë ndryshe, sepse nëse shkon në Pukë, ose do të flesh në Hotel Turizëm Puka si mbret, ose do të bujtësh tek Hani i Përparim Laçit si mik shtëpie. Ne zgjedhëm të dytën, meqë në hotelin e Xhimit kishim fjetur më parë.

Hani i Përparim Laçit është pa mëdyshje më i miri në Shqipëri. Papi iu përgjigj me "po" nismës së atëhershme të GIZ-it për ta kthyer shtëpinë në njërin prej 40 haneve të Shqipërisë e sot, ndonëse është shtuar shumë numri i shtëpive pritëse, jo të gjitha ato 40 që u quajtën hane, e vazhduan traditën. Pastaj për shkak të konotacionit negativ që ka fjala "han" në Shqipëri, shtëpitë pritëse e kthyen emrin nga "han" në bujtina. Vetëm Papi nuk e ndërroi dhe vazhdoi të quhej "Hani i Përparim Laçit". Dhe mirë bëri. Sot është i vetmi.

Kur para shtatë vjetësh ktheheshim nga pista skive me këmbët qull nga bora, e shoqja e Papit na priste te soba me çorapet e thata dhe çajin gati. Këtë herë ishte ndryshe. Tek hani i ri që ka ca vite që është bërë, të pret oxhaku në mes të dhomës, rreth e qark, çifteli e

sofra, qëndisma e zbukurime, e kanë kthyer vendin në muze tradite. Papi dhe e shoqja na presin krahëhapur, fëmijët gjithashtu. Tashmë janë rritur dhe secili ka nga një detyrë në mbarëvajtjen e punës. Tryeza mbushet plot, nuk të pyet njeri çfarë do porositësh. Mazë, Fli, mish zgarë, djathë nape, turshi, raki thane, e pas buke (pasi jemi dëndur në të ngrënë), gështenja dhe verë te oxhaku.

Na bëhet zemra mal që tashmë Hani është rritur në bukuri e në kapacitet. Papi po ndërton vilat e reja prej druri sepse kërkesat e turistëve për qëndrim në Pukë janë rritur.

Puka po bëhet. Jo se s'ka qenë por kur themi po bëhet, e kemi fjalën për Pukën turistike. Shumë gjëra të bukura po ndodhin në qytetin e vogël verior, që shumë shpejt do ta shndërrojë në një Valbonë të dytë. Nuk mund të thuhet se Puka nuk pret turistë, përkundrazi, shumë festa të përvitshme, si "Sofra Pukjane" apo festa të shumta lokale të natyrës dhe aventurës organizohen rregullisht atje. Sheshi i vogël i qytetit ngahera mbushet plot me motorristë të huaj që pëlqejnë të bëjnë aventura nëpër malet tona.

Por tani është ndryshe. Xhimi Begeja





Hani i Përparim Laçit



Hotel Turizëm Puka

i cili i bashkohej parkut ekzistues ku pemët tashmë ishin aty prej disa dekadash dhe kishin krijuar një pyll të bukur. Rreth e qark liqenit, një zinxhir i gjatë rruge në formë shëtitoreje, që shërbente edhe për biçikletat, që kur mbyllej e vinte sërish para Hotel Turizëm Pukës, bëhej rreth 2 kilometra. Fantastike! Por prisni, ka edhe më. Po aty, do të ndërtohet një park aventurash dhe një Zip Line, më e gjatë se ajo që është në Bogë të Rugovës. Shpresojmë që brenda muajit ta kemi mbyllur dhe dimri ta gjejë Pukën së paku me dy liqene.

Edhe ne shpresojmë shumë. E duam Pukën, këtë qytet të vogël e zemërbardhë. Ka njerëz shumë mikpritës e të gëzueshëm. Shpresojmë gjithashtu që askush të mos e lërë më qytetin, e as fshatin por t' u kthehen shtëpive e t' i hapin ashtu siç ka bërë Papi me Hanin e tij e ashtu siç ka bërë Xhimi që ka ardhur nga Tirana dhe gjysmën e jetës e ka kaluar në Pukë. Sepse nesër kur të vijnë turistët e shumtë, duhet t' i kenë dyert e hapura dhe sofrat pukjane të shtruara. Dhe atëhere të festojmë me raki thane dhe Birrë Puka natyrisht.

**Pukë, 22 tetor 2017**

ishte shend e verë, teksa na tregonte se sheshi po ndryshonte rrënjësisht. Rikualifikimi urban do ta bëjë qendrën me pllaka natyrale, pra një shëtitore të bukur. Ndërtesat do të vishen të gjitha me çati alpine dhe do ta shndërrojnë qytetin në një xhevahir të vogël. Por nuk mbaron këtu. Se kjo po ndodh me të gjitha qytetet e vogla. Ajo që vjen më pas është më e bukura.

Puka po bëhet me dy liqene, madje jo me dy por me tre. Përveç atij që ka, pak në të dalë të qytetit, do të ketë një të dytë, mu në zemër të qytetit. Kantieri kishte marrë formë, dhe Xhimi teksa na tregonte, vinte vërdallë me këpucët me baltë. Kur e pyetëm po ai pse punonte aty dhe mbante gurët së bashku me punëtorët gjithë qejf, na e ktheu: Sepse liqeni po bëhet në oborrin e shtëpisë time. Dhe oborrin im do të zbukurohet, unë do ta gëzoj më shumë se të gjithë. Natyrisht edhe turistët.

Projekti dukej vërtet madhështor; një liqen i vogël artificial



Xhimi Begeja,  
në parkun e ri të Pukës

GASTRONOMI

# *E gjithë bota në Hotel Adriatik*



Flora Xhemani Baba



**■** Po të përpiqesh të kapësh thelbin e kësaj shprehjeje, duhet të kalosh nëpër shumë dimensione. Mirëpo ne e kemi në fakt për kuptimin e parë të fjalës. Sepse Hotel Adriatik që në ngjizje u krijua si një tempull kozmopolitan që, ndonëse pjesë e një vendi të izoluar komunist, do të priste turistë nga e gjithë bota. Dhe ashtu ndodhi. Të gjitha ngjyrat dhe kombësitë parakaluan për dekada, në një prej vendeve të pakta në Shqipëri ku mund të ndodhte një gjë e tillë.

Dhe ashtu është edhe sot por në përmasa të tjera, e natyrisht nën një dritë tjetër, në atë të lirisë së fantazisë, shijeve të rafinuara e detajeve që atëhere as që mund të mendoheshin por që sot e kaltojnë shkajshmërisht gjithçka që ky hotel ofron, duke ia shtuar hijeshinë dhe sharmin, edhe kur ofrohen thjesht.

Thënë shkurt, sot do bëjmë një udhëtim shumë të veçantë. Do të udhëtojmë sërish nëpër botë ndonëse stacionin e nisjes dhe të mbërritjes e kemi në Hotel Adriatik, në Durrësin e bukur, që në këtë mes vjeshte që ngjan si verë, është edhe i qetë, edhe i magjishëm. Do të udhëtojmë vërtet por përmes shijeve, atyre shijeve kozmopolitane të kuzhinës, apo më mirë, të kuzhinave të Adriatikut e do t'u biem kryq e tërthor kontinenteve. Sepse e besoni apo jo, e gjithë bota gjendet në Hotel Adriatik. Çdo lloj kuzhine mund të shihet këtu. Dhe nuk bëhet fjalë thjesht për një lloj pjate që një shef i talentuar kuzhine mund dhe duhet të dijë ta gatujë patjetër. Po përpiqemi të themi që secila nga kuzhinat specifike në Adriatik drejtohet nga një specialist i kulinarisë që vjen nga një kulturë gastronomike e caktuar, Pastigjia, kuzhina Aziatike, kuzhina Italiane me pastat e freskëta dhe ajo Shqiptare, secila ka nga një profesionist të mirëfilltë dhe me përvojën e edukimin përkatës. Ja për shembull, për të ofruar gatimet e ndërlikuara të kuzhinës aziatike, që për shijet e sotme të rafinuara, edhe të shqiptarëve të bredhur, është shumë në modë, hoteli ka në dispozicion një shef Ekzekutiv jo vetëm me kombësi aziatike, por edhe me një përvojë të gjatë në xhep, e cila ka kaluar përmes zinxhirit të shumë hoteleve Prestigjioze nëpër botë, ka gatuar për familje Mbretërore e ka mbi 30 vjet eksperiencë, por që me shumë thjeshtësi dhe modesti na pret, na takon, shpjegon ushqimin që gatuan dhe buzëqesh me habinë tonë.

E për të kaluar në ekstremin tjetër të pamendueshëm, surprizën e dytë të radhës këtu, për të patur në dispozicion gatime tradicionale shqiptare, që janë fjala e parë e turistëve të huaj, ka ardhur dora vetë, një amvisë përmetare, por që i njeht shumë mirë edhe pjatat e Shqipërisë së Mesme! Teta Vasilika (stafi ka filluar ta thërrasë kështu me familjaritet, qyshkurse fëmija i disa klientëve të përhershëm thoshte se donte byrek nga ai që bënte Teta Vasilika) është mbretëresha e kuzhinës shqiptare, që kalon nëpër duart e saj, byrekët dhe lakrorët e famshëm, tavat e

## *Experience the taste of the World in Adriatik Hotel*

**■** 60 years ago, Hotel Adriatik was built from scratch, on the Albanian coast, and was the first Luxury Hotel & a cosmopolitan temple. Although Albania was a communist country at the time, tourists from all around the world were welcomed at the hotel.

People of all flag colors and nations has experienced the hotel since 1957.

Today, completely renovated and refurbished, in June 2017, covered in Glamour and charm, with marble and decorations, special room interiors, authentic Albania, Albanian names for the events rooms, emphasizing the artistic Albanian artworks, present in every inch of the hotel interiors, rooms, lobby,

This wonderful gem, shines bright and gives Durres back that old exclusive feeling, related to the history of the hotel.

Today me and my family, stopped to have lunch, in a beautiful sunny day of mid October,.... 29 Degrees Celsius, having a bath, in the Hotel's private beach.


Seated on the Terrace of Apolonia Restaurant, located in this Historic Hotel, we were surprisingly amazed.

We explored the magic of "traveling" different flavors of the cuisine, proudly served in Hotel Adriatik, and it was really magic, like traveling the world, sitting in a tastefully decorated table, overlooking the Adriatic Sea.

Believe me, just seat and relax....it is a Million Dollar view!

The Hotel's cuisine is run by a very experienced Executive Chef, with more than 30 years of experience, heading the kitchen in Prestigious Hotels, cooking especially for Royal Families in



 shumta me perime e zogj fshati, ëmbëlsirat që si ajo askush s'i bën dot, e sidomos ato që vijnë drejt e nga vendlindja e saj e që janë shpallur "Presidio slow food" nga Slow Food International; glikotë e Përmetit. Të gjitha llojet. Le të mos vazhdojmë më tej, për të thënë që jo vetëm ëmbëlsirat por edhe akulloret bëhen vetë në kuzhinën e Adriatikut, madje akullore si qëmoti, me qumësht fshati, kupa inoksi dhe krejt të bardha, me pak reçel përsipër. Pra, asgjë e gatuar nuk vjen nga jashtë, gjithçka gatuhet aty.

Do thoni ju, pse, u gatuaka kuzhinë tradicionale në një hotel me pesë yje, ku presupozohet të shërbehet vetëm ushqim elegant, shampanjë, verë e cilësisë së lartë, e takëme të këtij lloji? Posi jo, gatuhet që ç'ke me të. Sepse kryefjala e një hoteli turistik janë turistët, dhe turistët duan kuzhinë shqiptare më së pari.

Gjatë ndryshimeve rrënjësore të vitit të fundit, në bisedat e gjata me Menaxheren , (sepse nëse kishit kohë pa qenë në Adriatik, nëse shkoni tani së fundmi dhe keni vënë re ndryshimet drastike, duhet të dini se pas çdo detaji, qëndron mendja dhe dora e kujdesshme e saj), shtylla kryesore e bisedës vinte pikërisht tek ushqimi, si baza e shërbimit për turistët, sidomos ata të huaj. Sepse nëse forma, pra dekorimi, shërbimi, ambientet, dhomat, detajet e gjithçka tjetër, ishin më të zgjidhshme në momentin që ndahej stili, përmbajtja, pra ushqimi, është një çështje shumë delikate. Nuk mjafton vetëm të gatuash mirë, duhet që edhe përbërësit të jenë po ashtu të zgjedhur. Mundësisht jo në treg por në natyrë, në gjendje të egër (fruta pylli, barishte të egra), ose sa më natyrale (produkte fshati, vajra punishtesh dore, bukë pa maja, mish i rritur në kullota natyrale, peshk i egër) dhe në shije sa më të veçanta.

Me ofrimin e kuzhinës tradicionale (jo thjesht shqiptare, të përgjithshme por gatime shtëpie, pjata nga zona të ndryshme) kemi qëlluar në shenjë, thotë Nevila, sepse kur ua propozojmë të huajve si risi, mbeten aty dhe e kërkojnë sërish të nesërmen.

E nga mos mbeteshin ata? Pula në tavë balte me patate e teta Vasilikës, ishte bërë që të lëpjej gishtat (mund të hash edhe me duar në hotel me pesë yje, nuk është turp :)), pale byreku me lakra të egra. Ne na pëlqeu t'i shijonim me verë të bardhë. Shqiptare. Shkonin shumë. Natyrisht sepse shoqëruar me perimet, me salcat dhe garniturat tradicionale, kombinimi bëhej perfekt.

Mirëpo Adriatiku është universal dhe e ka për detyrë t'i ofrojë kuzhinat e tjera, në të njëjtin nivel cilësie secilën. Le të dalim pak tek kuzhina mesdhetare. E ku ka turist që nuk dashurohet pas saj! E ku ka shije më të thella e më të plotë! Si mund të mos adhurohet për shembull një pjatë e thjeshtë në dukje siç është pasta e gatuar vetë, me fruta deti! Gjithë aromat e Mesdheut janë aty brenda. Vetëm të mendosh për agrume, vajra ulliri ekstra të virgjër, djathra të shijeve të ndryshme, midhje, oktapodë, peshqit e mrekullueshëm të ujrave të kristaltë të Jonit e Adriatikut (Adriatikut tonë :) ) dhe të ikën mendja, imagjinoni pastaj t'i shijosh nga dora e një kuzhinieri

 Southern Asian countries and Middle East, in most famous Hotel Chains in Singapore, Indonesia and Malaysia and other parts of the world.

The second surprise was that, this Chef smiles, chats, is so kind and humble, he comes by himself, to show and explain the food , right to your table.

But don't get fooled only by the authentic , fantastic, Asian Fusion taste, sushi or noodles, and if you are really interested to taste the real traditional Albanian cuisine, our Albanian chefs either, won't disappoint you .


Teta Vasilika , this is how they call here here, is an Albanian Chef , very experienced, from Permeti Region , Southern East Albania, very famous for her great dishes, recipes, desserts, "gliko" especially, who are also sold at the Store located in the Lobby, so you can always take Gliko with you if you like it.

She was graduated from the Old Style Culinary School of Communism times , and is delivering "Le crème de la crème" of Albanian Cuisine, preparing "Presidio SLOW FOOD " named like this from the Slow Food international.

Some of the most special traditional plates are the pie filled with spinach and ricotta, the oven baked specialties , fresh country broilers with rice or "Quill ", and many other mouthwatering dishes, that I really can't describe, but I took many pictures of, that somehow taste better than the ones my mother prepares home ....

It's a surprise to us, to find traditional cuisine, in here, we were thinking that they were serving only fancy dishes and caviar .....

But, in contrary, the fact that the Albanian cuisine is so much appreciated in this 5 Star Resort, and got the best reviews so far, was the General Manager's choice, to insist to

 të mirë. Sepse talenti i një kuzhinieri ka rëndësinë e vet. Është ai që e bën të shkëlqejë një pjatë të gatuar siç duhet. Ja për shembull kur shikon levrekun e sapodalë nga rrjetat e peshkatarëve në një pjatë me këtë pamje, mendon duke vënë buzën në gaz se çdo levrek do të shtrihej me qejf aty. Kuzhina Mesdhetare është baraz me dashurinë.

Mozaiku i gatimeve është kaq i larmishëm në Hotel Adriatik, sa që nuk ka si të mungojë kuzhina aziatike. Kaq në modë sot në Shqipëri. E nëse nuk e gjeni në një vend kozmopolitan si Hotel Adriatiku, që pret turistë nga e gjithë bota, ku mund ta gjeni tjetër? Sepse si të themi, e do njeriu një gotë verë e një dorë sushi, që bisedat me miqtë darkave të bëhen më interesante kur në to përfshihet edhe sushi, si trendi i fundit gastronomik në Shqipëri. Prania e salmonit kryesisht apo e havjarit tek sushi (ndonëse sushi mund të gatuhet me gjithçka, sipas mendimit të shefave specialistë të fushës), e ekzaltton pak më shumë bisedën, që tenton të shkojë drejt shijeve të rafinuara, ekzotikës së orientit të largët, që identifikohet me kombin më të përparuar teknologjik në botë, (jetojmë apo s'jetojmë në epokën e udhëtimeve pa kufi?).

Por një kuzhinë që të jetë autentike ka nevojë të gatuhet nga një dorë vendase. Për këtë qëllim ka ardhur një kuzhinier aziatik në hotel, që jo vetëm njeher mirë filozofinë e ushqimit që vjen nga vendi i tij por dallon gjithashtu edhe diferencën mes një shijeje të rafinuar e asaj të zakonshme. Meqë ra fjala, Sushi ishte "excellent" dhe megjithëse nuk jemi njohës të thekur të tij, na pëlqen të besojmë se ishte edhe për meritë të kuzhinierit e jo vetëm të përbërësve.


Dita e gjatë në Adriatik ne na shkoi për mrekulli, shumica e arsyes ishte për shkak të paradës që bënin sa kamerierët e sa kuzhinierët para tryezës tonë, një paradë e vërtetë degustimi, siç parapëlqehet të thuhet në gjuhën e sotme të gastronomisë. Por ajo që e kopsiti mrekullueshëm këtë të diel të diellit, ishte koha. Moti domethënë. Një det i paqtë ku ishte mëkat të mos laheshe (dhe neve nuk na pëlqejnë mëkatet kështu që u lamë) dhe që të huajt si përfituesit më të mirë të Shqipërisë, e shfrytëzuan më së miri. Dhe kur dielli erdh e u ul këmbëkryq mbi tryezën tonë në verandë, menduam se kishte ardhur koha të shkonim. Duke qenë se ëmbëlsirat e mrekullueshme, kekun e çokollates, Mystic Dessert, ëmbëlsirën e krijuar posaçërisht si veçanti e këtij Hoteli (Signature Dessert) dhe akullore bio me qumësht fshati, i kishim provuar edhe herë të tjera, nuk deshëm ta prishim shijen shumëdimensionale të paradës tonë gastronomike. Teksa prisnim të vinte kamerieri e t'ia thoshim këtë, ai ia behu me një pjatë që nga larg i pamë vetëm ngjyrën e portokalltë të ndezur.

Pak revani hasude nga Teta Vasilika, si për mbyllje, tha buzagaz.

Dhe ne që kishim menduar ta mbyllnim pa ëmbëlsirë. A mund t'i thuhej jo? Eh moj teta Vasilika, të lumshin duart, që e kishe qarë revani hasuden!

Dhe, duke qenë se kemi dëshirë ta themi mendimin tonë e jo për arsye kahjesh nacionaliste, edhe neve sot, na lanë pa mend gatimet e teta Vasilikës. Të gjitha pa përjashtim. Dhe mund ta themi pa frikë, me gjithë respektin për sushin, shijet e mrekullueshme të kuzhinës italiane apo çfarëdolloj gatimi të një kombi tjetër. Kuzhina shqiptare është Mbretëresha. Dhe për fat të mirë, këtë e kanë kuptuar edhe turistët. Sepse jo vetëm dhe thjesht për të blerë përvoja por sepse ata duan dhe preferojnë kuzhinën shqiptare. Dhe shijet e saj unike e autentike, i gjeni në Hotel Adriatik.



 give this special experience of tasting the real Albanian food of first quality ingredients, to every foreigner or Albanian, visiting the hotel.

Everything here speaks a classy, tasty, and soft Albanian.

We can't leave behind the great, fresh seafood, the fish who comes everyday from the Fishermans, who go and fish with their small boats, in Adriatik Sea.

A smart and rich combination of different sauces, made this last tasting Menu incredibly amazing. The kids did enjoy every single bite. :) even the italian style fresh pasta with seafood ....All the mediterranean simple and lovely taste ....

Concerned about having too much? You have to forget about the calories, well, is a Sunday, is our free day !!

Without any doubt, don't try to skip the dessert here, a whole pastry staff is behind all that, the Mystic dessert - the hotel's signature dessert, Revani, Chocolate cake, Banana fritters with ice cream, and many other choices of dessert, who are being prepared fresh daily, with the flour who is brought here from the local villages and is 100% wholegrain, tasty and healthy.

First quality food, at incredible prices, this is the place where quality, really meets the price you pay, without forgetting a large choice of local wines, beers, and international ones.

This was our Sunday of Mid October, how about yours?



# ALER Restaurant

*Çfarë planesh keni  
këtë fundjavë?*



Nuk është e thënë që pse mbaroi sezoni nuk mund të shkoni në bregdet për pushime apo për një fundjavë, përkundrazi, tani deti shijohet më mirë. Mungon kaosi dhe rrëmuja, mungon trafiku i dendur dhe shumë detaje të tjera që për hir të së vërtetës, nuk është se janë shumë të këndshme në sezonin veror. Përveç kësaj edhe shërbimi e ushqimi janë më të mirë në një stinë të qetë e pa fluks. Ja për shembull, në restorantin e ALER HOTEL, tek Mali i Robit, mund të shijoni kuzhinë të shkëlqyer mesdhetare, ta zgjidhni peshkun e egër vetë drejt e tek ekspozitori, shërbimin e stafit ta keni plotësisht në dispozicion si mbret dhe çmimet krejt të përballueshme. Dhe po patët dëshirë bëni edhe një xhiro bregut të detit për të shijuar pasditet e ngrohta, vetëm ju dhe deti me aromën e vet dehëse. Edhe po u vonuat, apo nëse doni të shijoni perëndimin, mund të akomodoheni në hotel me një çmim të arsyeshëm e kështu keni shansin të provoni edhe mrekullinë e mëngjeseve të freskëta. Një staf i tërë do të përkujdeset për ju.

**Aler Hotel dhe Restorant tek Mali i Robit po ju pret. Keni bërë plane për këtë fundjavë?**



*Friday Fun day!  
You are welcomed to enjoy your  
day with us!  
Try our delicious food and have a  
chance to spend a weekend at our  
homie hotel for a great price!*







## ALER Hotel Durrës



**Mali i Robit, Durrës, Albania**  
Tel./Fax: +355 4 453 5555  
Cel. +355 69 3655684  
+355 69 2969214  
[www.alertravel.com](http://www.alertravel.com)



Aler hotel Durrës is located in the coastal area of Durrës, only 30 km from the airport. 3 storey building is situated on the first line near the sea. Surrounded by nature between the trees and the Adriatic Sea, the hotel also offers a modern restaurant. The restaurant provides European cuisine with all kinds of dishes. The hotel has a beach-bar to enable tourists to take some exotic drinks to the sounds of music. Staff speaks English, Russian and Ukrainian.

Buffet breakfast while lunch and dinner are a la carte. Bar and restaurant offer their service from 7:30 -24:00. The hotel has wi-fi, free parking, exchange, strongbox in reception. The hotel strictly prohibits animals. It has 15 rooms, air conditioning, double bed, wardrobe, fridge and TV, while the bathroom has bath towels and washing cosmetics, a hair dryer is at the reception. Cleaning in the room and change of linen is every day. Standard rooms are from 20 square meters and have a sea view or a park view. The beach is private, sand. Sunbeds and umbrellas are included in the price. Beach towels are not offered.



# I know a place in the beautiful Albania it is Rodoni Cape

Flora Xhemani Baba

## “Di një vend” në Shqipërinë e bukur ai është Kepi i Rodonit

Kur në kulmin e verës së sivjetme me temperatura të larta e sezon të ndezur turistik pashë fillimisht në rrjetet sociale një shkrim, me atë simbolin si thurje, që për pak tendencë, i thonë ndryshe edhe “hashtag” të shkruhej një shprehje “di1vend”, të shafqej në profilet e djemve dhe vajzave të Klubit Discover Albania, fillimisht të Ismailit e pastaj me radhë, të të tjerëve, thashë me vete: Ç` të jetë ky vend? Po ne, e dimë? Apo e dinë vetëm këta të Klubit? Pyetjet poshtë fotove nuk pinin ujë sepse askush nuk tregonte asgjë, me gjasë për të rritur kureshtjen, që duhet thënë se u rrit jo pak. Edhe kureshtja jonë u rrit mjaftueshëm por megjithatë, duke qenë pjesë e marketingut turistik e dinim që kjo ishte njëfarë “strategjie” dhe herët a vonë ky vend do të zbulohet. Po ta kishim pyetur Ismailin që në fillim, me siguri do të na e thoshte, por as këtë nuk deshëm ta bëjmë, për të respektuar “fushatën” e marketingut.

Kjo histori vazhdoi për një kohë të mjaftueshme dhe kur gradualisht filluan të dalin fragmente të shkëputura fotosh, të cilat shumica nuk po i njihnin dot se ku ishin shkrepur, kureshtja u ndez më shumë. Dhe kjo fazë e dytë e përgatitjes me të njëjtën moto “di1vend”, pasoi me një cikël tjetër, që duhet thënë se ishte fushata turistike më e bukur që më kishin zënë sytë deri në atë moment. Por para se të pasonte fushata fundore, ne e morëm vesh më fund dhe jo më rastësisht por nga një telefonatë e Ismailit: “Dua të bëj një aktivitet të paharruar në Rodon”. Një festë të madhe dy-ditore ku t`i bëjmë të gjitha; muzikë, festë, sporte, plazh, aktivitete në natyrë, të flemë në kamping, të vizitojmë kalanë, kishën. Gjithçka

At the peak of the summer, while temperatures stood high and the touristic season was busy, I came across an article in social media, preceded with that famous hashtag symbol #di1vend, it was widespread on profiles of boys and girls from Discover Albania Club. Ismail had posted it on his profile first followed by the others, so I asked myself: What could this place be? Do we know it? Or only this Club knows what’s going on? Questions asked in the comment box went ignored and unanswered, most probably to maintain the curiosity, which undoubtedly was heightened significantly. Our curiosity was also heightened, even though being part of tourism marketing we were aware that this was a “strategy” and sooner or later the location would be revealed. If we had asked Ismail, he would have surely told us, but we refused this in order to respect their marketing campaign.

This story went on for a considerable long time, then after fragments of pictures were posted, first people were unaware about the location of the pictures arousing thus even more interest. This second stage of preparation holding the motto “di1vend” (I know a place), was succeeded by another stage, which was the best looking tourism campaign I had ever come across until that moment. Prior to the last stage of the campaign, we uncovered the location, lastly, not by chance, but Ismail himself called us: “I want to organize an unforgettable event at Rodon.” A huge party going on for two days, it would have everything: music, party, sports, beach,



pa ndalim. 48 orë festë. Që njerëzit të kuptojnë se kjo perlë mund të shfrytëzohet plotësisht. Dua prej jush të bëjmë bashkë fushatën promovuese. Sa më bukur që të jetë e mundur. Ashtu siç e meriton Rodoni.

Po. Natyrisht. E çfarë mund të ishte tjetër gjithë ky mister përveç Rodonit? A ishim dakord ne? Fjalë ishte ajo?

Kështu pra, nën moton e veçantë "Di një vend", e cila lindi jo aq rastësisht por si një shkëndijë mes qindra udhëtimeve e fotove të bukura nëpër Shqipëri, Klubi "Discover Albania", shpalli një aktivitet dy-ditor, për të vizituar një prej vendeve më të bukura e më

outdoor activities, camping, visiting the castle and the church. Everything non-stop for 48 hours. So people would understand that this precious site can be fully utilized. He asked us to participate in the promoting campaign. As best as we could. Befitting the cape of Rodon.

Surely, all the mystery was about Rodon, and were we in? Of course, we were one-hundred-percent in.

So then, using the motto "I know a place," that was created on purpose by "Discover Albania" club to ignite a double day activity, organized in one of the most beautiful places in Albania, the Cape



interesante në Shqipëri, Kepin e Rodonit. Ishte një aktivitet i konceptuar si një festë e madhe në natyrë, që zgjati dy ditë e një natë, pikërisht në datat 25 dhe 26 Gusht, ku organizatorët ftuan edhe kompani të tjera që ushtrojnë aktivitetin e tyre me sporte në natyrë, që festa të bëhej sa më e larmishme dhe interesante.

Për mua personalisht fushata disa-ditore që i parapriu festës, ka qenë atmosfera më e bukur e më gazmore, që i dha rrjeteve sociale ngjyrat me të bukura e më të gëzuara që kishte pasur ndonjëherë.

Të gjithë ata që kanë qenë fëmijë para viteve '90, e dinë mirë se sa pak personazhe filmash vizatimorë ka patur në atë periudhë e sa të dashur ishin ata, në morinë e madhe të mungesave të asaj fëmijërie. Kështu që kur filluan të mbinin nëpër statuse figurat e Arushit që kërkonte babanë, të Ujkut dhe Kaut, Lepurush Veshkaushit, Çufos, Tipit, që secili të tregonin se dinin një vend, ku bëhej plazh, ku lundrohej me kajak, ku pedaloje me biçikleta mali, ku bëje "stand up paddle" apo sporte të tjera në natyrë, të gjithë u ngazëllyen. Dhe mendoj ishte edhe për këtë

of Rodon. This event was designed to resemble a huge outdoor party, that lasted for two days and one night, on 25th and 26th of August, where organizers had invited other companies that organized an assortment of outdoor activities that were also interesting.

In my opinion, the multiple-days campaign that preceded the party was the most beautiful and joyful atmosphere that painted the social media full of colors.

All of those who grew up before the nineties, are aware of the few animated characters that existed then, and how dear they were to them, while growing up amidst many shortages. Everyone was exalted when profile statues showed pictures of animated characters of a former generation, such as the "bear looking for his father," "the wolf and the Cow," "the coned-ear bunny," "Çufo," Tipi," while everyone was trying to show that they know of a place with a beach, a place to go kayaking, go

mountain biking, a place to do stand up paddle, or other outdoor sports. Hundreds of youngsters from Albania and Kosovo joined the party and became part this event. An organized transportation started off the journey from Tirana until the Cape of Rodon, reaching a place where the sunset was an unforgettable and hearty moment, in a destination where the sun and the moon were invited in a beach party that lasted to the early hours of the morning.

I wouldn't consider not joining this beautiful party, despite all the tight traveling schedule of the summer. As per usual, I took the boys along in the journey, so they would get to know their homeland better. It wasn't the first time we had camped, the last time was in Pilur, during South Outdoor Festival. The concert had music, with songs and youth rhythms mixed together by DJs, it was the soundtrack of a long night with everyone participating as they wished, either taking a lengthy walk along the beach, or orbiting the fireplace with conversation, some enjoyed beer and barbecue, others danced close the concert's stage. The sound of the music was heard in both corners of the long beach.

The only option of accommodation were camping tents, because Rodon is safe from urbanization and we hope that it remains like this, so it can continue to offer a different outdoor experience.

Rodon doesn't have only nature, there you can discover a piece of the Albanian history and one of the multiple activities of the

arsye që qindra të rinj nga Shqipëria dhe Kosova iu bashkuan ftesës së Klubit për të qenë pjesë e kësaj feste, e cila nisi që në Tiranë, me transportin e organizuar, vazhdoi me shijimin e udhëtimit deri në Kepin e Rodonit, me përjetimin e shijimit të perëndimit të paharrueshëm ku hëna dhe Dielli ishin bërë bashkë dhe me festën e madhe në plazh, që zgjati deri në orët e para të mëngjesit.

Natyrisht megjithë udhëtimet e ngjeshura të verës, ishte e pamundur që edhe ne të mos i bashkoheshim kësaj feste të bukur. Djemtë me vete, ashtu siç fundja bënim në shumicën e udhëtimeve tona, për t'i njohur me vendin e tyre. Nuk ishte as hera e parë që flinin në kamping, më e fundit kishte ndodhur në Pilur, në South Outdoor Festival.

Një koncert i organizuar me muzikë të kombinuar mes këngës dhe ritmeve rinore të muzikës me DJ, ishte kolona zanore e një mbrëmjeje të gjatë që secili e shijoi ashtu siç dëshirone, o duke bërë shëtitje të gjata në plazh, o duke biseduar me shokët rreth zjarrit, o duke pirë një birra në darkën e barbekusë, ose duke ndjekur nga afër koncertin, tingujt e të cilit dëgjoheshin deri larg, në të dy cepat e plazhi të gjatë.

Fjetja e organizuar në çadra kampingu, ishte e vetmja mënyrë akomodimi sepse Rodoni për fat të mirë ende nuk është prekur nga urbanizimi dhe shpresojmë që të mbetet i tillë, pikërisht për të ofruar një përvojë ndryshe të shijimit të natyrës.

Por jo vetëm të natyrës. Rodoni është një vend ku mund të zbulohet edhe një copëz e historisë së Shqipërisë dhe një prej aktiviteteve të shumta që u organizuan në këtë festë, ishte edhe vizita në Kalanë





e Skënderbeut, pak kilometra në këmbë që nga plazhi ku ishte stacionuar kampi. Po ashtu ishte menduar edhe vizita në Kishën e Shën Ndout.

Dita gdhii me një mëngjes që nuk kishte si bëhej më i paqhtë. Nga dritarja e hapur e çadrës nuk merrej vesh se ku ishte deti e ku qielli sepse mungesa e diellit që s'kishte lindur ende, e kishte shkrirë vijën e horizontit duke i larë të dy në argjend. Djemtë me të atin, u vunë bregut të mblidhnin guaska, teksa prisnin të vinte ora për të ngrënë mëngjesin.

E pas mëngjesit, grupe të ndryshme iu bashkuan aktiviteteve të ndryshme.

Dikush pati dëshirë për një relaks total nën tingujt qetësues dhe lëvizjet magjike të sportit shpirtëror të Jogës. Më të dhënët pas natyrës, iu bashkuan grupeve që do të vizitonin Kalanë dhe Kishën, kurse ata më aventurorët, shkuan pas sporteve. Në det grupet e Albania Adventure organizuan "stand up paddle" dhe kajak ndërsa përgjatë shpateve të Kepit, sërish grupet e Albania Adventure u zhytën në aventurën "Off Road" me autokolonën e makinave 4 x 4. Pati dhe nga ata që zgjodhën të pedalonin përgjatë shtigjeve me biçikletë.

Ishte një festë ku mund të thuhet me plot gojën se Rodoni mori jetë. Klubi "Discover Albania", My Albania Nature Explorers, Albania Adventure, Borea Travel, DSM, Kalemi Travel, ATV, dhanë secili pak nga përvoja e tyre, të cilën e shijuan me qindra të rinj, për të treguar se po, Shqipëria mund të shijohet duke e dashur natyrën, duke e respektuar trashëgiminë, duke mos e ndotur mjedisin, duke e njohur historinë e sigurisht duke u argëtuar pa fund. Sepse të dish vlerat që ke dhe t'i shijosh ato duke mos i dëmtuar, do të thotë të ushtrosh turizëm të përgjegjshëm.

**#Di1vend të ri. Por nuk jua zbuloj tani. Për ta zbuluar, duhet të ndiqni aktivitetet e Klubit "Discover Albania"**

event was visiting the Castle of Skanderbeg, a short walking distance from the camping location. A visit to the church of St. Anthony was also part of the event's organizations.


The day dawned with the most peaceful morning. Peeking out from the tent's window it was almost impossible telling the sea from the sky, the horizon had melted them in silver as the bright sun had not risen yet. The boys and their father started gathering seashells, while waiting for breakfast.

After breakfast, various groups were present with a multitude of

activities. Some choose to relax completely, while peacefully following the magical movements of Yoga. Some were eager to explore nature, joining the visiting groups of the castle and the church, while the ones who were more adventurous, went after sports. Albania Adventure organized stand up paddle and kayaking, while along the sides of the cape the groups of Albania Adventure were totally immersed in the "off road" adventure with four-wheel drive vehicles. Some choose to cycle in the trails. The party brought much life to Rodon. "Discover Albania" club, My Albania Nature Explorer, Albania Adventure, Borea Travel, DSM, Kalemi Travel, ATV, were all present sharing their experience with hundreds of youngsters, they confirmed that Albania could be enjoyed while loving nature, respecting the heritage, keeping the environment clean,

getting to know the history and having tons of fun. Recognizing and enjoying the inherited values, while keeping them safe, this is the significance of a responsible tourism.

**#IKnow1place. A new one. But I will not tell it. To learn more, you should follow the steps of "Discover Albania" Club**



Pët të prenotuar turet:  
To book the tours:

Për ture në të gjitha stinët:  
To book tours in every season:

KLUBI "DISCOVER ALBANIA"

Te.: +355696583870

+355 69 40 40 333

info@discoveralbanianow.com

www.discoveralbanianow.com



*Është stinë udhëtimesh!*  
KLUBI "DISCOVER ALBANIA"

Ju pret për aventura të paharrueshme, që do t'i zbulojmë bashkë



KLUBI "DISCOVER ALBANIA"  
Discovering together...

*the adventure is On!*

Discovering together with Discover Albania Club,  
you will experience unforgettable adventures!



# GlobalLimits Albania

## The Hidden Treasure

### From Berat to Butrint, through the treasures of UNESCO



Global Limits is a company that organizes races on rugged and wild terrain with runners from all continents. For the GlobalLimits Albania Project - The Hidden Treasure it has collaborated with Albanian Operator "Albania Adventure", who took care of all the logistic part of this event.

Since the beginning, this event has been supported by the Ministry of Tourism, Culture, General Directorate of Strategic Planning for Cultural Heritage, Regional Directorate of National Culture of Berat, Regional Directorate of National Culture Vlora, Butrint Park Administration Office, Saranda.

In addition to the competitive goal, this race was very important for the tourism promotion of the host country, Albania, as 60 runners come from different continents. All participants are very sensitive individuals to cultural heritage, therefore this route has been carefully selected which started at the fortress of the city of Berat, continuing towards the Mesopotamian monastery, to finish in the ancient city of Butrint. The distances that ran running, 30-50 km per day, for a total of 220 kilometers.

Following the step of the romantic poet Lord Byron (all' allergeo), 60 determined runners from 27 nations around the world will realize the first multi-staged race in Albania, at the UNESCO World Heritage site of the "City of Thousand Windows", Berat, on Sunday, 10 September 2017, 8am local time.

The race finished on 15 September 2017 at the Amphitheatre in the 3000 years old ancient wall city of Butrint.

To reach this goal, the runners had to run 220km with 8,000m altitude gain in 6 days, passing numerous local remote villages, untouched nature and spending their nights in local houses, ancient monasteries, lakeside and ancient castles.

#### Race Report Stage 1

After spending the evening camping in the Berat castle, 60 runners from 27 countries were ready for the first stage of the inaugural GlobalLimits Albania - The Hidden Treasure at the foot of the ancient city of Berat. The mayor of the ancient city gave a speech for thanking the runners visiting Albania and Berat and local school children sang the national anthem of the country to honour it.

The race started at 8am local time. Frank Johansen from Denmark finished the 38 km in an impressive 3:20hrs while GlobalLimits veteran winner ArgyPapathanasopoulos followed just 5minutes behind. Kurt Alderweireldt from Belgium, shared today's podium at third place, finishing at 3:27hrs.

In female category won Leandra Kurtz from Switzerland in

4:30hrs. She obviously enjoyed the stage and looked pretty fresh at the finish. Second was Austrian Christina Khinast in 4:41hrs ahead of American Charla Heimer in 4:56hrs.

All runners finished the stage and enjoyed the evening in the small village of Buze on the ridge of the mountains with an breathtaking view.

#### Race Report Stage 2

The second stage of GlobalLimits Albania - The Hidden Treasure started at 7am at the Village of Buzi. Special thanks to the local school of Buzi, which hosted the runners the evening before. The runners left the village and through the picturesque and windy mountain valley.

The top 5 runners again set a high speed from the start on. Finally the 30.6km stage was won by Greek ArgyPapathanasopoulos in 3:10hrs just 4mins ahead of Danish runner Frank Johansen and Belgium Kurt Alderweireldt. Manu Pastor from Spain finished 4th on his birthday.

Another impressive win by Swiss Leandra Kurtz in the female category in 4:09. Second was Cherrie Chung from Hongkong ahead of Austrian Christina Khinast.

All runners have finished the stage and enjoyed the homestay with local families in the village of Peshtan.

#### Report Stage 3

After spending an evening with local villagers in the village of Peshtan, the runners were ready for the 54.5km long. The top 30 runners started at 7am while the rest started at 6am. They have to climb up to the village of Limar at 800 meter. From there they climb further to 1100m arriving at the Zagoria valley passing numerous local villages and with wonderful views of southern Albanian mountain valleys.

There was a very close race between the top 2 males - with ArgyPapathanasopoulo from Greece leading 5 seconds ahead of Frank Johansen from Denmark and well ahead of Kurt Alderweireldt. In the female group, Swiss Leandra Kurtz set another impressive pace and winning the stage ahead of Hong Kong runner Cherry Chung follows and Austrian runner Christina Khinast. Pat Singh (Guayana/ Canada) commented that the scenery in this stage is breathtaking.

#### Race Report Stage 4

After sleeping under the starry night by the lake, the runners were ready for another 38,4km running. They left the camp at 7am and





run through the village of Lazarat before climbing up the 1340m high mountains and reach the top for a panoramic view of Corfu and the Ionian Sea. They then descent to the village of Delvine and climb through another mountain and reach the finishing line at the ancient monastery of Mesopotam. They spent the evening camping in the courtyard of the monastery and enjoying a cool dip in the nearby river.

Special mention is German runner Ingo Plehwe, who completed this stage ranking number 6. Daniel Meyes from Switzerland also recovered and had a strong day finishing this stage ranking number 5 today.

Overall leader Frank Johansen set an impressive pace today, running most of the stage with Belgium Frank Alderweireldt. Finally Frank won the stage 10mins ahead of ArgyPapathanasopoulos and Kurt Alderweireldt.

In general ranking, Frank Johansen from Denmark extended his lead to Argy to 10:38mins now. Kurt Alderweireldt stayed in 3rd place. The female category stayed the same with Leandra Kurtz from Switzerland in the first place, Cherry Chung from Hong Kong second and Christine Khinast from Austria stayed at third. The end of the day was at the village of Mursi, next to the Greek border.

#### Race Report Stage 5

Getting closer! The second last stage of GlobalLimits Albania - The Hidden Treasure started in morning at the ancient monastery of Mesopotam. After passing rolling hills, grassland and local villages, the runners arrived at checkpoint 3, where they climbed the 1100m high hill and enjoyed the view of the landside of Murci valley. At the other side of the hill is the panoramic view of the Ionian Sea and the finish line - Butrint.

The runners stayed in tents by the lake in the village of Murci. They just enjoyed an especially for GlobalLimits runners organized village festival with complementary Albanian dinner and traditional Albanian polyphonic dance performance.

Stage 5 of 44km was won by Frank Johansen in 4:05hrs ahead of ArgyPapathanasopoulos in 4:13hrs and Manu Pastor of Spain who really enjoyed the climbs today.

Today's victory gave Frank Johansen a comfortable lead of 19mins before the last stage. Second was still ArgyPapathanasopoulos ahead of Belgium runner Kurt Alderweireldt. In the female category Leandra Kurtz from Switzerland is still in comfortable lead ahead of Austrian Christina Khinast and Cherrie Chung from Hongkong. Tomorrow is the last stage where runners will run 14km to the UNESCO heritage site of Butrint.

#### Race Report Final Stage - Albania - The Hidden Treasure

After 5 days of running adventure through remote Albanian mountains, windy trails, saying hello to goats/sheeps/cows and dancing and having fun with local people in a street festival of Murci Village, 60 strong GlobalLimits Albania - The Hidden Treasure runners finally reached the last stage of the race with a last 14,7 km run from the Village of Murci to the finishing line at the UNESCO World heritage site of Butrint.

The finish line is set at the 3000+ years old Theater of the complex. The runners must cross the Ionian Channel by ferry and run a loop circling the magnificent ancient complex.

Danish Frank Johansen is the winner of the male category at the race with Greek runner ArgyPapathanasopoulos in second. Kurt Alderweireldt from Belgium finished 3rd. In the female category,

Swiss runner Leandra Kurtz is the first followed by Christina Khinast from Austria. Cherry Chung from Hongkong finished 3rd.

After touring around Butrint, the runners arrived at a premium resort in Saranda and enjoyed themselves by the Ionian Sea. There they celebrated their hard work at the hotel with the award ceremony and buffet dinner.

It was not just a running race. It was a passage through history and the hidden treasures of Albania, this small and beautiful country in the Western Balkans, which almost no one of the runners knew before but that at the end of this race it would be difficult to forget easily. It was a journey that was stamped with hospitality, with unconditional love and friendship, just as Albanians only know how to give it. Goodbye in the next year at the second stage of GlobalLimits Albania Hidden Treasures!

## The winners GlobalLimits Albania The Hidden Treasures

### Male:

1. Frank Johansen - Denmark **21:39 hrs**
2. ArgyriosPapathanasopoulos - Greece  
**22:02 hrs**
3. Kurt Alderweirelt - Belgium **23:41 hrs**

### Female:

1. Leandra Kurtz - Switzerland **28:12 hrs**
2. Christina Khinast - Austria **29:52 hrs**
3. Cherrie Chung - Hongkong **29:58 hrs**





Të Shtunën e 9 Shtatorit 2017, Rrjollit të Velipojës iu dyfishua numri i peshkatarëve. Por ndryshe nga ato pak familje vendase që e kanë lidhur jetën me varkat e peshkimit edhe në det të trazuar, 23 mysafirët e rreshtuar në lindje të fshatit ishin sportistë, anëtarë të Federatës Shqiptare të Peshkimit Sportiv dhe Rekreativ. Në një atmosferë të jashtëzakonshme miqësore, me nga dy kallame peshkimi për person, ata garuan në gjashtë orët e fundit të ditës, për të zënë një vend nderi në fazën e dytë të Kampionatit Kombëtar të Peshkimit Sportiv, që për herë të parë u mbajt në këtë pjesë të bregdetit shqiptar. Më herët, në muajin Prill, faza e parë u organizua në Orikum, ndërsa sipas organizatorëve, faza e tretë do të mbahet në Palasë, në fund të Tetorit.

Njëri ndër organizatorët, Lorenc Çepele nga Federata Shqiptare e Gjuetarëve dhe Peshkatarëve - anëtarë e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, tha për revistën Travel se pjesëmarrësit e garës janë të përgatitur mirë teknikisht, dhe se rezultatet e peshkimmit sportiv shqiptar janë të krahasueshme edhe me nivelet europiane të këtij sporti. Vitin e kaluar ai u shpall kampion kombëtar, duke kapur 19 peshq në një garë të vetme, çka sipas tij, është një rezultat i mirë. Çepele thotë se ka ardhur enkas nga Greqia, ku edhe jeton, për të marrë pjesë në këtë garë. Ai është kampion i Europës për garat mes klubeve, duke përfaqë-



MBAHET FAZA E DYTË E KAMPIONATIT KOMBËTAR TË PESHKIMIT SPORTIV

# FAT APO ZOTËSI?

## Peshkatarët zgjedhin miqësinë në Rrjoll të Velipojës



Rrjoll 9 Shtator 2017. Pjesëmarrësit e fazës së dytë të Kampionatit Kombëtar të Peshkimit Sportiv

suar Surfcasting & Long-casting Club Albania në kampionatin e zhvilluar në Qipro. Ndërkaq, në mesin e konkurrentëve është edhe një shtetas grek, i cili zuri vendin e 14 në këtë garë, sipas tabelës së rezultateve të

ofruar nga organizatorët. Të pyetur nëse peshkimi sportiv është më shumë çështje teknike apo fati, garuesit ndajnë mendime të ndryshme. Çepele thotë se 60% e rezultatit është fat, ndërsa pjesa tjetër është

teknikë, ku një rol të rëndësishëm luajnë edhe pajisjet e duhura. Kjo teknikë e surfcasting i përket vetëm peshkimit në ujërat e kripuara, - thotë Saimir Kapidani, një tjetër organizator dhe pjesëmarrës i garës. Kush



## Mbrojtësit e Detit promovojnë peshkimin e qëndrueshëm

Të inkuadruar edhe në shoqatën "Mbrojtësit e Detit", peshkatarët sportivë thonë se do t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre kundër metodave të paligjshme të peshkimit të aplikuara jo pak në ujërat shqiptare. Për të promovuar peshkimin sportiv dhe të qëndrueshëm, dy shoqata të tjera, Peshkatori dhe Tubertini organizuan më 1 Tetor, po në Rrjoll të Velipojës garën e surfcasting, ku për 10 vendet organizatorët dhuruan kallama dhe makineri peshkimi. Ndërkra, kohët e fundit, Shqipëria u pranua anëtare me të drejta të plota e EFSA - European Federation of Sea Anglers (Federata Europiane e Peshkatarëve të Detit).



Saimir Kapidani, përherë i qeshur dhe dashamirës



Adriatik Canaj dhe komisioneri i garës, Akil Margjeka



Kristi Gjoka, fituesi i fazës së dytë të Kampionatit Kombëtar



Lorenc Çepele, nga Surfcasting & Longcasting Club Albania, shpallur kampion kombëtar dhe european në konkurrimin e klubeve

mendon se është fat, gabohet, - thotë ai edhe pse për vete nuk nxori nga uji asnjë peshk brenda orës së parë të garës. I pyetur nëse nuk është treguar aq i zoti deri në ato momente, ai e pranon me shaka: Kjo tregon se duhet t'i vë detyra vetes për të dalë sa më mirë. Ndësa Kristi Gjoka, të cilit gara po i shkon më së miri, thotë se fati ka përqindjen më të madhe në rezultatin e peshkimit. I këtij mendimi është edhe Adriatik Canaj, të cilit gara i dha rezultat të mirë që në fillim. Jo më kot urojmë "qëllofsh!" - thotë ai, duke shtuar se të gjithë pjesëmarrësit e zotërojnë mirë teknikën e peshkimit sportiv.

Për peshkatarët sportivë, pjesa më e bukur e garës është vetë mbledhja e tyre së bashku. Shkëmbimi i përvojës me njëri-tjetrin është më i rëndësishëm se fitimi i garës, - thonë ata. Rrjoll është ndër vendet më të mira për surfcast, lavdëron Kapidani vendin e këshilluar nga peshkatarët e Rrjollit për zhvillimin e kësaj gare. Le të fitojë më i miri!

Dhe më i miri, sipas rezu-

ltateve zyrtare, doli Kristi Gjoka, me 328 pikë, i pasuar nga Euglent Morina me 262 dhe Naim Hoxha me 260. Sipas komisionerit të garës, Akil Margjeka, pikët përcaktohen në bazë të numrit dhe madhësisë së peshqve të kapur nga dy kallamat me të cilët peshkatarët operojnë në këtë konkurrim. Ai thotë se nuk ka ndonjë kusht të veçantë për të marrë pjesë në këtë garë, mjafton të ekzistojë dëshira dhe dashamirësia për detin. Nëse peshqit e kapur janë tepër të vegjël, ne i kthejmë prapë në det, - thotë Margjeka. Ai tregon se peshkatarët duhet të kujdesen që gjahu i tyre të qëndrojë gjallë deri në fund të garës, e për këtë, përveç dy kallamave, krimbave etj., në pajisjet e pjesëmarrësve janë edhe kovat plastike ku hidhet peshku i kapur. Megjithatë, në fund të garës, i gjithë peshku i kapur shërbeu si ushqim për grupin, që rreth zjarrit, shakave dhe shoqërisë së mirë, e pritën mëngjesin e së Dieles nën qiellin e qendësuar të Rrjollit.

**Travel**

# Zemra e Malësisë në Shllak

Zemra e Malësisë ishte projekti tjetër i paraqitur në Konferencën 2 Turizmi në Qarkun Shkodër, të mbajtur në Shkollën e Mesme Profesionale "Ndre Mjeda" të Bushatit.

I ideuar dhe paraqitur nga dy nxënës të kësaj shkolle - Dorjana Ahi dhe Jozef Ndreka, projekti fokusohet në zonën e thellë malore me rreth 700 banorë të Shllakut, afro 30 km nga qyteti i Shkodrës, por tepër të izoluar dhe të pazhvilluar.

elin e detit, si dhe 9 majat e Cukalit 1295 - 1734 m.

## E para bujtinë në zonën e Shllakut - një kullë shekullore

Sipas ideatorëve të këtij projekti Start-up, kulla shekullore në pronësi të Dorjana Ahi do të shndërrohet në një bujtinë tradicionale, e para strukturë akomoduese në zonën e Shllakut. Me riparime dhe ndërhyrje të vogla me vlerë jo më shumë se 5 mijë euro dhe duke ruajtur origjinalitetin e saj, kulla do të shndërrohet në një qendër për krejt zonën



Nxënësit Dorjana Ahi dhe Jozef Ndreka duke prezantuar idenë e tyre në Konferencën e Turizmit

## Shllaku i izoluar

Dikur Komunë me të njëjtin emër, Shllaku përbëhet nga fshatrat: Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Bene, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj dhe Uk-Bibaj, sot është Njësi Administrative - pjesë e Bashkisë Vau i Dejës të Rrethit të Shkodrës. Për shkak të mungesës së zhvillimit ekonomik të kushtëzuar edhe nga terreni tepër i thepisur malor (vetëm 0.03% e sipërfaqes është tokë bujqësore) dhe lartësisë mesatare mbidetare prej rreth 1.000 metrash, Shllaku është braktisur nga më shumë se 1200 banorë, një pjesë e të cilëve kthehen në këtë zonë vetëm gjatë verës. Megjithatë, Shllaku ka disa shkolla 9-vjeçare dhe qendra shëndetësore, ndërsa infrastruktura rrugore është plotësisht e amortizuar. Ndër atraksionet kryesore të zonës janë Fusha e Liqenit 1300 m mbi niv-

aq të pasur me atraksione natyrore, si shpella e gryka malore me pamje të mrekullueshme. Me shumë kujdes në ndërhyrjet e parashikuara në idenë e tyre, nxënësit madje kanë menduar që përveç objekteve të vjetra me vlera etno-kulturale dhe historike, të përdorin për akomodimin e turistëve dyshekët me kashtë, si dikur. Gjithashtu turistëve që do të vizitojnë Shllakun do t'u shërbehen gatime tradicionale, ndërsa nuk do të mungojë edhe përfshirja e tyre në jetën e banorëve të zonës.

Me këtë projekt-ide, nxënësit e mësipërm tërhoqën vëmendjen e jurisë, duke u vlerësuar me çmimin e dytë në konkursin Start Up Tourism, por edhe morën votat maksimale të publikut në Konferencën 2 Turizmi në Qarkun Shkodër, të organizuar më 12 dhe 13 Maj nga Organizata GO2, VIS Albania dhe Cospe.


Në këtë numër, Travel boton projektet fituese të Konkursit të Ideve, të zhvilluar në kuadër të Konferencës 2: Turizmi në Qarkun Shkodër, me fokus startup-et në fushën e turizmit, të mbajtur më 12 dhe 13 Maj 2017 në Shkollën e Mesme Profesionale "Ndre Mjeda", Bushat, dhe të organizuar nga GO2 Albania, VIS Albania dhe COSPE Albania.

# Stanet, ky pret mes

Në Alpe ekzistojnë një numër i konsiderueshëm vendbanimesh. Numërohen rreth 110 vendbanime fshatare, të vogla dhe të shpërndara. Janë të vendosura kryesisht në luginat dhe shpatet e tyre, ku ka pasur më tepër mundësi për tokë të punueshme. Banesat e tyre janë të ndërtuara prej guri dhe druri, në trajtën e kullave, me çati shumë të pjerrëta. Aktualisht në Alpe jetojnë rreth 82.000 banorë. Dendësia mesatare e popullsisë është 37 banorë për km<sup>2</sup>. Duke qenë mjaft të izoluar, ata ruajnë shumë zakone, tradita nga e kaluara. Krahas banimeve të përhershme ka dhe vendbanime të përkohshme - stanet, "verimi në bjeshkë", me të cilat merret rreth 8-10% e popullsisë (600-700 banorë) të të gjitha moshave, sidomos gra dhe fëmijë. Stani përfaqëson një sistem veprimtarish baritore, ku përfshihet kultivimi i kulturave bujqësore, aktiviteti blegtoral, ruajtja e mallrave dhe jeta e bariut/artizanit.

## Stanet si mikroferma ekologjike në zemër të pyllit

Kulturat bujqësore më të përhapura



# produkt i ri turistik malesh fshehur



Petrit Imeraj është inxhinier i përgjithshëm pyjesh dhe jurist. Si ideator, zbatues dhe autor, ai ka marrë pjesë në konferenca lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, me biodiversitetin dhe vlerat natyrore në veri të Shqipërisë, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare, menaxhim të hapësirave ndërkufitare, eko-turizmin malor dhe legjislacion mjedisor shqiptar. Kordinator i qendrës së informacionit për zhvillimin e eko-turizmit në Shqipërinë e Veriut "Balkan Peace Park Information Centre", që nga viti 1998 Imeraj drejton një shoqatë ambientaliste e cila promovon vlerat natyrore dhe eko-turistike të Alpeve shqiptare dhe hapësirës ndërkufitare mes Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Autor i Foto-Ekspozitave në Gjermani dhe në Çeki për turizmin malor dhe detar të Qarkut Shkodër. Ambasador i Green Destinations në Shqipëri.

në alpe janë: misri, foragjeret, perimet, patatja, fasulja, pemët frutore dhe vreshtat. Familjet që verojnë në stane e kanë bazuar jetesën e tyre tek prodhimet e fermës. Toka përdoret kryesisht për bujqësi, por dhe si kullotë për bagëtinë. Produktet bujqësore dhe blegtorale si qumështi, djathi, kosi, mishi, gjal-

pi, mjalti etj, janë artikujt kryesorë që ky sistem prodhon për jetesë dhe tregti, në marrëdhëniet tregtare me zonën fshore. Në alpe mbarështohen bagëtitë e imëta (lopa, delja, dhia etj.) shpendët, bletët, kuajt dhe derrat. Tradita e ruajtjes në kushtet shtëpiake ka dy forma: pastërmë (mishi i tharë në tym) dhe regjjen.

## Koritat e tamlit, trinat, baxhot natyrale, tharku dhe çarraniku

Produktet e prodhuara në stane kanë mangësi kur dalin në treg, sepse mund të ruhen gjatë për konsum. Për të ruajtur prodhimet për vetëkonsum apo për treg, zakonisht përdoren trinat, baxhot, tharku apo ambiente të tjera tradicionale të zonave. Por ato nuk plotësojnë kriteret e nevojshme për ruajtjen normale të prodhimit. Shumica e koshave tradicionale për ruajtjen e misrit pranë shtëpive dëmtohen nga kushtet atmosferike. Ndërkohë që baza ushqimore për blegtorinë depozitohet në natyrë, në formën e mullarëve, e në ndonjë rast sporadik edhe në sillose të përshtatshme të ndërtuara për këtë qëllim.

## Nga fshati në stan, nga stani në majë

Stanet përveçse një nevojë dhe mundësi zhvillimi, mund të jenë edhe një produkt turistik ku ndërthuret tradita, aventura, kultura e eksplorimit etj.

Duhet konsideruar fat që stanet e alpeve nuk janë të lidhura me rrugë automobilistike, sepse kjo i bën ato shumë të veçanta në aspektin e produktit turistik.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, krijimi i "Turit të staneve" do të sillte zhvillimin e agroturizmit përmes plotësimit të nevojave të banorëve të këtyre zonave, ndërsa në të ardhmen do të sillte rritjen e kërkesës për produktet e staneve.

Sipas projektit të ideuar nga Petrit Imeraj dhe të vlerësuar me çmimin e parë në konkursin Start Up Tourism të Konferencës 2 Turizmi në Qarkun Shkodër, është i nevojshëm realizimi i hartës turistike të staneve në alpe, të shoqëruar me përshkrimin e produkteve që ofrojnë këto struktura. Në projekt, gjithashtu evidentohet nevoja për rritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin e pronarëve të staneve për rëndësinë e vazhdimit të këtij sistemi, përmes tureve konceptformuese për jetën në stane. Sipas Imerajt, ky projekt do të ishte mirë të zbatohet nga "Aleanca e Alpeve Shqiptare", ndërsa për promovimin do të duhej të punonte çdo institucion dhe person që merret me turizmin.



▮ Anila Çuçllari

# Aromë Kolonje

Afërsisht 45 km larg qytetit të Korçës ndodhet një qytet tjetër sigurisht jo aq i madh por po aq i pastër, mikpritës dhe me kulturë, Erseka. Prej kilometrave të duket larg por kur e përshkon, kjo rrugë edhe pse disi e amortizuar (tani po bëhet rruga e re), ofron peisazhe të mrekullueshme të natyrës. Kjo është arsyeja pse ky segment rruge, frekuentohet kaq shumë nga çiklistë dhe motorristë, çekë, polakë e gjermanë. Qafa e Qarrit është ajo që ndan fushën e Korçës me Gropën apo Pllajën e Kolonjës. Gropa e Kolonjës ka një lartësi rreth 1100 m mbi nivelin e detit. Në lindje të saj ndodhet mali i Gramozit me një lartësi prej 2523 m mbi nivelin e detit.

Në këmbët e Gramozit shtrihet Erseka, qyteti me një qetësi për t'u admiruar, i pastër me njerëz shumë mikpritës. Erseka është themeluar në shekullin e XVII, pra është një qytet relativisht i ri që shërben si qendër e rrethit Kolonjë.

Arsyet për të vizituar Kolonjën janë të shumta por arsyeja kryesore e mbi të gjitha, janë vetë kolonjarët. Imagjinoni njerëz të butë e të sjellëshëm që të presin vetëm me fjalë të bukura e një qytetari mahnitëse, që nuk e prish dot asnjë sjellje e asnjë turisti, sado i vrazhdë qoftë ai.

Në Kolonjë mund të shkohet për shumë gjëra dhe sikur edhe të mos i realizosh dot të gjitha në një udhëtim, pasurohesh shpirtërisht vetëm duke vizituar pak, fare pak prej saj.

Në Kolonjë mund të zhvillohet dhe ka filluar të zhvillohet

turizmi natyror pasi është një zonë e pasur me bukuri natyrore. Adhuruesit e natyrës kanë kohë që shijojnë vende si Çuka e Peçit në vargmalin e Gramozit, kanionet e Virkës, Borovës, Pagomenit, Ujvarën e Rehovës, korijen e Shën Kollit të Vodicës, shpellën karstike të Podës, burimet me gazrat sulfurore të Postenanit, burimet e ujrave termominerale të Vronomerit, Llixhat e Sarandaporit, rezervatin e Gërmenj-Shelegurit, etj. Nje vend i cili po tërheq mjaft turistë që janë të apasionuar pas alpinizmit, është edhe liqeni akullnajor i Gramozit. Turet me kuaj apo me mushka,

përveç ecjeve alpinistike, janë një mundësi shumë e mirë për ta zhvilluar këtë zonë dhe për t'i dhënë pak më shumë hov turizmit malor.

Në Kolonjë mund të zhvillohet edhe turizmi historik e arkeologjik. Në Muzeun Historik në Ersekë mund të njihesh me gërmimet arkeologjike të Kolonjës dhe, me përpjekjet e rilindasve dhe patriotëve kolonjarë si Fan Noli, Petro Nini Luarasi, Papa Kristo Negovani, Sevasti Qiriaz, Parashqevi Qiriaz, Jani Vreto, Faik Konica, Themistokli Gërmenji, edhe me materiale etnografike të zonës. Mund gjithashtu të vizitohen Urat e moçme të gurta të Postenanit dhe Radovës, vendbanimi neolitik në fshatin Kamnik, kala, tuma, kisha e teqe shekullore, që janë të shpërndara në të gjithë zonën përreth.

Një arsye e fortë për të vizituar Kolonjën është edhe turizmi gastronomik me gatimet tradicionale. E ku ka kënaqësi më të madhe se të provosh gatimet e amvisave kolonjare; Lakror misri ose pacarok, lakror me dy petë, byrek (mesnik) me petë të pjekura, petulla të fshira, petulla të mbushura,

pulë e mbushur me arra, kukurec, kolloface, pispili, lakror me dy petë, lepur i egër çomlek, Bakllava, brushtull (petë të mbështjella me arra), zahiretë e dimrit, petët, roshnicat, tërhanin e thartë, tërhanin e ëmbël, mollët erëmira dhe të gjitha frutat e tjera që jo vetëm bëhen reçelra e gliko por edhe thahen apo piqen në furrë, në oxhakë e shoqërohen me pijet dhe rakitë e zonës.

Në Kolonjë ka zona të mbrojtura ku mund të zhvillohen me shumë sukses alpinizmi, shëtitja turistike, pushime e çlodhje spontane apo të organizuara,

për të cilat mund t'ju ndihmojnë banorët e zonës, të cilët kanë hapur shtëpitë e kanë filluar të presin turistët.

Kolonjarët merren me blegtorinë, pylltarinë, bletarinë, pemëtarinë, grumbullimin e përpunimin e bimëve medicinale e së fundi, edhe me turizmin agrar.

Është vërtet një përvojë e bukur që do t'ju pasurojë shpirtit, të ndani kohë me kolonjarët e të shikoni nga afër se sa njerëz të jashtëzakonshëm janë.



## Rreth e qark Kolonjës

**REHOVA** është një fshat i ngritur në rrëzë të Gramozit, në lartësinë 1150 m mbi nivelin e detit dhe është një nga fshatrat më të bukura të Kolonjës. Fshati ofron një pamje të mrekullueshme në brendësi të tij, është një fshat karakteristik me shtëpi të ndërtuara me gurë dhe të mbuluara me rrasa (ploça) guri. Me muret rrethues të oborrit të ndërtuar me gurë, porta prej druri e me kolona prej guri të gdhendura nga mjeshtrat e gurit, Rehova ka filluar të hedhë hapa e parë drejt turizmit të bujtinave. Vendndodhja e tij në rrëzë të malit të Gramozit, krijon mundësinë të shohësh një pamje të mrekullueshme të Ersekës dhe zonës përreth. Banorët e Rehovës që shquhen për mikpritjen, ofrojnë tashmë shtëpite e veta për turistët që vijnë për të shijuar mrekullitë e këtij fshati. Interesante në këtë fshat janë kishat e fshatit ku vlen të përmenden si më të veçantat:

- **Kisha e Shën Kollit**, e ndërtuar në vitin 1820, që është kishë katedrale, ikonostasi i së cilës për vetë vlerat e rralla që paraqet, është tashmë i ekspozuar në Muzeun Mesjetar në Korçë

- **Kisha Shën Kollit i Vogël** është kisha më e vjetër në fshat e cila është ngritur në një koderrvarr ilir.

- **Kisha e Shën Gjergjit** e cila bën pjesë në kishat më të vjetra në fshat pas kishës Shën Kollit i vogël

Fshati dallohet për traditat në këngë valle dhe zejтари.

Folklori.

Rehova ka një folklor të pasur në këngë, valle etj. "Fiata" është valle e kënduar, e cila ka fituar shumë çmime në festival, më i njohuri në festivalin e Gjirokastrës në vitin 1978, ka fituar vend të parë. Vallja e kënduar "Fiata" lidhet me ripërteritjen e brezave. Ka edhe shumë valle të tjera të kënduara: "O limon i bardhë", "Murga qyqe", "Fshati i vogël, trima shumë" etj..

**BOROVA** është fshati ku përveç bukurive natyrore mund të vizitohet memoriali kushtuar viktimave të Masakres të viti 1943 nga pushtuesit nazistë.

Vodica është një tjetër fshat i bukur ku vlen të vizitohet kisha e Shën Kollit.

Në jugperëndim të Ersekës ndodhet peisazhi befasues i zonës së Pyllit të **GËRMENJ-SHELEGURIT**. Po të udhëtosh 30 minuta në jug të Ersekës, është një pyll në ruajtje, që përbëhet kryesisht nga pisha e egër, bredhi dhe lisi. Megjithatë nuk ekzistojnë shtigje formale, zona ofron shumë mundësi për udhëtime me këmbë ose kampingje. Por zona është mjaft e vizituar edhe për shkak se prej vitesh aty ushtron aktivitetin e saj "Farma Sotira", e cila e ka bërë të njohur jo vetëm në Shqipëri zonën e Kolonjës dhe të Leskovikut, por edhe jashtë saj, prej shumë turistëve të huaj që e vizitojnë e shkruajnë për të nëpër faqet e njohura të udhëtimit nëpër botë.

Kolonja ka muzikën, vallet e veshjet tradicionale të ruajtura në breza dhe grupin karakteristik të këngës kolonjare, njohur me emrin "As e vogël, as e madhe". Edhe Kolonja vetë nuk është as e vogël, as e madhe por është e mjaftueshme që të kënaqë dëshirat tuaja na një udhëtim që kur ta mbaroni e të kthehni në shtëpi, do të merrni me vete aromë Kolonje.





# Falme Falmiri

## RESTORANT

Kashtëbardhë, Lushnje, Albania; Tel: +355 69 40 60 262

*Ashtu siç e do tradita myzeqare*




Natural food, comfort, friendly hospitality and above all, tasteful dishes, all based on grill. The products are not to many but the taste is delicious and you will come back to experience again the same pleasure, if you come here once.



Artur Guni

# Me qerre dhe kuaj si romakët, nëpër shtigjet e rrugës Egnatia



**🇲🇰** AST (Albanian Sport and Tourism) ka mbi 7 vjet që me anë të aktiviteteve të saj e promovon këtë itinerar turistik. Në këto shtatë vjet, grupe nga Shqipëria dhe këto tre vitet e fundit edhe të huaj, kanë pasur mundësinë të përshkojnë shtigjet e saj në segmente të ndryshme të Shqipërisë ose edhe të gjithë itinerarin. Aktiviteti i organizuar nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në bashkëpunim me Universitetin e Venecias dhe AST Elbasani, para dy vjetësh pati një jehonë të madhe në media, gjë që solli edhe rritjen e interesit për këtë destinacion të ri. Pas këtij aktiviteti ka pasur një shtim të frekuentimit të këtij itinerari turistik në tri disiplina: ecja, biçikleta malore (dyrrrotaku) dhe motori. AST ka bërë shoqërimin (udhërrëfimin) e grupeve sipas kërkesave të agjencive turistike dhe individëve të ndryshëm në disa pjesë të Rrugës Egnatia ose dhe të gjithë segmentin e tij brenda territorit të Shqipërisë. Grupi i fundit u shoqërua nga udhërrëfyesit e AST, M.Çoçoli, përgjatë segmentit të rrugës Egnatia nga Durrësi deri në kufi me Greqinë.

**Rruga Egnatia** është një destinacion i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në trevat në të cilat ajo kalon. Tashmë mund të themi se ky destinacion mund të shfrytëzohet në shumë mënyra të tjera, duke e bërë mjaft interesant zhvillimin e këtij produkti turistik. Natyrisht që ecja në këmbë në shtigjet ku kalonte dikur gjurma e saj por edhe në copëzat e mbetura të kalldrëmeve, është një kënaqësi e vërtetë. Është gjithashtu një sfidë e bukur përshkrimi i saj edhe me biçikleta malore dhe motorra të lehtë off-road. Por pa mendoni pak sikur ta përshkonit me kuaj ose me qerre (përshtatur si qerret e luftës të periudhës romake) sa bukur do të ishte! Do ta ndienit veten një legjionar të vërtetë! Sot në Shqipëri kjo mund të duket si qesharake por në fakt është mjaft tërheqëse për një kategori turistësh të huaj dhe pse jo, edhe shqiptarë kur kjo kombinohet edhe me aktivitete të ndërmjetme apo duke vizituar objektet kulturore që ndodhen përgjatë segmentit, deri në kufi.

Në një bisedë që bëmë me administratorin e **Balkan Resort në Mirakë, Polis Librazhd**, si një stacion i ri tashmë i Via Egnatia, ai na rrëfeu shumë gjëra interesante nga zhvillimet e kohëve të fundit që kishin lidhje me itinerarin.

Ajo çka kemi vënë re ka qenë e rastësishme, thotë Misir Hoxha, kanë ardhur të huaj si gjermanë, anglezë, hollandezë, australiane, italiane, spanjollë, kinezë, francezë etj.. Ky ka qenë target grupi që ka patur interes për rrugën Egnatia. Shumë prej tyre kanë ardhur të organizuar në grupe, shoqëruar nga guida shqiptare dhe grupe të shoqëruar nga guidë gjermane (grup me motorra apo 4 x 4), shumë të tjerë këmbësorë me çanta

**🇬🇧** AST (Albanian Sport and Tourism) for over 7 years is promoting this tourist itinerary through its activities. During these seven years, groups from Albania and recently even foreign groups have been able to cross the paths in different segments of Via Egnatia in Albania or even the entire itinerary. One of the most outstanding activities, organized by the National Coast Agency in cooperation with the University of Venice and AST Elbasan two years ago, attracted the attention of media, which also brought about the increase of awareness and interest for this new destination. After this activity there was an increase in the attendance of this tourist itinerary in three disciplines: walking, mountain biking and motorcycling.

AST has guided these groups according to the requirements of tourist agencies and of different individuals in several segments of Via Egnatia or along the entire segments within the Albanian territory. The last group was guided by AST member, Marsel Çoçoli, along Via Egnatia segment from Durrës to the Greece border.

**Via Egnatia** is an important destination for tourism development in the areas in which it runs. We can already say that this destination can be used in many other ways, making the development of this tourism along this road very interesting. No doubt that walking on the traces of this road, and also on the remaining cobblestones, is a real pleasure. It's also a great challenge passing along on mountain bikes and off-road motorbikes.

But, just think of a moment how beautiful it would be if having the possibility to cross this road riding on horses or on chariots (adapted as Roman war chariots)! You would feel a true legionary! Actually, this may seem ridiculous in Albania, but in fact it is quite attractive for a category of foreign tourists and why not Albanians, if combined with intermediate activities or visiting cultural objects across the segment up to the border.

In a conversation we made with the administrator of the **Balkan Resort in Mirakë, Polis Librazhd**, as a new station of Via Egnatia, he told us many interesting things about the recent developments related to the itinerary.

"What we have noticed has been incidental, says Misir Hoxha. Foreigners come from Germany, England, Holland, Australia, Italy, Spain, China, France etc. This has been a target group interested in the Egnatia road. Many of them have been organized in groups, accompanied by Albanian guides but also groups accompanied by German guides (group of motorcycles or 4x4) and many others with backpacks or bicycles that have been alone or accompanied by another person.

What seems interesting is tourist age-groups. The German guided group consisted of tourist of 30-65-year-old. This guide has brought two groups during this summer season.

shpine apo me biçikleta që kanë qenë vetëm ose të shoqëruar nga një person tjetër.

Interesante ka qenë fakti i grupmohave të turistëve. Grupi me guidë gjermane ka patur grupmohën 30-65 vjeç. Kjo guidë ka sjellë dy grupe gjatë këtij sezoni veror. Albania Tradition ka sjellë 4 grupe me nga 12-16 persona gjatë sezonit. Grupet janë akomoduar me nga një natë. Udhëtimi i tyre ishte me ecje dhe biçikleta (kryesisht grupi ka qenë me francezë). Albania Cycle gjithashtu ka sjellë grupe me moshë të vjetër, 60 vjeç e lart.

Ka ndodhur që kanë fjetur dhe raste të tjera kanë qenë pushim kafeje ose drekë.

Past & Present gjithashtu ka sjellë grupe të ndryshme por vetëm për të drekuar (grupmosha +50 vjeç, spanjollë kryesisht si dhe kinezë). Shumë të tjerë kanë qenë të rastësishëm siç e përmenda më lart. Një sugjerim: fletëpalosje informuese për Rrugën Egnatia, do t'i kishin shërbyer shumë turizmit dhe zhvillimit të kësaj zone.

### Fillimi i rrugëtimit - Aty ku nis Egnatia

Pas ndërprerjes me det, Via Apia, ndërro emër dhe tashmë quhet Egnatia. Ajo nis në Durrës, ku ne bëjmë një shëtitje të shkurtër dhe menjëherë pas portit shkelim metrat e para të një rruge që edhe sot mban emrin Rruge Egnatia. Po në afërsi të rrugës ndodhet dhe Torra Veneciane e shekullit të XV. Më pas vazhdojmë drejt Muzeut Arkeologjik, ku takimi me historinë e antikitetit është edhe më i prekshëm sesa gurët e kalldrëmit të rrugës antike romake.

Edhe një vizitë tek Amfiteatri antik, jo me tepër se 400 metra larg. Ishte e nevojshme njohja me këto vepra të antikitetit, për të patur jo vetëm një panoramë sa më të qartë të epokës antike por për të nderur më shumë imagjinatën teksa do përshkonim shtigjet e lashta.

Pasi kaluam Durrësin, filluam menjëherë me ecjen.

Gjatë një diskutimi me miqtë turistë, ata lanë të kuptohej se ecja do të kishte të njëjtën natyrë me atë të ushtarëve romakë dhe me po të njëjtat pika drejtimi të përdorura nga ushtria e atëhershme. Pra ecja do të ishte e shpejtë dhe e gjatë, shtrirë në një hapësirë kohe dhe distance të konsiderueshme. Historia thotë që ushtarët romakë ecnin deri në 45 km në ditë, sepse edhe distancat ndërmjet

Albania Tradition has brought 4 groups with 12-16 people each during the season. The groups are accommodated by one night. They were hiking and riding bicycles (mostly the French group). Albania Cycle has also brought older age groups, 60 years and older.

Some of the groups has stopped overnight here, some other have stopped just for a coffee or lunch breaks.

Past & Present has also brought different groups, but only for lunch (age group +50, Spanish and Chinese). But there are also many other individual or groups that s have been casual as I mentioned above.

A suggestion: information leaflets on Via Egnatia would have served a lot to tourism and development in this area."

### Starting of the journey- Where Via Egnatia starts

After the sea break, Via Apia, changed its name to Via Egnatia. It starts in Durrës, where we made a short walk and immediately after the harbor, we continued along the road that still holds the name Via Egnatia. You can spot the Venetian Tower of the 15th century near the road.

Then we continued to the Archaeological Museum, where meeting with the history of antiquity is even more tangible than the cobblestones of the ancient Roman road. Another visit to the ancient Amphitheater, not more than 400 meters away. It is necessary to know something about these antiquity works, to have not only a clear picture of the antiquity, but to ignite the imagination while crossing the ancient trails of Via Egnatia. During discussions with several tourists, they told us that they intended to hike like the Roman soldiers did, using the same points of references the roman armies did. Thus, hiking would be fast and long. History shows that Roman soldiers walked up to 45 km a day, because distances between stations were also



With chariots  
and horses  
like the Romans,  
on the trails  
of Via Egnatia



 stacioneve të pushimeve ishin po ashtu 45 km njëra nga tjetra.

Edhe grupi ynë ka ecur përafërsisht me të njëjtat ritme, duke arritur një shpejtësi me së paku 28 km në ditë. Ama duhet të them se gjithmonë ishte një grup prej shtatë-tetë personash që luante rolin e lokomotivës dhe kryesonte gjithë kolonën, duke mbajtur të njëjtin ritëm ecjeje me atë të ushtarëve romakë. Pra ky grup ecte edhe dy orë më shumë.

### Segmenti i parë: Golem -Peqin

#### 1. Golem -Tilaj - Seferaj- Golemas – Zikularaj - Helmas - Memzotaj.

Ecja filloi në fshatin Golemas, nëpër kodrat e bukura nga ku duket edhe deti me qetësi dhe shkëlqimin e tij. Gjatë këtyre kodrave na ka shoqëruar një qetësi e papërshkruar. Tek sodisnim vreshtat e kantinës Belba, mendonim me ëndje se sa bukur do të ishte në të ardhmen kur ky itinerar të pasurohej me një ndalesë pranë vreshtave, nën hijen e bukur të strehëve të drurit, ulur në stola primitive, duke pirë verë me kupa balte, ashtu siç mund të kenë bërë gjatë edhe ushtarët romakë gjatë shtegtimeve të tyre. Në këtë segment nuk do të ishte keq të bëhej një ndalesë në Kishën shekullore romano-gotike të Çetës, apo edhe një vizitë në kalanë fushore të Bashtovës, në dalje të Kavajës.

#### 2. Memzotaj- Kryezi – Memollaj – Hasdushk – Rrezej – Karinë – Peqin.

Edhe dita e dytë ishte po ashtu një ecje në rrugë kodrinore, mes ullijsh dhe fushash të mbjella, një peisazh qetësues e mbresëlënës që po ta zhvendosje në kohë, ishte një kuadër i bukur në sfond të kolonës së gjatë të ushtarëve romakë (krahasimi i vazhdueshëm me ushtritë romake në mendjen tonë, ishte më i fortë sesa çdo karvan i mundshëm tregtar sepse na pëlqente ta mendonim veten luftëtarë si ata. Na mungonin vetëm qerret luftarake, që do të përpiqeshim t'i përfshinim në itineraret e ardhshme)

### Segmenti i dytë: Peqin –Elbasan

#### 1. Peqin – Fatishë – Perparim -Lolaj - Pajove – Grykesh - Broshkë

#### 2. Broshkë – Valas - Muriqan - Jagodinë - Ura e Topçias - Elbasan.

#### Peqini. Kludiana-Biklinet-Peklin-Peqin

Peqini është një vendbanim i lashtë ilir, në bregun e majtë të lumit Shkumbin. Pozicioni gjeografik, ia jepte atij një mundësi të tillë, duke qene i vendosur përgjatë rrugës së vjetër të KANDAVISË e më pas të asaj Egnatia, i njohur me emrin Kludiana. Në burimet historike të vitit 1431 thirri me emrin Biklinet dhe me pas Peklin.

Nese ju keni dëshirë dhe kohë, mund të devijoni pak rrugën majtas dhe të vizitoni fshatin ku është gjetur një nga thesarët me të famshme, i njohur si Thesari i Vrapit, i cili u zbulua rastësisht më 1902 në një arë të fshatit Vrap, në rajonin e Peqinit. Një pikë e rëndësishme që nuk duhet humbur përgjatë këtij segmenti është stacioni romak Add Quintum, rrënojat e të cilit ndodhen në Bradashesh. Stacioni Romak, një kompleks arkitekturor i gjysmes së dytë të shekullit të dytë dhe gjysmës së

parë të shekullit të tretë të e.r. me gjatësi 25 metra dhe gjerësi 11 metra, ka dhomat e zhveshjes (lat: apodyterium) të ujit të freskët dhe ujit të vakët. Ndonëse nuk është shumë i mirëmbajtur, është mjaft interesant për t'u vizituar.

### Segmenti i tretë: Elbasan -Qukës

#### Elbasani ( Skampis ) - Valm, Neokaster, Ili-basan

Elbasani është edhe qyteti më i madh që mund të konsiderohet si stacion qëndrimi përgjatë rrugës Egnatia. Qyteti që u kurorëzua nga dy nga perandorët më të mëdhenj të kohës Diokleciani i Perandorisë Romake (me origjinë Ilire 284 - 305 para Krishtit), i cili emërtoi Skampi dhe pas shkatërrimit në vitin 479 nga Visigotet, drejtuar nga Theodoriku, rindërtohet nga Mehmeti II, i Perandorisë Otomane i cili e emërtoi Ili-basan - Elbasan e shqipëruar. Por në shekullin e V dhe të VI mendohet se është quajtur me emrin Valm pas rindërtimit nga Perandori Romak me origjinë Ilire Justiniani.

 45 km apart.

Our group also walked almost at the same pace, reaching a speed of at least 28 km per day. I must say that there was always a group of seven or eight people who played the "locomotive" role and headed the entire column, keeping the walking pace of the Roman soldiers.

### I. First Segment

#### 1. Golem -Tilaj – Seferaj – Golemas – Zikularaj – Helmas – Memzotaj

The hiking started in the village of Golemas, through the beautiful hills, where you can look at the sea beaming in its tranquility and splendor. Hiking through the hill was unspeakably calm. While contemplating the vineyards of Belba winery, we wondered how beautiful it would be in the future when this route will be enriched by a vineyard stop, under the beautiful shade of wooden shelters, sitting in primitive benches, drinking wine in clay cups, as Roman soldiers may have done elsewhere during their pilgrimage. It would be a good idea to have a station in this segment by the ancient Roman-Gothic Church of Çeta, or even a visit to Bashtova's field fortress, at the outskirts of Kavaja.

#### 2. Memzotaj- Kryezi – Memollaj – Hasdushk – Rrezej – Karinë – Peqin

During the second day, we continued hiking in the hillsides, between olive groves and planted fields, a relaxing and impressive landscape that, imagining back in time, this beautiful scenery should have accompanied the long columns of Roman soldiers (imagining ourselves as warriors, we loved comparing with Roman armies, a stronger comparison than with any potential merchant caravan. We only lacked the war chariots, which we would try to include in the future itineraries.)

### II. Second segment -Peqin – Elbasan

#### 1. Peqin – Fatishë – Perparim -Lolaj - Pajove – Grykesh - Broshkë

#### 2. Broshkë – Valas - Muriqan - Jagodinë - Ura e Topçias - Elbasan

#### Peqin. Kludiana-Biklinet-Peklin-Peqin

Peqin is an ancient Illyrian settlement, on the left bank of Shkumbin River. The geographic position granted Peqini, known as Kludiana, such an opportunity, being located along the old path of CANDAVIA and latter of Via Egnatia. In the historical documents of year 1431 it was known as Biklinet and then Peklin.

If you have the desire and time, you can take a little left to visit the village where one of the famous treasures was discovered, known as the Treasure of Vrap. It was accidentally discovered in 1902 in a field near the village.

Another important place that should not be missed along this segment is the Roman Add Quintum station, the ruins of which lie at the village of Bradashesh, near Elbasan. The Roman Station, an architectural complex of the second half of the second century and the first half of the third century BC., with a length of 25 meters and a width of 11 meters, consist of the dressing rooms (lat: apodyterium) and rooms with fresh and lukewarm water. Though not very well maintained, it is quite interesting to visit.

### III. Third Segment - Elbasan -Qukës

#### Elbasani (Skampis) - Valm,

#### Neokaster, Ili-basan

Elbasan is the largest city that can be considered a residence station along Via Egnatia. The city was crowned by two of the greatest emperors of the time: Diocletian of the Roman Empire (of Illyrian origin 284 - 305 BC), who named the city "Skampi" and after the destruction by Visigots in 479, led by Theodoriku, it was rebuilt by Mehmet II of the Ottoman Empire, who named the city Ilyabhan - Elbasan. But in the 5th and 6th centuries, it is thought that it was called Valm after the rebuilding by Justinian - the Roman Emperor of Illyrian origin.

Elbasan Castle had 26 towers in equal distances from each other, throughout the 9 m height wall. Via Egnatia passes through the castle in the East - West direction. Nowadays, it has remained only the south gate as the entrance to the castle. The castle was surrounded by a moat that was filled by the deviation of Zaranika and Manazderje streams. There are many places to visit in Elbasan like the Elbasani mosaic, old churches and mosques, the clock tower, the ethnographic museum,





the building where the Congress of Elbasani was held and many other interesting places.

### 1. Elbasan - Hajdaran - Shushicë - Polis - Mirakë

In Shushica, there is a beautiful tourist attraction, Bysheku, a spring of cold water, an amazing place for picnics or lunch breaks. If you are interested, on the way you can visit the Castles of Mengël and Xibrakë.

In Polis - Mirakë is a tract of Via Egnatia together with Kamara Bridge in Mirakë. The territory between Elbasan and beyond Qukës was once owned by the Illyrians (Candav) tribes, and therefore this street is also known as Candavia. Particularly distinctive is that in this segment there was a well-known temple in ancient times dedicated to Diana, which was known by the Romans as Diana of Candavia.

### 2. Mirakë - Babje - Spathar - Dardhë

### 3. Dardhë - Xhyrë - Qukës Skënderbe - Bërzeshtë (Qukës)

## IV. Fourth Segment - Qukës - Ohër

In Selca e Poshtme, on the right side of Qukës, there is a unique and important archaeological point of Albanian ancient history. Archaeological finds brought to light five monumental antique stone graves excavated in the rock in Selca e Poshtme, which tells about a society of a high economic and cultural level of the IVth - IIIrd century BC.

Monumental tombs of Selca e Siperme and other archaeological discoveries speak of an extremely developed region in ancient times. It is thought that we are dealing with ancient Pelion. Here lived and was buried the Illyrian King, Klit.

Along this road segment there is also the Goliku Bridge. According to historical documents of antiquity, this area was inhabited by the Illyrian Tribes of Enkelej and Desarae. In this region, at the end of the Vth century (BC), a powerful Illyrian state was formed, with settlements and castles around Ohrid Lake like: Enkelana, Lyhnikos, Pelion, Sation, Baos etc. These centers have played an important role in the Illyrian - Macedonian and Illyrian - Roman wars.


### 1. Bërzeshta - Prrenjas - Qafë Thanë Kufi

On the hill surrounding the town there is a place called Pogradec Castle. The castle has been inhabited from the Vth century BC until the Xth century, after which the inhabitants descend closer to the lake, which the Romans called Lyhnikos that means Lake of Light. You should not miss a visit to the village of Lin along this segment to see Lin's wonderful mosaics, a work that dates back to the IVth - Vth century, the time of the Roman Emperor of Illyrian origin, Justinian.

### 2. Qafë Thanë Kufi - Radozhda - Kalishta - Struga

This segment is really beautiful. The mountain, forests and the Lake create a stunning



 Kalaja e Elbasanit ka pasur 26 kulla në largësi të barabartë nga njëra-tjetra, gjatë të gjithë murit me lartësi 9 m. Në këtë fortesë "Via Egnatia" kalon përmes saj me drejtimin Lindje - Perëndim. Sot, nga hyrjet (Portat) e kësaj kalaje ka mbetur vetëm porta jugore. Kështjella ka qenë rrethuar me një hendek, që mbushej nga devijimi i përroit të Zaranikës dhe Manazderjes. Në Elbasan ka shumë vende për t'u vizituar, që mund t'ia kërkonin udhërrëfyesit tuaj.

### 1. Elbasan - Hajdaran - Shushicë - Polis - Mirakë.

Në Shushicë ndodhet një atraksion i bukur turistik, Bysheku, një burim me ujë të ftohtë, idela për një piknik ose pushim dreke. Në Mengel, nëse e zgjatni kohëqëndrimin tuaj, mund të vizitohet Kalaja e Menglit kurse në Xibrakë, Kalaja e Xibrakës.

Polis - Mirakë ndodhet një trakt i rrugës Egnatia dhe Ura e Kamarës në Mirakë. Territori ndërmjet Elbasanit dhe përtej Qukësit dikur ka qenë në zotërim të fiseve Ilire Kandave (Candav) dhe prandaj edhe kjo rrugë është emërtuar dhe njohur edhe si Kandavia. E veçanta është se në këtë segment ka qenë një tempull mjaft i njohur në antikitet kushtuar Dianës dhe nga romakët njihet si Diana Kandave.

### 2. Mirakë - Babje - Spathar - Dardhë.

### 3. Dardhë - Xhyrë - Qukës Skënderbeu - Bërzeshta (Qukës)

## Segmenti i katërt: Qukës - Ohër

Në Selcën e Poshtme, në krahun e djathtë të Qukësit ndodhet një pikë arkeologjike unike dhe mjaft e rëndësishme për historinë e lashtë të shqiptarëve. Zbulimet arkeologjike nxorën në dritë në Selcën e Poshtme pesë varret monumentale të antikitetit, të gërmuara në shkëmb, gjë që flet për një shoqëri me nivel të lartë ekonomik - kulturor të shekullit IV-III para Krishtit (BC).

Varret monumentale të Selcës së Sipërme dhe zbulimet e tjera arkeologjike, flasin për një rajon tepër të zhvilluar në lashtësi. Mendohet se kemi të bëjmë me Pelionin e lashtë. Këtu ka jetuar dhe është varrosur edhe mbreti ilir Klit.

Përgjatë kësaj rruge ndodhet edhe Ura e Golikut

Sipas burimeve të antikitetit, kjo zonë ka qenë e banuar nga Fiset Ilire të Enkelejve dhe Desarëve. Në këtë rajon në fund të shekullit V (BC), u formua një shtet i fuqishëm Ilir, me vendbanime dhe kështjella rrotull Liqenit të Ohrit si: Enkelana, Lyhnikos, Pelion, Sation, Baos etj. Këto qendra kanë luajtur një rol të rëndësishëm në luftërat Iliro - Maqedonase dhe Iliro - Romake

### 1. Bërzeshta - Prrenjas - Qafë Thanë Kufi

Në kodër, sipër qytetit ndodhet vendi i quajtur Kalaja e Pogradecit. Kalaja ka qenë e banuar që në shekullin V para Krishtit (BC). Ka qenë e banuar deri në shekullin X, kohë pas të cilës banorët zbriten më afër Liqenit, të cilin Romakët e quajten Lyhnikos, që do të thotë Liqeni i Dritës.

Nuk duhet humbur edhe një vizitë në fshatin Lin përgjatë këtij segmenti, për të parë Mozaikët e mrekullueshëm të Linit, vepër kjo që i përket shekullit të IV-V, kohës së sundimit të Perandorit



## Takimi Ndërkombëtar i Turizmit Malor dhe Kulturor

"Egnatia - nyje e rëndësishme për shkëmbimin e tregtisë e kulturave në mes popujve në lashtësi, por edhe në ditët tona"



Romak me origjinë ilire, Justinianit.

### 2. Qafë Thanë Kufi - Radozhda - Kalishta - Struga.

Këtu rruga ishte shumë e bukur. Në prani të malit dhe pyjeve e Liqenit, krijohet një panoramë mahnitëse gjatë të gjithë rrugës deri në Strugë.

Në vazhdim jashtë kufirit të Shqipërisë itinerari ishte ky:

### 3.Struge -Ohër

#### Ohër - Manastir (Bitola).

##### 1. Ohër - Velgosti

##### 2. Velgosti - Petrino - Resen.

##### 3. Resen - Sopotska - Diavato pass-Kazani - Dolenci - Capari

##### 4. Capari - Rotino -Trnovo-Dihono.

##### 5. Dihono - Brusknik - Lavci - Bukovo - Manastir (Bitola) Heraklea Antike.

#### Bitola -Niki (kufi me Greqinë)

##### 1. Bitola - Heraclea - Bukovo - Bistrica - Oliveni - Bareshani - Velusha - Nikki (pika kufitare).

Ishte një udhëtim shumë i bukur por gjithashtu i lodhshëm.

Rruga zgjati shtatë ditë, katër ditë në Shqipëri dhe tri ditë në Maqedoni.

Patëm fat që koha që me ne. Një kohë me diell Shtatori dhe pa erë.

Rruga të jep një ndjesi tjetër të papërshkruar sepse është një rrugë me shumë histori dhe lavdi brenda saj. **863 kilometra lavdi dhe histori, të përshkuara me shumë dashuri.**

panorama along the way to Struga.

The itinerary next to the Albanian border is as follows:

### 3. Struge -Ohër

#### Ohër - Manastir (Bitola)

##### 1. Ohër - Velgosti

##### 2. Velgosti - Petrino - Resen

##### 3. Resen - Sopotska - Diavato pass-Kazani - Dolenci - Capari

##### 4. Capari - Rotino -Trnovo-Dihono

##### 5. Dihono - Brusknik - Lavci - Bukovo - Manastir (Bitola) Heraklea Antike

#### Bitola -Nikki (near the Greek border)

##### 1. Bitola - Heraclea - Bukovo - Bistrica - Oliveni - Bareshani - Velusha - Nikki

It was a very nice, but also tedious hiking. It lasted for seven days, four days in Albania and three days in Macedonia. We were lucky to have a wonderful weather - beautiful sunny September days.

This road gives you an unspeakable sensation,

because of its history and glory - **863 kilometers of history and glory, overwhelmed with love.**





The new Via Egnatia station!



**BALLKAN**  
RESORT

National Road  
Elbasan - Librazhd - Prentas  
Cel Phone: +355 694439601  
info@hotel-ballkan.com  
info@resortballkan.com  
www.hotel-ballkan.com



Only 10 km from Elbasan you will find the perfect waving combination between modern architecture of "Ballkan" Resort with virgin nature. The nature near the river Shkumbin, between the surrounding mountains makes the picture even more wonderful. Here you can take a deep breath because of the clean air, tranquility, comfort, quality of service, which are characteristics that make this resort even more special. 3 stars BALKAN resort is the most luxurious hotel in the region of Elbasan; it is a massive 3 -floored building comprising 20 rooms.

At Your disposal You can find :

- air-conditioned rooms, \* 9 single rooms, \* 9 double rooms, \* 2 suites
- - rooms "Luxury" category without central air-conditioning



Restaurants and Entertainment Places:

BALKAN hotel restaurants offer luxurious and comfortable atmosphere with exquisite style and excellent service. The Menu includes international cuisine with great variety of food and drinks, as well as traditional Bulgarian dishes and wines. The atmosphere is exceptionally proper for business lunches and dinners, romantic dates and for organized business and private parties.

\* Panorama restaurant with 60 seats and located near the river Shkumbin

\* Basic restaurant BALKAN comprising of a small hall with 100 seats, and big terrace



Resort Ballkan,  
Elbasan



# Kelmendi

## bukuria e rrallë në gji të Alpeve

**Rozafa Topalli**  
Fotot: Mario Gjini

**■ Mirë që qershori është disi i paedukatë dhe troket pa takt me grushtin plot vapë, por është edhe hamletian: “Jam apo nuk jam verë?!”...**

Duke bërë 2 llogari të thjeshta; 1. Ngrohja globale dhe 2. Koordinatat mesdhetare, padyshim që qershori i bie të jetë verë e kaluar verës. Dhe ku flitet për verë do dyzohesh patjetër me pushimet.

Riepilogramë! Eshtë qershor; është verë! Ka pushimeee! Ku? Sa? Me kë?

Sa herë na ka ndodhur që të na pyesin : “Ku do shkoni për plazh sivjet ?”...dhe kushedi, diku ndonjë “bardhosh” edhe mund të jetë bezdisur nga kjo pyetje rutinë.

Plazh?! A thua se pushimet janë vetëm plazh, det e rërë! E duke kaluar në mendime gjithë alternativat e mundshme, na ndizet befas një llambushkë e gjelbër. Gjelbëroshe, ashtu si vetë natyra e maleve të veriut. Pikërisht ajo natyrë që për shumë kohë e kemi paragjykuar, injoruar e dizintegruar, përbën sot për sot një nga ato oazet e Parajsës Tokësore.

**■ June is somewhat rude and tactless, when it pounds the door with its fists full of heat, and it has the audacity to act like a Hamlet: “Am I, or am I not summer?!...”**

Accounting for two events at once, the global warming and the Mediterranean coordinates, the month of June is undoubtedly summer. When talking about summer you immediately think of vacations.


Let's start over! It's June, it's summer! It's vacation time! Where? How much? With Whom? How many times we have been asked: “Where are you going to the beach this year?”...and maybe, someplace, some pale skinned man must have been annoyed by this common question.

The beach?! Vacation doesn't mean only beach, sea and sand! While bringing to mind all possible options, suddenly a green light ignites. It is color green, resembling the landscape of the northern mountains. This natural




# Kelmend

the rare beauty  
of the  
Northern Alps






 landscape that has been contemplated, ignored, and disintegrated is one of the paradisiacal earthly oases today.

The mountains of Kelmend are slowly revealed, while travelling in the paved curvy roads reaching Tamarë, Lepushë, and Vermosh! Landscapes that were previously thought as Photoshop masterpieces, found only in lucky places, there this depicted reality is humble and undeniable. There are fresh air, traditional and healthy food, acoustic tranquility and divine peace. The perfect place to become undone and to unite all the pieces of self scattered from the daily routine and usual stress; to revamp and retreat. The love for the live stock and for the human being in its core essence takes a whole other meaning. While slowly we take on the mantle of the philosopher, it is the turn of photography. It will be an unforgivable sin, if we didn't take pictures of the surrounding landscape offered to us. On our return, we could, admittedly, sell them for post cards. What about the beach?! – would ask some of you, who have their swimming suits ready.

Not a problem! The many guesthouses in the area offer an exceptional accommodation and they have not forgotten the swimming pool. In spite of this, next to Vermosh, there is the lake of Rikavec, which extends until Montenegro. And, in case your taste is still not satiated and you wish to continue exploring, a car is needed to reach the cities of Plava and Gucia, which are 20 km away from Vermosh. Even though, we have crossed the border and reached Montenegro, most people there are Albanians. The profound natural beauty of the mountains continues here. The natural park of Vuthaj, the startling romantic lake of Plava and the historical creeks of Ali Pasha Gucia are some notable see sights. The whiff of the historical and the traditional, and the staggering nature entice you so much that it seems almost like a betrayal not to share this

 Malësia e Kelmendit shkopsitet dalëngadalë, tek udhëton nëpër rrugët e shtruara gjarpëruese.

Tamarë, Lepushë, Vermosh! Peisazhe që dikur mendoje se ishin veçse mjeshtëri të photoshop-it, apo thjesht domeine të vendeve fatlume, atje janë një e vërtetë modeste dhe e pamohueshme.


Ajri i pastër, ushqimi tradicional dhe i shëndetshëm, qetësi akustike dhe paqe shpirtërore. Vendi i duhur për t'u ribërë; për të mbledhur gjithë vetët tona të shpërndara nga rutina e stresi i përditshëm; për t'i ritrajtuar dhe rivlerësuar. Dashuria për gjënë e gjallë, për njeriun si esencë, nis e merr një kuptim tejet të rëndësishëm.

Pasi , dalëngadalë bëhemi pak "filozofë" vjen radha e fotografisë...Do ishte mëkat i pafalshëm të mos bënim foto të të gjitha panoramave sugjestionuese që të ofrohen. Në kthim, pse jo, mund t'i shisnim për kartolina mirëfilli ;)

Po plazhi?! - do thonit ju, që keni blerë kostumet e banjos...

Pa problem! Bujtinat e shumta aty, me kushte më se të mira, nuk mund ta kishin anashkaluar as idenë e pishinës. Përpos kësaj, shumë afër Vermoshit, pozicionohet edhe liqeni i Rikavecit (një pjesë e së cilit kalon në territorin e Malit të Zi ) E pas gjithë kësaj, nëse jeni vërtet të pangopur dhe doni të vazhdoni me eksplorimet, mjafton një makinë dhe 20 km larg Vermoshit, shpërfaqen qytetet e Plavës e të Gucisë. E megjithëse nga pikëpamja kufitare kemi kaluar në Mal të Zi, aty shumica janë shqiptarë. Vazhdon hijerëndë bukuria natyrore malore. Spikasin parku natyror në Vuthaj, liqeni




 piktoresk e romantik i Plavës si dhe krojet historike të Ali Pashë Gucisë. Tisi historik, tradicional dhe natyra mbresëlënëse të yshtin aq shumë sa që të duket diçka vërtet tradhtare po të mos e bashkëndash me të tjerët këtë eksperiencë të vyer.

Tanimë, nëse nuk ju kemi bërë absolutisht ziliqarë, aq sa ta quani detyrim vizitën e Alpeve të Veriut, ju rrëfejme thjesht, se alibia e një vere të bukur dhe ripërtëritëse nuk mund gjendet askund tjetër përveçse aty!

...dhe prapë e di se ata skeptikët e përhershëm do thonë : “Mbaroi vapa me gushtin?!”

Padyshim që vera e vjeshta janë si “vjehrra e nusja”; duhet t’i lënë medeomos radhën njëra-tjetrës. Me të ardhë shtatori, natyra egërsohet dhe normal që në zonat malore kjo vihet re theksueshëm. Duket sikur sipari stinor aty, ngrihet sa hap e mbyll sytë dhe na prezanton një skenografi të re, me ngjyrat e bronzta, në bakër e okër. Natyrën e ftohtë e kompensojnë shkëlqyeshëm vatrat e oxhakëve plot zjarr të pashuar; aty ku të shijon thelbësisht ushqimi, muhabeti, dhe njeriu. Në vjeshtë, “vera” struket nëpër shtëpi, bujtina e hane dhe shpeshherë identifikohet me bujarinë dhe gojëtarinë e zotit të shtëpisë. Tek më të moshuarit duket sikur ka ngelur si hije ajo “frika” e dimrit acar, masat ushqimore për të cilin, i duhej t’i merrnin të mirëmenduarat e madje që nga fundi i stinës së nxehtë. Por jo, kjo është diçka e superuar tashmë; kufiri është vetëm 20 minuta larg; rruga është e shtruar, e asfaltuar dhe tejet ftuese për udhëtim. Bora është akoma në fazën e kukafshehtit, por që mirëpritet. Malësia e Kelmendit duket si vendi ideal për të projektuar së afërmi pistat e skive dhe teleferikët. Me shpresën e mirë që në destinacionet turistike dimërore të shtohet së shpejti edhe kjo Malësi hirëplotë dhe të mos i kemi më zili as shteteve fqinjë, ju ftojme të bëhemi turistë në vendin tonë, që t’i kuptojmë edhe më mirë se çfarë i ka dyndur kohët e fundit tek ne, turistët e huaj! Pa klishe’ dhe me natyrën në shpirt, do mund të shohim qartësisht atë që me të vërtetë meriton të quhet e bukur!!

 precious experience with the others. Now, unless you haven’t become totally jealous, so that you make it your duty to visit the Northern Alps, we show you the alibi of a beautiful and retreating summer that you won’t find anywhere, but here!

...and yet I know the eternal skeptics will say: “The heat wanes after August?!”

Summer and autumn are like daughter and mother-in-law, undoubtedly; they must give way to one another. When September comes, the nature becomes aggressive and normally that mountainous areas are mostly affected. It seems that the seasonal stage changes in a jiffy and a new script is present, adorned with bronze, copper and ochre colors. The cold nature is completed with an eternal fire laid in the hearth, where you can essentially savor the food, the chit chat and the interlocutor. In autumn, “summer” crouches inside homes, guesthouses and barns and it is often identified with the generosity and the storytelling of the host. The elderly experience the shadow left by the “fear” of an icy cold winter, so they are precocious and gather food provisions at the exit of the hot month. This is surpassed, however, the border is 20 min away, and the roads are paved and constructed and quite inviting to the traveler. The snow is still playing hide and seek, but it is welcoming. The mountains of Kelmend seem like the perfect place to built skiing paths and air trams. I hope that these mountains will be added to your winter holiday destination, so that you won’t feel envy for the neighboring countries, so we invite you to become a tourist in your own country, and to better understand what has caused foreign travellers to flock in our direction. Harboring no clichés and with nature at heart, you will plainly stare at what really deserves to be called beautiful!!

# 10 Lundrimet e mia me kanoë rreth e rrotull Shkodrës

▶ Kastriot Faci ©

Bregu i Ranës, Kiras

Që nga fillimi i këtij viti, kam arritur të bëj 47 udhëtime në mal e në natyrë, deri më sot. Kjo, si një sfidë me veten time në vitin e 50 vjetorit. Nga këto, 10 janë lundrime me kanoë. Hera e parë që lundroj me kanoë, shumë kënaqësi, por nga ana tjetër si pa dashje kam zbuluar disa nga destinacionet të rëndësishme të lundrimit me kanoë në Shkodër e në Pukë. Lundrimet i kam realizuar në liqenet e Shkodrës, Vaut të Dejës, Komanit, e në lumenjtë e Bunës e Drinit së bashku me miqtë e mi. Ndaj dua t'i falënderoj shumë ata, Andi Mulën nga "Water Sports on the Lake, Albania", Alket Camaj, nga Ferma ekosociale si dhe të gjithë bashkëlundruesit e

tjerë, Irena dhe Debora Negri Bakalli, Genta Trashani, Aurora Piroviq, Ingridi dhe Elionin Faci, Mark Kadarja, Jessicca Schelton, Blendi dhe Kujtim Gërdoçi, Mirsad Kuçi, Denis Ju etj.

## Liqeni i Komanit

U nisëm me makinë nga Shkodra rreth orës 07.30. Në kaladën e Komanit na u desh të prisnim pak, sa të nisej trageti i tejmbushur me makina e turistë vendas e të huaj, që ishin nisur drejt Fierzës. Destinacion kanë Valbonën. Lëshuam kanoet në ujë dhe të magjepsur shumë nga bukuria e shkëmbinjve të thepisur që na shoqëruan në dy anët e brigjeve të liqenit. Pas rreth 20 minutash e gjetëm veten



përballë me shpellën e Kaurrit. Një labirinth shumë interesant me dy dalje, një e mbi një. Shpella quhet kështu, pasi dikur kishte shërbyer për strehimin e murgjërve katolikë. Nuk mund t'i rezistojmë ujit të pastër të liqenit e të nxehtit të verës hidhemi të gjithë në ujë. Vazhdojmë lundrimin me kanoe. Format e maleve përreth dhe ujrat e liqenit që futeshin në thellësi të tyre me kujtojnë fjordet norvegjeze. Drekën e kemi marrë me vete dhe e po e hamë në breg të liqenit në fshatin Kishë Arre, vazhdojmë lundrimin. Në të dy anët tona në terrene shumë të thyera malore, shohim aty-këtu ndonjë shtëpi e ngastra të punuara e kopshte me pemë. Shtëpitë janë ndërtuar aq lart pasi liqeni i hidrocentralit të Komanit

u kishte zënë tokën me ujrat e tij. Ishulli i Paqes ndodhet në afërsi të udhëkryqit, aty ku ne duhet të marrim majtas, duke lënë kthesën e Fierzës e drejtuar për në Lumin e Shalës. Sigurojmë kanoet në portin e vogël pranë shtëpisë së Kapitenit Mario Molla. Familja e tij, një prej banorëve të vetëm në këto shkrepë, na mirëpresin buzagaz e zemërbardhësi, ashtu siç i ka hije malësorëve tanë. Dielli ka nisë pikiatën e vet tashmë, shenjat e lodhjes duken qartë tek të gjithë. Një shpellë na shfaqet pas një kthese të fortë prej 90 gradësh në ujrat transparente të lumit të Shalës. Lumi është kujdesur që shtroja e saj të jetë një grumbull rëre shumë i imtë. Ka rënë muzgu dhe sapo kemi mbërritur në Blini Park, në të vetmin lokal këtu në



Bregu i Ranës, Kiras



Buna



Lumi i Shalës

mes të maleve, buzë lumit të Shalës. Distanca e përshkruar sot është 17 km. E nesërmja do të jetë një aventurë me vete.

### Hani i Hotit- Syri i Sheganit (Liqeni Shkodrës)

Niveli i ujrave të liqenit këtë verë ka rënë si asnjëherë më parë. Leshterikët duket që janë zaptuesit e ujrave të Liqenit sidomos në cektinë. Ngjyra e ujit është kafe në të kuqe, pasojë e erës së fortë, e cila fryn pas shpinës sonë me rreth 23 km në orë, megjithatë është një ditë e ngrohtë. Era na shtynte fuqishëm pa patur nevojë për t' u dhënë rremave aspak. Destinacioni ynë për sot është Syrit i Sheganit, monument natyror. E lamë pas pikën kufitare të Hanit të Hotit. Ingredi, mbesa ime dhe unë të hipur në një kanoe dyshe lundrojmë në afërsi të bregut për të shmangur rrokullisjen e kanoes nga era dhe dallgët e forta. Merakosem për aparatën fotografikë më shume se çdo gjë tjetër, sepse ky është lundrimi im i 7-të. Elioni, i cili e ka për herë të parë udhëtimin me kanoe, u rrëzua dy herë në ujë, shpejt e shpjet, paçka se është një trup muskuloz. Bëjmë ndalesën e parë në kampingun e ngritur nga gjuetarë apo çobanë të zonës. Nuk jemi të sigurtë kush e ka bërë, por e përgëzojmë për pozicionin dhe formën e tij në mungesë, ndësa bëjmë foton e parë të grupit aty. Të mahnitur të gjithë shijojmë bukuritë natyrore të Syrit i Zi, Syrit të Sheganit dhe Syrin e Virit, të gjitha burime ujrash nëntoksore, që vijnë nga alpet Shqiptare. Të gjithë lahem në syrin e Kaltër dhe në Syrin e Virit. Era nuk përbën më problem për ne, na mbron kodra. Shijojmë drekën e më pas në vend të ëmbëlsires hamë fiq që këpusim nga një pemë fiku të egër, por shumë të ëmbël. Ndërkohë që një qen pastor na leh. Përshendetemi me të dhe me të zotët, turistë nga Polonia. Ata e kanë ngritur një kamping me tre çadra në brigjet e liqenit të Shkodrës. Pak më tutje një plakë e veshur me veshjen e zonës kujdeset për një tufëzë delesh, e punon një triko. Ajo na

përshendet duke na uruar rrugë të mbarë. Është fundi i udhëtimit tonë për sot. Distanca e përshkruar është 11 km në 6 orë.

### Lumi Drin- Plazhi Belaj, Lumi Buna

Këtë udhëtim e realizuam sëbashku me mysafirë të veçantë nga Kosova. E them kështu pasi na u bashkuan me ne Uta Ibrahimimi me shokët e saj Valonin, Vullkanin dhe Arlindin. Uta është femra e parë Shqiptare që ngjiti majën më të lartë në botë, Everestin. Nisemi nga ura e Bahçallëkut, lumi Drin e për shkak të rrjedhës së fortë të tij shumë shpejt e gjejmë vehten në rrjedhën e qetë të lumit Buna, buzë fshtatit Zues. Lundrimi në Bunë të jep siguri dhe kënaqesi të madhe, kjo pasi përgjatë dy brigjeve të shfaqen peisazhe të bukura, ku natyra është treguar e pakursyer për t' i dhënë dorën e saj. Ndalesën e parë e bëjmë në rrënojat e Kishës së Shirqit, është Kisha e Princërve, këtu janë bërë celebrimet martesore të princërve. Bëjmë ndalesa të tjera në vazhdim, freskohemi në ujrat e Bunës. Me ne kanë ardhur dhe Kozeta dhe Saimiri, gazetarë, Artur Guni dhe Prof. Filipi nga AST Elbasani, që si ne dhe ata e kanë me shumë pasion natyrën. Andi dhe unë jemi shumë të kujdesur që gjithmonë të pozicionohemi në krahun e majtë të lumit. Kjo pasi jemi në një zonë kufitare. Lumi Buna ndahet në dysh me shtetin fqinjë Malit të Zi si me thikë në mesin e tij. Distanca e përshkruar sot në 5.5 orë është 14 km. Mbërrijmë në Belaj, aty ku një grumbull rëre e imtë ka formuar një plazh shumë të bukur me pemë e hije. Nga ana tjetër e bregut vetëm rreth 30 metër, ngrihet një shpat shkëmbor me lartësi rreth 120 metër. Në majë të tij qëndron ndërtesa e postës kufitare Malazeze. Këtu bashkëlundruesve u tregoj historinë e arratisjes me spektaktoriale e të pazakontë, për ditën me diell gjatë rregjimit komunist. Gjatë aksionit për ndërtimin e shtëpive të rrëzuara nga tërmeti i vitit 1979 në fshatin Dajc, ishin angazhuar shumë të rinj vullnetarë nga i gjithë vendi ynë. Sejcilit prej shoferëve të kamionëve,



**Buna**



**Koman**



u ishte caktuar një ushtar i armatosur për siguri, kur u duhej të kalonin nëpër Belaj. Kështu mendonte "Partia" për tu siguruar që asnjëri nuk mund të arratisë. Mirëpo shoferi, një aksionist nga Durrësi kishte një plan. Pasi kishte hapur mbulesën e motorrit të kamionit, i kishte kërkuar ushtarit që ta ndihmonte e të mbante të shkelur pedalen e gazit të kamionit tip "Zis", pasi nuk po punonte mirë motori. Jepi, jepi, bërtiste shoferi mbi motorrin e makinës. Ushtari i mëshonte fort e më fort pedalat të gazit. Nuk po e dëgjonte me zërin komandues të shoferit ndaj ulët të shikojë për të. Ishte shumë vonë shoferi durrsak i kishte kaluar nga ana tjetër e lumit, ishte arratisur. Pikërisht ky vend ishte dhe destinacioni ynë për sot. Vizitoni Shqipërinë, vizitoni Shkodrën!

**Më kontaktoni nëse jeni të interesuar në daljen e radhës me kanoe në 0682026559.**

## 10 lundrimet e mia me kanoe

Nr. Nisja	Mbërritja	Zona e lundrimit
1 Shirokë	Ura e Bunës	Liçeni i Shkodrës e lumi Buna (dhe kthim)
2 Shirokë	Bregu i Ranës	Liçeni i Shkodrës (dhe kthim)
3 Shirokë	Gril, Omaraj	Liçeni i Shkodrës (dhe kthim)
4 Karmë	Rragam	Liçeni Vau i Dejës
5 Ura e Spatharit	Oblike	Lumi Drin dhe Buna
6 Oblikë	Khakaj	Lumi Buna
7 Koman	Lumi Shalë	Liçeni i Komanit e lumi i Shalës (dhe kthim)
8 Ura e Bahcallekut	Belaj	Lumi Drin dhe Buna
9 Hani i hotit	Syri i Sheganit	Liçeni i Shkodrës
10 Rragam	Ishulli i Shurllahut	Liçeni i Vaut të Dejës (dhe kthim)




**Lumi Drin nisja për në Belaj**



# Udhëtim përmes fotografisë së të talentuarës Ina Toska


Ajo është një vajzë e veçantë, që më shumë sesa me aftësi të veçanta, ka një talent të jashtëzakonshëm; dashurinë e pakufishme për jetën. Me një luftë të madhe përmes vështirësish që jo çdokush i ka kaluar në jetë, ia ka dalë mbanë jo vetëm të fitojë, por të bëhet edhe shembull frymëzimi për të tjerët. Sot ka gjetur pasionin e saj përmes fotografisë, e ndonëse shumicën e kohës ndihmon njerëzit në nevojë, gjen herë pas here edhe kohë për t'iu kushtuar udhëtimeve, duke na sjellë jo vetëm foto, por edhe mbresa të bukura. Kjo është Ina Toska, fotografja e talentuar fierake dhe ne ju kemi sjellë një udhëtim përmes fotove të saj.







*Pics-Trip through  
the focus of  
Ina Toska  
Photography*



# Unique traits



## Jona Kuka

### What is unique about Albania?

There are some things that you can only find here. Let's me walk you through them.

#### Kapar.

When you go to a shop and you really like something, but it happens that you do not have the full amount to pay for it, you can leave the store a kapar. The store keeper will hold it for you. And in the next couple of days you return with the rest of what you owe and get your stuff. This is a sweet negotiation because if it happens that you change your mind about the jacket or the dress and the original excitement wanes off, then you can apologize politely and get your kapar back. So, leaving a kapar is great for students or those with a low paid job or for anyone for that matter, who understands the value of money. One can leave a kapar only in smaller stores for clothing items, shoes, bags, books, and stuff like that.

#### Albanian.

The only place you can practice Albanian is Albania. We speak our own unique Indo-European language with influences from Latin, Turkish and of course English. The countries around us speak

different languages such as Greek, Serbo-Croatian, Macedonian, and Montenegrin Serbo-Croatian. So, if you want to say words like "rrota" for wheel; "lumi" for river; "gjethe" for tree leaf; "mal" for mountain; "dashuri" for love or "rrugë" for street, you can practice those strong consonants and clear open vowels only here. So "mirëseardhe ne Shqiperi" welcome to Albania. Even though you would hear opa or ciao in our everyday language like the greeks and italians would use it.

#### Drinking beer in public

Drinking beer in public can be a problem in some places like US or Canada but not here. You can enjoy one or two beers in the park with a group of friends without scaring out. Just be mindful to find a litter box on the way so you don't pollute the ground. Even though we aren't the most refined society when it comes to taking care of our public spaces we are working on it.

#### Gabi

Gabi open markets are the places where one can find used everything. We have a diverse Roma community, who is involved in trading second-hand clothes.

**Do you know of anything that is uniquely Albanian?**

**MADE IN ALBANIA**

**travel** supplement

- Kantina Kokomani
- Ferma Amalthia
- Kantina Herta
- Rezidenca jazoj
- Birra Puka
- Studio Alizoti



made in **albania**





# E BEGATA SHQIPËRI E MESME

## *The prosperous Central Albania*


Rezarta Delisula

© agroweb.org

 Kur Lufta e Dytë Botërore shkatërroi çdo gjë, vreshtarët francezë, të dëshpëruar në maksimum, rrëmonin në tokat e përcëlluara për të gjetur një fidan rrushi që mund të kishte shpëtuar pa djegur. Kjo skenë dashurie e nevojë për vreshtin, m'u kujtua teksa nisa rrugëtimin tim në prodhuesit e licensuar të verës në Shqipërinë e Mesme. Agjencia e Zhvillimit Rajonal 2, drejtoi guidën e rrugës së verës, një eksperiencë e veçantë që s'duhet lënë pa e provuar. Ndalesa e parë nga Tirana ishte në Marikaj, në një kodër të butë e cila ishte harmonizuar pafund nga vreshtat me rrush shqiptar, shesh i bardhë, kabërnët, merlot e mavrut. Eltjan Miçi është inxhinieri kimist i kësaj kantine, pjesa më e veçantë e së cilës ishte tuneli, aty ku ruheshin verërat e vjetëruara. Ai na shpjegon se kantina u ndërtua në vitin 2000 dhe në vitin 2004 filloi të merrej prodhimi i parë. Ai shpjegon se janë të shumë vizitorët që vijnë në kantinë dhe duan të kalojnë një pasdite duke shijuar verën shqiptare, duke shtuar se kjo verë shitet kryesisht në lokale por edhe në subjekte të

 When World War Two destroyed everything, French farmers of wine were fully desperate, so they dug in the scorched land to find a sapling that had maybe survived the heatwave. I was reminded of this love scene and a need for the vine, when I just started my journey to the licensed producers of wine in the Mid Albanian region. The agency for regional development no.2 led the way to the vineyard. This was a special experience that you must not miss. The first stop from Tirana was in Marikaj, in a soft hill that was infinitely in tune with the vineyards of Albanian grapes, a white square, Cabernet, merlot and Mavrut. Eltjan Mici who is a chemical engineer works in this wine cellar that has an inbuilt tunnel, where old wines were preserved. This inbuilt tunnel was the most interesting part. He was telling us that his canteen was built in 2000 and the first production yielded in 2004. He explains that there are many visitors that come to the canteen that want to spend an afternoon savoring the Albanian wine, this wine is destined for restaurants and other national subjects. "In a year they get 400 to 500

Vreshat e kantinës Belba, Golemas, Kavajë





Kantina Kokomani, Eminas, Shijak



Kantina Kokomani, Eminas, Shijak



 tjera kombëtare. “Në vit marrim 400-450 quintal rush e rreth 50% e prodhimit përkthehet në verë”, tregon Eltjani për AgroWeb. Pasi shijojmë verën e Kantinës Bardhi nisemi për në vreshtat më të mëdha në Shqipërinë e mesme por edhe në gjithë Shqipërinë, në vreshtat e fshatit Arapaj, pronë e vëllezërve Koka që posedojnë Kantinën “Skënderbeu” në Shkozet të Durrësit. Kjo sipërfaqe prej 50 hektarësh, ku 35 hektarë janë vreshta e të tjerat rrugë kalimi, duken më shumë si të pikturuara se sa të vërteta, e fundin e tyre nuk e shohim dot. Në këtë tokë janë mbjellë varietete të huaja si Chardonnay, Montepulciano, Negro Amaro dhe në vit merren 5 mijë quintal rrush, përkthyer në 500 mijë shishe vere. Kantina e Verës dhe e pijeve të tjera aloklike “Skënderbeu” është ndërtuar në kohën e komunizmit dhe me privatizimin e saj, investimet e kanë tjetërsuar. Megjithatë, pjesa më e pazakontë e kantinës nga na drejton Indriti, ishin vaskat e ruajtjes së alkoolit. Ato ishin gjigande, me lartësi rreth 6 metra e sipërfaqe rreth 20-25 metra katror. “Skënderbeu” është ndër të paktat marka shqiptare për pijet në botë dhe janë të shumtë turistët e huaj që vizitojnë kantinën. Vreshtat e Shqipërisë së Mesme Udhëtimi i rradhës është në Golemas të Kavajës. Kisha dëgjuar për këtë verë më parë dhe një miku im më pati thënë që, vreshtat i ka fantastike madje ai nuk tregonte asnjë lloj vere në lokalit e tij përveç Belba-s. Belba ishte shumë pranë fshatit Golemas, por ishte aq rrugë e mundishme për të shkuar aty sa s’bëhet. Investimet në infrastrukturë zero. Megjithatë, pas tronditjes nga gropat e rrugës, çdo gjë u harrua me pamjen fantastike të kodrinave mbushur me vreshta. Nga njëra anë Belba kufizohej me Pezën, ndërsa në anën tjetër dukej deti. Pikërisht, në një ndër këto anë dy vëllezërit kishin ndërtuar një vend me dru në formë rrethore për të pushuar. Ishte shumë fresk dhe Fatbardh Belba, që kishte jetuar në Montepulciano ia dinte shumë mirë shijimit të verës me djathra, krudo e salççe. Vera Shesh i kantinës Belba ishte fantastike, më e mirë se shumë verëra që kemi provuar rëndom, një shije dhe aromë. E shijshme gjithashtu ishte dhe kabërneta ndërsa chardonnay ishte e hatashëm. E ulur në mes të askundit, duke parë 15 mijë hektarë me vreshta e punën fantastike të vëllezërve kuptova se kjo punë do shumë dashuri. Ky ishte një vend që s’duhet lënë pa u parë e pa shijuar mrekullinë e verës shqiptare. Aty takuam Maksin, një inxhinier ndërtimi që punonte në Bashkinë e Kavajës, por që prej 30 vjetësh kishte studiuar në Torino. “Ka dokumente të vjetër që botanistë të njohur kanë thënë se toskana e sotshme e ka bazën nga fidanët që janë sjellë nga


 quintal of grapes and 50% of production is translated in wine,” says Eltjan. After we have savored the wine of Bardha wine cellar we head to the biggest vineyards in Central Albania and the entire Albania for that matter, the vineyards of Arapaj village, a property of Kokabrothers that own “Skenderbeu” Wine cellar in Shkozet, Durres. This surface of around 50 hectares, where 35 hectares are vineyards and the rest roads, seem to be painted rather than real, and the end isn’t in near sight. Foreign varieties are farmed in this land, like Chardonnay, Montepulciano, Negro Amaro and 5 quintal of grapes are produced from the land, which translate to 500 thousand wine bottles. The wine cellar and of other alcoholic beverages “Skenderbeu” was built during communism, but privatization followed with investments that altered its face. However, Indrit is leading us to the most unusual part of the wine cellar, which was the tub serving to preserve alcohol. They were gigantic standing at 6 meters tall and a surface of 20-25 square meters. “Skenderbeu” is one of the few Albanian brands of beverages in the world and many foreign tourists visit the wine cellar. The next stop in our journey to the vineyards of Centra Albania is Golemas, in Kavaje. I heard about this wine before and a friend of mine said to me that the vines are fantastic and he didn’t offer any other wine in his restaurant, but Belba. Belba was close to Golemas village but the road to there was very difficult. Investments in infrastructure were non-existent. However, after the blows of the road troughs, everything was forgotten as in front of us appeared eager the hills covered with vineyards. At one side Belba was in the border of Peza, and in the other side was the sea. Exactly at this place the two brothers had built a wooden structure for relaxing. It was really cool so Fatbardh Belba, who had resided in Montepulciano was a connoisseur of drinking wine while tasting cheese, crudo and sausage. Shesh wine produced in Belba wine cellar was fantastic, better than many wines that we had randomly tasted, it had a distinct smell and taste. Cabernet was also tasty while Chardonnay was exceptional. Standing in the middle of nowhere, overlooking 15 thousand hectares of vineyards, property of the brothers, I realized that this amount of work requires plenty of love. You should consider visiting this place and tasting the delicious Albanian wine. We met with Maks, a construction engineer who worked



Kantina Herta, Maminas, Durrës



 at the Municipality of Kavaja, who had studied for 30 years in Torino. "There are old documents that say that renowned botanists have attested that present dayToscana vineyards are originals saplings originating from the coast of Durrës. One of them is Columella as this region is known for its vines," says Maks. If you go to Belba vineyards you don't want to go away, but the directors of the agency of regional development that manage the promotion of Albanian values would accompany us to another fantastic place, and that was the Kokomani wine cellar, a few kilometers away from Shijak. Kokomani wine cellar works as agro business. It is not opened usually, so you have to make reservations, while despite tasting the regional wine there is traditional food and the oven-baked lamb. Visi, who works at the Municipality of Shijak as a consulting expert, tells us that there are four licensed wine canteens in his area and many other smaller producers. Kokomani wine cellar looks awesome. With the sun on top and a lot of surrounding nature. A boy tells us that when the owner of this place was investing the people despised and mocked him, meanwhile, today, many look at him with envy because he applied his long-term idea successfully. After tasting Albanian wines, all of them good and qualitative, we returned in Tirana. This is not the only road of wine, there are many other canteens in Central Albania, like Duka and Herta wine celars. They have tremendous good value, as well, and without a doubt they must be first explored and valued by us, Albanians.

 Gjiri i durrësit. Një prej tyre është Columella e në fakt kjo zonë është e artë për vreshtari", thotë Maksi. Nëse shkoni te vreshtat e Belbës s' do ju bëhet të ikni prej andej, por drejtuesit e agjencisë së zhvillimit rajonal që merren me promovimin e vlerave shqiptare do të na shoqëronin në një tjetër vend fantastik, në kantinën Kokomani, pak kilometra larg Shijakut. Kantina Kokomani funksionon si agrobiznes. Zakonisht nuk është i hapur gjithmonë e funksionon vetëm nëpërmjet prenotimit, ku përveç shijimit të verës vendase do të shijosh dhe ushqime karakteristike shqiptare dhe mishin e qengjit në furrë. Visi, që punon në Bashkinë e Shijakut si këshilltar na tregon se vetëm në zonën e tij ka katër kantina vere të licencuara e plot prodhues të vegjël. Kantina Kokomani ka një pamje super. Detin përballë e shumë gjelbërim. Një djalë na tregon që kur pronari i saj kishte nisur të bënte këtë investim, njerëzit e përfllisnin dhe talleshin ndërsa sot të gjithë e shohin me zili për mendimin afatgjatë dhe të suksesshëm të tij. Kantina Herta nuk është tjetër veçse Kantina e families Hamdi Osmani.

Krijuar nga kjo familie, ajo nisi prodhimin pasi kishte krijuar një sipërfaqe prej 4,5 hektarësh vresht në Maminas e rrethina. Teknologjia e saj italiane i jep mundësinë asaj të prodhojë verëra të cilësisë së lartë dhe të jetë një konkurrese e denjë në tregun e verërave shqiptare. Pas shijimit të verërave shqiptare, të gjitha të mira e cilësore, u kthyem në Tiranë. Dhe rruga e verës nuk është vetëm kjo, sepse ka kantina të tjera në Shqipërinë e Mesme, si Duka, Herta e të tjera, të cilat kanë po kaq vlerë dhe padiskutim duhen njohur e vlerësuar fillimisht nga vetë ne, shqiptarët.

Artikulli është shkruar për AgroWeb dhe gjendet në [www.agroweb.org](http://www.agroweb.org) me titullin: "Rruga e verës në Shqipërinë e Mesme"



Kantina Herta, Maminas, Durrës

# KOKOMANI VINEYARD



*12 muaj kënaqësi, shije, stil dhe klas i lartë  
në një ambient të mrekullueshëm*



Adresa:  
Eminas i Vogël, Komuna Gjepalaj, Durrës  
Cel: +355 69 20 50 870  
+355 69 40 19 172; +355 69 40 19 166  
E-mail: [info@kokomaniwinery.com](mailto:info@kokomaniwinery.com);  
E-mail: [b.kokomani@gmail.com](mailto:b.kokomani@gmail.com)  
Web: [www.kokomani-winery.com](http://www.kokomani-winery.com)





**MADE IN  
ALBANIA**

Kecat janë rritur tashë dhe janë bërë dhi e gjithashtu kanë lindur keca të tjerë. Por edhe ferma Amalthia është rritur dhe ka filluar t' i japë tregut produktet e saj të shijshme e të freskëta. Dhjetëra produkte e dhjetëra receta ku kombinohen jo vetëm djathrat e shumtë të freskët e të stazhionuar por edhe mishi i kecit të freskët. Ferma Amalthia është tashmë një realitet i pamohueshëm i produkteve shqiptare që meritojnë markën prestigjioze "Made in Albania"

Primo sale  
4 stinët

Kec i mbushur

# Ferma Amalthia

*bio-organikja  
në tryezën tuaj!*  
djathë i freskët

Riccotta e freskët

djathë i stazhionuar

qumësht  
i freskët  
në shishe  
gelqi



# Kantina Herta,

Maminas, Durrës, Albania



## nga vreshti në gotë...



*Kantina Herta nuk është tjetër veçse Kantina e families Hamdi Osmani. Krijuar nga kjo familie, ajo nisi prodhimin pasi kishte krijuar një sipërfaqe prej 4,5 hektarësh vresht në Maminas e rrethina, sipërfaqe të cilën e ka çuar deri në 6 hektarë. Teknologjia e saj italiane "Della Tofolla" i jep mundësinë asaj të prodhojë verëra të cilësisë së lartë dhe të jetë një konkuresuese e denjë në tregun e verërave shqiptare. Me llojet e kultivarëve si Merlot, Trebiano, Toscano, Kabërnët, etj., Herta ka krijuar produkte mjaft interesante si Bukuroshja e Durrësit, Merlot Dyrrah, Kabërnët Savinjon, Merlot Trebiano etj..*

*Mirëpo Kantina Herta nuk është thjesht çështje e një produkti të mirë por e një filozofie që sgkon drejt shijimit të natyrës, peisazhit, ushimeve të pastra pranë natyrës. E vendosur në një zonë mjaft të bukur të Durrësit, rrugës që ju çon për tek Gjiri i Lalëzit dhe Kepi i Rodonit, pranë liqeneve-rezervuare të karrecit, ambientet rreth kantinës ju ofrojnë mundësinë ideale për të shijuar një gotë verë në natyrë, shoqëruar me produktet e shijshme të zonës.*

**Adresa:**

**Rruga Gjiri i Lalëzit, Maminas, Durrës, Albania**


**Tel: +355 68 679 7703, [www.kantinaherta.com](http://www.kantinaherta.com)**





Ajo është birra e pastër e burimeve të maleve të Dukës, është birra e alpinistëve, birra e aventurave malore dhe e festave të gjata deri në mëngjes. Është birra që ka udhëtuar nëpër botë, duke përfaqësuar jo vetëm produktet e krahinës së Dukës por edhe produktet "Made in Albania" kudo nëpër panairët e turizmit në botë. Është birra që është ngjitur deri në Everest, në majën më të lartë të botës. Është "Birra Duka" krijuar nga Familja Begeja, dërguar me dashuri nëpër të gjithë Shqipërinë nga Xhimi Begeja dhe mirëpritur përzemërsisht nga të gjithë. Nuk ka festë sportive pa Birrë Duka.

**Hotel Turizëm Puka**  
**Pukë, Albania**  
**+355 67 207 0306**  
**FB: Puka Beer**



# Rezidenca Jazoj

## Vlora që nuk njihni

Radhimë



Saga e udhëtimeve gastronomike këtë herë na çoi në Vlorë. Ju do të thoni: pse nuk ju doli gjithë vera për të vajtur në Vlorë? Jo, nuk na doli. Sepse me siguri që edhe ju që po lexoni këtë rrëfim tani, mendoni atë që mendojnë shumica, se kur themi Vlorë, jemi mësuar të vrapojmë drejt detit, sa më pranë tij, mundësisht buzë tij, të na lagë këmbët teksa shijojmë peshkun e freskët apo frutat e detit.

Por a e keni menduar ndonjëherë se vetëm pak metra më lart, mbi kodrat e Radhimës mund të shijoni një botë krejt tjetër, me kuzhinë shtëpie, pula që rriten vetë, gatuar me makarona shtëpie e rosnica, byrekë e pispili me lakra të egra, reçelna e glikora me frutat e oborrit, likerna e raki nga vreshti, ullinj nga kalinjotët e famshëm të Vlorës? Një botë që e kemi lënë


plotësisht në hije, me peisazhin kodrinor që i rri si kurorë Jonit Edhe kuzhinë deti po aq të freskët sa poshtë por më të lirë se buzë detit. Eh, sa shkurt i biem dhe sa shumë humbasim. Sa kënaqësi i heqim vetes vetëm nga mosdija dhe dembelizmi. Sa pak marrim nga shijet e natyrës, ofruar përmes kuzhinës shqiptare...

Megjithatë nuk është kurrë vonë për të zbuluar shije të reja, ose më mirë vende të reja ku fshihen shijet e vjetra të dikurshme, pjatat tradicionale ku mbi të gjitha mbretëron ushqimi natyral e i gatuar si në shtëpi. Edhe për ne ishte zbulim ajo që gjetëm tek Rezidenca Jazoj, ku Bruna e zonja e shtëpisë na kishte bërë një ftesë prej kohësh. Nuk dua t'ju them shumë, ishin fjalët e saj, madje nuk dua të them asgjë, Dua të vini vetë një të diel pushimi e të kaloni një ditë tek ne. Do t'ju ofrojmë më të mirën tonë e shpresojmë se do t'i kënaqim



REZIDENZA JAZOJ, Radhimë, Vlorë, AL  
TEL +355 696847744; + +355 696714634

 Rezidenza Jazoj  Rezidenza Jazoj



shijet tuaja.  
Nuk është shumë larg nga rruga kryesore, as 400 metra. I ngjitesh kodrës mes rrugës së ngushtë e në të majtë, jemi drejt e tek oborri, ku fillimisht gjemë pulat, që çukisin të qeta nëpër bar. Pastaj, parajsja. Lule, lule, lule, gjithandej. Pemët mbushur plot, hurmat, shëegët, mandarinat, ftonjtë..., poshte tyre zambakët, krizantemat, karafilët, trëndafilët, lulemëllagat, që ishin harlisur të gjitha sikur ishte verë e jo mesvjeshtë. Bruna erdhi e na përshëndeti në oborr ndërkohë që bëhej gati t' u hidhte për të ngrënë pulave.

Ju duket e çuditshme? Ajo është e zonja e shtëpisë. Vetë gatuan, vetë shërben, vetë i bën byrekët e mrekullueshëm, mirëmban rezidencën, bën reçelnat, zahiretë e dimrit, mbledh ullinjtë... e në fundjavë kur ka më shumë punë kërkon ndihmë për të ndarë pak peshën e punës. Lodhet shumë por është e kënaqur me punën e saj sepse deri më sot, nuk ka ndodhur asnjëherë që dikush të largohet i pakënaqur nga shërbimi i saj e ç' është më e rëndësishmja, nga gatimet, që është edhe pika e fortë e Rezidencës Jazoj. Pse quhet rezidencë dhe jo hotel si të gjithë të tjerët? Sepse të pret si një mik shtëpie e kur bëhesh mik vërtet, nuk largohesh më. Nuk është çështje sloganeshe apo demagogjije por ky vend vërtet funksionon kështu. Pra, nuk është se mund të ngjitesh nga rruga kryesore këtu, e të kërkosh si pa gjë të keq një pulë fshati apo një byrek, apo një tavë në furrë etj., sepse duhen disa orë për të përgatitur një gatim të tillë tradicional. Kështu që është mirë që para se ta ndani mendjen për të ardhur, të telefononi ose të shkruani në adresat e rezidencës.



Zgjedhëm të hamë jashtë, ishte një ditë vere e vërtetë, që nuk mund të shpërdorohej duke ndenjur brenda, madje as në verandë. Sa më afër gjelbërimit, në tavolinën e drunjtë pranë shelgut, ku ishte krijuar një qoshe e perezistueshme. Nuk ka nevojë të përshkruhet asgjë në fakt, mjafton t' i hidhni një sy tryezës të shtruar, që ju kemi treguar në faqet e këtij shkrimi. Më shumë se



një tryezë për një vakt, ishte një sofër bujare me atë që ofron Rezidenca Jazoj në një ditë fundjave si kjo. Petullat e mëngjesit me reçel. Shtatë lloje reçelnash kishe bërë Bruna, e sërish po bënte me frutat e stinës që i kishte të gjitha në oborr. Për mirëseardhje një raki me mirto, ose mirtilli (italisht) ose mersina. Ka një aromë të mrekullueshme dhe mund ta pinë edhe femrat si aperitiv. Bruna e bën vetë, dhe jo vetëm atë. Pulë me rosnica, zogj të njomë me makarona shtëpie, djathë nape, ullinjë e oborrit (lart mbi ullinj ishte edhe një pyll me lisa ku të huajt, se ata bredhin gjithmonë, shkonin e bënin shëtitje), byrek me lakra të egra, pispili, lule kungulli....

Mendoni një festë familjare me një tryezë të mbushur në këtë mënyrë, që kënaq fëmijë e të rritur bashkë. Festat familjare janë gjëja më e zakonshme këtu, sepse ushqimi që ofrohet është i pakarahasueshëm me asnjë restorant serie, kudoqoftë ai. Aq më tepër që ofrohen njësoj me cilësi të lartë, si produkte fshati, ashtu edhe produkte deti, apo kuzhinë italiane me përbërës të freskët. Madje kuzhinën italiane, peshkun eapo frutat e detit, janë edhe më të thjeshta për t`u ofruar se nuk kërkohet shumë kohë për gatim, mjaft që të jenë të freskëta. Por rezidenca ofron gatimet e fshatit pikërisht se do të jetë ndryshe, që njerëzit të gjejnë këtu atë që nuk e gjenë në një vend tjetër.

Është ambienti ideal ku mund të festosh për qejf e nuk të ha merakun as se ku e ke lënë makinën, e as se ku shkuan kalamajtë. Ambienti i gjelbër në oborin e rezidencës, nuk ka fund, edhe para restorantit, edhe tek parking, edhe para hotelit.

Dhe meqë ra fjala tek hoteli, nuk po flasim për çarçafët akull të bardhë e për dorën që ndjehet e të duket sikur po fle në krevatin tënd, se këto janë detaje që e zonja e shtëpisë nuk i toleron, megjithë punët e shumta që ka. Por po flasim për ballkonet. Para jush hapet deti sa të ha syri. E mendoni dot, në një javë ose dhjetëditësh vere, se sa ngjyra perëndimesh mund të shijoni nga këto ballkone? Pamja e detit, që ndryshon çdo ditë por edhe çdo stinë, sipas luleve që çelin e i bashkohen panoramës, është një prej arsyeve të fort apse Bruna e harron lodhjen e punës. E sidoqoftë pa kohë, e gjen një sekondë për ta hedhur me vrap një foto në rrjetet sociale, sepse nuk i reziston dot bukurisë së natyrës.

As ne nuk i rezistua dot. Dhe nuk u ulëm fare në tavolinë për të ngrënë por morëm shiltet e u shtrua shesh, mbi barin e njomë, me pulat që na vinin rreth e qark.

E ku kishte kënaqësi më të madhe?

Rezidenca Jazoj. Një qoshe e fshehur mes natyrës që duhet ta zbuloni urgjentisht.



# ENGOBA



## tradita mijëvjeçare ballkanase e gdhendjes së qeramikës, në Vlorë, në atelienë e artistit **Zeqir Alizoti**

Në traditën tonë prodhimi i qeramikës zë një vend të veçantë; që prej antikitetit të hershëm e deri në ditët tona, me argjilën e përpunuar me dorë, njerëzit e lashtë krijojnë objekte utilitare të përdorimit të përditshëm. Kjo traditë në popuj dhe vende të ndryshme të botës u rrit dhe u zhvillua jo vetëm teknikisht por në formë, në motive dhe në karakterin funksional të tyre. Veçoritë individuale, motivet, shpirti dhe tradita në shekuj, u ruajt dhe u zhvillua në popuj dhe qytetërime të ndryshme. Kështu ndodhi edhe në vendin tonë. U hapën reparte dhe fabrika të ndryshme, si në Tiranë, Vlorë, Kavajë, Korçë e gjetkë. Diku u ruajt tradita dhe trashëgimia, duke krijuar objekte artistike, funksionale, krejtësisht të veçanta në motive, forma etj.. Pas viteve '90, në kushtet e ekonomisë së tregut, shumë prej këtyre reparteve dhe zejtarëve u transformuan, duke iu përshtatur kërkesave të tregut, të brendshëm dhe të jashtëm. Shumë zeje humbën ose u transformuan në krijimin e objekteve pa vlera të veçanta artistike.

Gjatë këtyre viteve të tranzicionit, në mungesën e kërkesave të tregut për objekte me vlera dekorative, popullore: (si rezultat i një turizmi sporadik) zejtarët apo qeramistët e mirëfilltë profesionistë u përpoqën dhe e mbushën tregun me objekte artizanale me vlera të ulëta në çmime, në dëm të cilësisë dhe ruajtjes së traditës. Një rol negativ ka luajtur prodhimet artizanale që vinin nga tregu i jashtëm; Tregtarët e mbushën tregun me objekte të cilat i blinin me kilogramë dhe i shisnin me copë në tregjet tona. Kjo bëri që shumë zejtarë për të mbijetuar ulën pretendimet dhe vlerat e artizanatit popullor tradicional.

Në luftën e madhe për mbijetesë dhe në përpjekje të ruajtjes së traditës, një punë të veçantë profesionale, duke u mbështetur në traditën tonë është bërë në repartin e qeramikës në qytetin e Vlorës. Ky repart







me një traditë shumëvjeçare konkuroi në tregun e brendshëm e të jashtëm për një periudhë tepër të gjatë, duke i dhuruar tregut qindra objekte me vlera funksionale dhe artistike. Duke e përfaqësuar vendin në dhjetëra panaire dhe ekspozita brenda dhe jashtë vendit. E veçanta dhe merita qëndron që objektet artistike që i serviroshin tregut, ishin në formë , teknikë dhe motive krejtësisht të traditës.

E bëmë një hyrje kaq të gjatë, pikërisht për t`ju rrëfyer për njërin prej personazheve të kësaj historie, që ka luajtur një rol të veçantë dhe specifik jo vetëm në botën e bukur të qeramikës por edhe në fushën e artit të skulpturës. Po flasim për skulptorin qeramist Zeqir Alizoti, i cili me mjeshtëri ka shfrytëzuar teknikat e veçanta të trashëguara, si engoba, një teknikë mijërvjeçare në trevat ballkanike dhe kryesisht në vendin tonë, të pasuruara më tej me motive popullore të krahinave të ndryshme. Mbi këtë traditë e trashëgimni ai ka mbështetur edhe krijimtarinë profesionale si artist bashkëkohor. Mjafton të bëni një vizitë në atelienë e artistit, për t`u mrekulluar me motivet e lashta ilire të vazove të qeramikës, me format e bukura femërore e mashkullore, veshur me kostume tradicionale shqiptare apo motivet floreale të gdhendjeve me engoba. Ky është një fakt shumë i rëndësishëm që çon në ruajtjen e traditës mijërvjeçare, e cila flet për vlerat e lashta të origjinës sonë. Duke qenë një teknikë e vështirë që kërkon edhe kosto të larta, rreziku i humbjes apo i tjetërsimit është shumë i madh prandaj këta artistë duhen mbështetur e vlerësuar, duke e nxjerrë sa më shumë në pah punën e tyre të mrekullueshme.

Nëse nuk keni mundësi ta vizitoni artistin në atelienë e tij dhe të admironi nga afër momentet e tij të punës, ju mund të shkoni


në çdo kohë në Vlorë, pranë teatrit Petro Marko, në libarinë Toena, e të vizitoni një show-room të pasur në punime qeramike të mrekullueshme e pse jo, të merrni me vete ndonjërin prej tyre si souvenir apo t`ia bëni dhuratë dikujt.

Ne prekëm vetëm njërën anë të artistit; atë të punimit të qeramikave por nuk harrojmë të përmendim punët e tij të mrekullueshme në skulpturë. Për to do t`ju falasim në një artikull tjetër, në një tjetër numër të Travel Magazine.



Show Rom: pranë teatrit Petro Marko, në libarinë Toena, Vlorë  
Tel.: +355 68 21 55 143; FB: Zeqir Alizoti Art & Sculpture





# LLOGORA TOURIST VILLAGE



**Llogora National Park, Vlore, Albania**  
**Tel.: +355693344400; e-mail: info@llogora.com**  
**www.llogora.com**

Fshati Turistik Llogora ndodhet në zemer të Parkut Kombëtar Llogora. Ajo ka një sipërfaqe prej 1.2 ha. Në brëndësi të saj ndodhen 16 vila druri, hotel 4 katësh me pishinë të brëndshme, Beer Club, Tavernë, Restorant, Bar, fushë basketbolli, sallë konferencash dhe 2 salla të vogla të cilat mund të përdoren për festa të vogla familjare ose mbledhje.

Në stinën e verës kur temperaturat janë të larta në qytetet e tjera të shqipërisë, në Llogora temperatura gjatë ditës është 10 gradë Celcius më e ulët, ndërsa gjatë natës arrijnë 10-12 gradë Celcius. Kjo ju jep një freski gjatë gjithë ditës dhe një gjumë të ëmbël gjatë natës. Ndërsa në periudhën e dimrit Fshati Turistik Llogora mbulohet nga dëbora. Në brëndësi të territorit tonë shetisin të lirë drera dhe sorkadhe të cilat ju bejnë pushimet tuaja akoma më magjike.



 **Llogora Tourist Village**



Marina Maritime SA Company

[www.finikas-lines.com](http://www.finikas-lines.com)

- ◆ Ferry Transport for persons and vehicles
- ◆ Bus transport for toursit itineraries
- ◆ Tours around Saranda & Albania
- ◆ Car Rentals
- ◆ Jeep Safari

*Let's travel together...*

Rruga Mitat Hoxha,  
Mbi portin Detar Sarandë, Albania;  
Tel: 0035585226057; Fax: 0035585225117  
Mob: 00355672022004; Mob:  
00355692073711;  
[info@finikas-lines.com](mailto:info@finikas-lines.com);  
[finikaslines@yahoo.com](mailto:finikaslines@yahoo.com)  
[marinamaritime.sa@gmail.com](mailto:marinamaritime.sa@gmail.com)  
[www.finikas-lines.com](http://www.finikas-lines.com)



# travel

Nr. 24 / 2017

albaniantravel.info

Në zbulim të Shqipërisë, thesarit të fshehur.  
Për herë të parë në Shqipëri, një garë vrapimi në terrene të vështira dhe të egra, me vrapues nga të gjitha kontinentet, organizuar nga GlobalLimits dhe mbështetur nga Albania Adventure. 220 km në 6 ditë, mes shtigjesh të panjohura, nga Berati në Butrint. Vitin që vjen kjo garë vjen sërish, në datat 7-15 Shtator.



Periodike / Botim i Blue Agency / ÇMIMI/PRICE Shqipëri 300 lekë / Kosovë, Mali i Zi 3 € / Maqedoni 160 Den, Greqi, Itali 5 €

*From Berati  
to Butrint with  
GlobalLimits and  
Albania Adventure*

# Albania Hidden Treasure